

**Ndërtimet**  
NATO shton  
vlerën e patund-  
shmërive

Fq.4



**TEATRI SHQIPTAR**  
Nga tetori në  
janar, Teatri  
me datë të re

Fq.7



**Shaqiri ishte vendimtar**  
**Klopp**

Fq.22



# Koha

www.koha.mk

**Të ndryshojë  
qasja ndaj  
Arabisë**

Fq.10

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3493 · e premte, 26 tetor 2018

3°C | 17°C

15 DEN

## EDITORIAL

**Viktimat e  
mosvëme-  
ndjes publike**



Donatorët që bashkëpunojnë me shoqata humanitare, në të shumtën e rasteve duan të ngelin anonimë, mirëpo mediat nuk duhet të bëhen aq të shurdhra dhe të mos afirmojnë altruizmin e këtyre shoqatave. Bamirësia, fundja, nuk kërkon reklamë, por vëmendja publike ka nevojë për krijimin e modeleve pozitive, duke futur kulturën e solidaritetit në praktikën... Fq.2

## RAJON

**Si do bëhet  
izolimi i  
kokave të  
krimit  
në burg**

Fq.14

## GLOBI

**Papa po  
mendon  
t'u lejojë  
priftërinjve  
martesën?**

Fq.15



## MUNDËSIA E VOTËBESIMIT NDAJ PRESIDENTIT IVANOV

# PËRCAKTUES 8 DEPUTETËT E PËRJASHTUAR



Kërkesë për votëbesim ndaj presidentit të shtetit Gjorgje Ivanov kanë të gjithë deputetët, por që të kalojë votëbesimi - nevojiten dy të tretat e votave. Kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi thotë se nuk përjashtohet mundësia për ngritjen e një iniciative të këtillë nëse në këtë temë diskutohet me 8 deputetët e përjashtuar nga VMRO-DPNME

Fq.3

## Kosova e Shqipëria të fundit, Maqedonia e 95-ta

Shkup, 25 tetor - Si Shqipëria dhe Kosova renditen të fundit në Evropë (pa përfshirë vendet e ish-Bashkimit Sovjetik) për të ardhurat për frymë, sipas të dhënave të fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, që ka përditësuar shifrat në "Pasqyrën Ekonomike Globale" të tetorit 2018. Për vitin 2018, Shqipëria vlerësohet të ketë të ardhura për frymë prej 5261 dollarësh, në vend të 102 nga 191 shtete, duke u përmirë-

suar me katër vende në raport me 2017-n, kur ishte në pozicionin e 106. Kosova, me të ardhura prej për frymë prej 4324 dollarësh, renditet e 112-a. Në rajon, të ardhurat më të larta i ka Mali i Zi me 8644 dollarë për frymë, duke u renditur e 79-a në botë, e ndjekur nga Serbia me 6815 dollarë (vendi 88), Maqedonia me 5953 dollarë (95) dhe Bosnjë Hercegovina me 5704 dollarë (e 100). Prej vitësh... Fq.6



## EDITORIAL

VIKTIMAT E  
MOSVËMENDJES  
PUBLIKE

Emin AZEMI

Donatorët që bashkëpunojnë me shoqata humanitare, në të shumtën e rasteve duan të ngelin anonimë, mirëpo mediat nuk duhet të bëhen aq të shurdhra dhe të mos afirmojnë altruizmin e këtyre shoqatave

Ngjarjet e ashtuquajtura të mëdha që po i servohen publikut, kanë filluar ta eklipsojnë njeriun e vogël, njeriun e sakrificave sublime gjatë viteve dramatike. Koncentrimi i vëmendjes publike vetëm tek manifestimet pompoze që po prodhojnë njëfarë lavdie politike dhe elektorale, e ka bërë pa sens kujdesin tonë moral e kombëtar ndaj atyre mikrongjarjeve që ishin magma vullkanike e historisë sonë më të re. Zakonisht në rrethana të tilla ka gjithnjë e më shumë personazhe të harruar të kësaj historie, të cilët paguan kosto të lartë qëndrimin e tyre të palëkundur në kushte kur ishin të vetëm para rreziqeve.

Të gjithë këta njerëz janë viktimë e harresës që vjen nga defokusi mi publik. Në mungesë të një gazetarie pak a shumë hulumtuese, këta fate njerëzish ngelin "libra të mbyllur" që askush nuk ua lexon tmerret që përjetuan.

Ndër personazhet e harruar janë edhe ata të cilët me vite kanë ndihmuar jetimët, skamnorët, të pastrehët, por që për ta shumë pak shkruhet e flitet në media. Ekziston madje edhe një paragjykim bllokues ndaj tyre, për faktin se ata mund të jenë personalitete fetare, rrethanë kjo që pa nevojë është konsideruar si tabu temë dhe nuk dihet sipas cilave kritere mediat përcaktojnë (jo)përshatshmërinë e tyre publike.

Ekzistojnë disa arsye pse mediat kanë mbajtur qëndrim paragjykes ndaj fondeve me prejardhje fetare, sidomos kur ato nuk janë transparente dhe në të shumtën e rasteve shkojnë nëpër kanale tepër të diskutueshme. Madje, përtej paragjyqimeve, janë bërë edhe hulumtime që kanë rezultuar me fakte pak a shumë komprometuese për vetë mënyrën e financimit, si dhe për dedikimin e këtyre fondeve.

Mirëpo, përtacia gazetareske për të mos hulumtuar edhe rastet pozitive, nganjëherë nuk mund të justifikohet, dhe më së paku të krijohen tablo bardh e zi, ku mund të bien viktimë e mosvëmendjes publike edhe njerëz të ndershëm, të cilët, edhe pse i takojnë establishmentit fetar, ata megjithatë luajnë një rol të rëndësishëm në zbutjen e varfërisë dhe tejkalimin e problemeve të vështira sociale në shumë familje shqiptare.

Në një "grip" të tillë të mosvëmendjes publike mund të ketë rënë edhe shoqata "Jetimët e Ballkanit", e cila për shumë vite është shumë aktive në mbarë hapësirën shqiptare, qoftë përmes dhënies së ndihmave të drejtpërdrejta, siç është edhe ndërtimi i shtëpive për të pastrehët, por edhe përmes ndihmave të tjera, përfshi edhe kuzhinat popullore për ofrimin e ushqimit falas në tre qytete të Kosovës.

Donatorët që bashkëpunojnë me shoqata të tilla, në të shumtën e rasteve duan të ngelin anonimë, mirëpo mediat nuk duhet të bëhen aq të shurdhra dhe të mos afirmojnë altruizmin e këtyre shoqatave. Bamirësia, fundja, nuk kërkon reklamë, por vëmendja publike ka nevojë për krijimin e modeleve pozitive, duke futur kulturën e solidaritetit në praktikën tonë të përditshme si një kod që duhet ti bashkojë dhe artikulojë vlerat njerëzore.

## MOMENT MË TË MIRË S'KEMI PASUR

"Le ta mbyllin gojën tellallët e qeverisë, lloj-lloj profesorë, anal-ista dhe tenderbegas se Marrëveshja e Prespës nuk lejuaka që shqiptarët të kërkojnë që kërkesat e atyre të përfshihen në ndryshimet kushtetuese.

Deputetët shqiptarë të mos i ngrejnjë dy gishtat pa u pranuar kërkesat e shqiptarëve, pasi Zaevi, edhe synet do të kishte pranuar të bëhet vetëm derisa ta kapërcejë hendekun. Sapo ta kalojë hendekun do të kërçasë dajaku. Më këtë votim pro, shqiptarët ia mbyllin vetes të gjitha shtigjet për të kërkuar në të ardhmen avancim të drejtave të veta nacionale. Ju deputetë, mos u fshihni si qyqarë pas sintagmës: kështu thotë Amerika. Amerika është me vullnetin e popujve dhe jo të matrapazëve politikë", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti Shpëtim Pollozhani.



## HASHIMI, NJË QETHËS I MIRË

"Kur Hashim Thaçi në intervistat e tij thekson 'raportet e shkëlqyera' me Isa Mustafën, ma përkujton raportin e berberit me klientin e tij. Hashimi është vërtet një qethës dhe rrojtari i talentuar, por edhe mirënjohës ndaj klientit që i rri mirë derisa ai kryen punën e tij. Në ndërkohë, liderhipi i PDK-së gjithmonë ka kujdes që të mos i përmend në publik insajderët nga partitë e tjera në mënyrë që t'i përdorë ata sa më gjatë dhe sa më mirë. PDK është vërtet një organizatë e shkëlqyer e shërbimit informativ", shkruan në profilin e tij në Facebook, shkrimtari Liri Loshi.



## TENDERBEU DHE SHOKËT E TIJ

"Në këtë vit të Skënderbeut, mendoni pak sa keq është që qeveriseni nga Tenderbeu dhe shokët e tij koncesionues dhe PPP. Dhe fëmijët e tyre lazdranë që rrahin policë, kapen me drogë, vriten nëpër lokale, dhe sponsorizojnë prodhimtarinë kulturore të medias dhe tallavasë", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti i Lëvizjes Vetëvendosje, Arbër Zaimi.



## LISTA QË KRIJON HUTI

"Kështu listash si kjo e grekëve mund të nxjerrë secili dhe në të të fus secilin nga ne. Që Mustafa i Nanove mbush xhepat nga jashtë, kjo kuptohet thjeshtë nga pisllet që bluan goja e tij, por një listë që nuk e ka kryemercenarin jeniçer Olsin e Jazexhinjëve vetëm shton dyshimet se kjo listë është sajuar për të krijuar huti dhe humbje besimi brenda një populli naiv që ha çdo gjë që i serohet", shkruan në profilin e tij në Facebook, dr.Artan Dika.



## MEDIACitate

MBI 57  
MILIONË  
EURO  
PËR 9 MUAJ  
UDHANË  
PËR  
VETERANËT

Mbi 57 milionë janë shpenzuar nga buxheti i shtetit për pagesa të veteranëve të luftës gjatë nëntëmuorit të këtij viti. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kjo shifër është rritur për 20 milionë euro apo 51 për qind. Kjo ka bërë që skemat sociale të pësojnë një rritje prej 16 për qind apo 44 milionë euro më shumë sesa gjatë periudhës janar-shtator të vitit 2017. Shpenzimet për skemat sociale kanë arritur në 321 milionë euro vetëm për 9 muaj, shkruan sot Koha Ditore. Rritjen e shpejtë të shpenzimeve për skemat sociale e ka parë si shqetësuese edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, i cili ka alarmuar se Kosova mund të shkojë drejtë krizës fiskale për shkak se buxheti i saj nuk përballon një rritje kaq të shpejtë të shpenzimeve për këtë kategori. Sipas raportit financiar për nëntëmuorin e këtij viti, një kopje që e ka siguruar gazeta "Koha Ditore", gjatë nëntëmuorit të 2016-s për pagesa të veteranëve të luftës ishin shpenzuar 28.86 milionë euro, për periudhën e njëjtë të 2017-s janë shpenzuar 37.96 milionë euro, ndërsa gjatë këtij viti vlera e pagesave ka arritur në mbi 57 milionë euro. Për pensionet bazë janë shpenzuar 86.83 milionë euro, për pensionet bazë të kontribut-dhënësve 71.10 milionë euro, për pensionet për persona me nevoja të veçanta 24.70 euro, për të verbrit 4.11 milionë euro. Bazuar në këtë raport për kategoritë e luftës janë shpenzuar edhe 29.83 milionë euro ndërsa për të burgosurit politik rreth 6.5 milionë euro.

(Koha DITORE, 25 tetor)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## ÇFARË ISHTE MARRËVESHJA TITONI-VENIZELLO?

Marrëveshja Titoni-Venizello (29 korrik 1919) ishte marrëveshje e fshehtë e përfunduar midis qeverive italiane e greke për ndarjen midis tyre të Shqipërisë, të Azisë së Vogël Perëndimore etj.

E nënshkruan ministri i Jashtëm italian T. Titoni dhe kryeministri grek E. Venizello. Sipas marrëveshjes në Konferencën e Paqes Roma do të mbështeste kërkesën greke për aneksimin e Korçës dhe të Gjirokastrës, ndërsa Athina do të përkrahte aneksimin e

krahinës së Vlorës prej Italisë dhe mandatin e saj mbi shtetin shqiptar të cunuar.

Greqia pranonte, gjithashtu, t'i lëshonte Italisë për 50 vjet një pjesë të skelës të Sarandës dhe të ruante asnjësinë e kanalit të Korfuzit.

Marrëveshja u denoncua nga pala italiane pas disfatës që pësoi në luftën e Vlorës, e cila e detyroi qeverinë e Romës të hiqte dorë nga aneksimi i Vlorës dhe nga mandati mbi shtetin shqiptar.

Kërkesë për votëbesim ndaj presidentit të shtetit Gjorgje Ivanov kanë të gjithë deputetët, por që të kalojë votëbesimi - nevojiten dy të tretat e votave. Kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi thotë se nuk përjashtohet mundësia për ngritjen e një iniciative të këtillë nëse në këtë temë diskutohet me 8 deputetët e përjashtuar nga VMRO-DPNME

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 25 tetor - Të drejtën e kërkesës për votëbesim ndaj kryetarit të shtetit në rastin konkret për Gjorgje Ivanov e kanë të gjithë deputetët. Por që të kalojë votëbesimi nevojiten dy të tretat e votave të deputetëve, ndonëse nuk është e sigurt nëse pikërisht tani është momenti i duhur për ngritjen e kësaj iniciative. Sidomos kur nuk dihet çfarë qëndrimi do të mbajnë 8 deputetët e përjashtuar nga partia opozitare, sepse këta 8 deputetë të opozitës e kanë dhënë votën e tyre për ndryshimet dhe kjo nuk do të thotë se mund ta mbështesin dhe votëbesimin e kryetarit të shtetit.

Kështu u përgjigj krye parlamentar Talat Xhaferi, në pyetjen gazetareske se a është koha që deputetët e Parlamentit të Maqedonisë të ngritin iniciativë për shkarkim të kryetarit të shtetit i cili ka bërë shkelje Kushtetutës së Maqedonisë herën e parë me mos nënshkrimin e miratimit të ligjit për përdorim të gjuhës shqipe në gjithë territorin e Maqedonisë për herë të dytë si "Formalisht votëbesimi mund të iniciohet me 20 vota, mirëpo për miratimin e këtij propozimi duhet të këtë mbështetjen e 2/3 e votave të deputetëve. Aktualisht Parlamenti nuk ka dy të tretat e votave prandaj është e panevojshme të kemi ngritjen e një iniciative të këtillë", deklaroi Xhaferi dhe sqaroi se kjo është e mundur nëse në këtë temë diskutohet me këta 8 deputetët e përjashtuar nga VMRO-DPNME, të cilët do të ishin të gatshëm që të mbështesin votëbesimin ndaj kryetarit të shtetit dhe në një situatë të tillë deputetët e shumicës parlamentar do të mund të ngrisin iniciativë në parlament për shkarkimin e kryetarit të shtetit.

MUNDËSIA E VOTËBESIMIT NDAJ PRESIDENTIT IVANOV

# PËRCAKTUESE, VOTAT E 8 DEPUTETËVE TË PËRJASHTUAR



## XHAFERI: PENGESË PËR GJUHËN SHQIPE, VETËM IVANOVI

Duke folur për hyrjen në fuqi në Gazetën zyrtare miratimi i Ligjit për gjuhën shqipe dhe iniciativën për kthimin sërish në votim në parlament, Xhaferi deklaroi se ligji tani më është miratuar dhe pengesë për këtë është vetëm kryetari i shtetit Ivanov. "Zotri Ivanov i cili me të vërtetë është President legal i shtetit, por i cili legjitimitetin e vet e ka humbur prej kohësh, me mosfirmosjen e dekretit me të cilin Ligji për përdorimin e gjuhëve me publikimin në Gazetën Zyrtare të Republikës

së Maqedonisë po pengon që të bëhet fuqiplotë. Në Parlament as që do të këtë ligj tjetër për gjuhën shqipe apo i njëjti të cilin dy herë e miratuan deputetët e shumicës parlamentare të kthehet sërish në votim. Ligji për përdorimin e gjuhës shqipe tani më është i miratuar vetëm se është çështje kohe për gjetjen e mënyrës se si të bëhet i plotfuqishëm në gazetën zyrtare të Maqedonisë", nënvizoi kryetari parlamentar Talat Xhaferi.

### DEPUTETËT E PËRJASHTUAR MUND TË FORMOJNË GRUP TË RI PARLAMENTAR

Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi informoi se deri më tani nuk ka asnjë propozim deri te kabineti i tij nga 8 deputetët se largohen nga grupi parlamentar VMRO-DPMNE-së, apo se kanë dorëzuar kërkesë se po formojnë grup të ri parlamentar, edhe pse sipas rregullores së parlamentit ata e kanë këtë të drejtë.

"Duke pasur parasysh se ata tani më janë shkëputur nga parti, rregullorja jep mundësi që ata të vetorganizohen, pasi që janë më shumë se 5 deputetë. Në aspektin formal fillimisht do të duhet individualisht të deklarohen për statutin që kanë në partinë e mëparshme. Njëherit ata duhet të deklarohen se nuk janë pjesë e koalicionit të partisë "Për Maqedoni më të mirë" që të mundet me akt të ri ti drejtohen kabinetit të tij për të formuar grup të ri parlamentar.

Formalisht për momentin VMRO-DPMNE ka vetëm një grup parlamentar në Parlament", tha Xhaferi.

### ENDE NUK DIHET A DO TË KETË PAJTIM, FALJE APO AMNISTI

Sipas kryeparlamentarit Xhaferi vazhdon pasiguria për formimin e komisionit për falje për shkak se 8 deputetët që votuan për ndryshimet kushtetues ende nuk kanë dorëzuar iniciativë për takim dhe të diskutojnë apo të sqarojnë se cila është ideja e tyre, pajtim, falje apo amnisti.

"Ideja për formimin e këtij trupi është në kontekst të përgatitjes së shumicës parlamentare që të kenë pajtim të përgjithshëm midis partive parlamentar. Iniciatorët e formimit të këtij komisioni deri më sot nuk më janë drejtuar që të japin sqarime konkrete se cila është ideja bazë për formimin e këtij komisioni. Vullneti i tyre ishte që unë të udhëheq me këtë komision dhe

presë që iniciatorët për formimin e këtij komisioni të caktojnë takim me mua dhe të sqarojnë dilemat se bëhet fjalë për pajtim, falje apo amnisti", tha Xhaferi.

Lidhur me iniciativën e VMRO-DPMNE-së se ata do të marrin pjesë në këtë komision vetëm nëse pranohet kërkesa e tyre për propozim ligj për amnisti, Xhaferi sqaroi se deputetët kanë të drejtë deri të kuvendi të dorëzojnë propozim ligje nëse e argumentojnë idenë për këtë ligj dhe çfarë do të thotë kjo për imazhin dhe pozitën e Parlamentit.

"Nuk mund të prejudiojë se cila është ideja e këtij ligji. Nëse është fjala për pajtim, ne shqiptarët shumë mirë e kuptojmë se çfarë do të thotë pajtim si dhe falje, sepse shqiptarët me mijëra herë kanë falur apo janë pajtuar në mes veti. Ligj për amnisti nuk mund të ketë për ata persona me të cilët merren organet gjyqësore", tha Xhaferi.



## Skurlėtis i sigurt se ekziston shumica edhe në Parlamentin grek

Athinë, 25 tetor - Në parlamentin e sotëm ekziston shumica e nevojshme për ratifikim të Marrëveshjes së Prespës, por edhe që të mos rrezikohet besimi i qeverisë aktuale, vlerëson sekretari i përgjithshëm i SYRIZA-s dhe ish-ministër, Panos Skurlėtis. Siç lajmëron korrespondentja e MIA-s nga Athina, Skurlėtis në një intervistë për televizionin "Alfa", sqaroi se Marrëveshja e Prespës dhe qëndrimi në pushtet në qeverinë aktuale, janë dy çështje që ndërliken mes vete. "Kjo çon në faktin se ekziston shumica e nevojshme dhe për miratimin e Marrëveshjes së Prespës, por ekziston edhe shumicë në parlamentin e sotëm që të mos kërcënohet besimi i qeverisë", thotë Skurlėtis. Në lidhje me atë se kur marrëveshja do të vendosej në rend dite në Parlamentin grek, Skurlėtis thotë se periudha e saktë kohore do të përcaktohet varësisht nga ajo se kur nga ana jonë do të përmbushen detyrimet e parapara. Sekretari i përgjithshëm i SYRIZA-s, vlerëson se edhe krahas pakënaqësive të shprehura nga partneri i koalicionit, Panos Kamenos, megjithatë, qeveria do ta tejkalojë këtë problem. "E kuptoj dhe nuk e nënvlerësoj këtë, kur një nga dy partnerët e koalicionit kohë pas kohe del dhe thotë se do të krijoj pengesa në procesin e votimit të marrëveshjes konkrete, ky është problem i madh, por vlerësoj se do ta tejkalojmë dhe do të na jepet mundësia që të ballafaqohemi me problemet tjera serioze të vendit, por edhe për shumicën e qytetarëve", sqaroi Panos Skurlėtis për televizionin grek.

## Kurc: BE nuk është e tërësishme pa Ballkanin

Budvë, 25 tetor - Bashkimi Evropian do të jetë i tërësishëm madje kur shtetet nga Ballkani Perëndimor do të jenë anëtarë të Unionit, deklaroi dje kancelari austriak Sebastian Kurc në Konferencën "Ballkani dhe BE-ja - Cikli pesëvjeçar i Procesit të Berli-

nit", që mbahet në Budvë. E euroj Maqedoninë për vendimin historik të vazhdojë me implementimin e Marrëveshjes së Prespës, tha më tej Kurc, me çka dërgoi sinjal të inkurajimit jo vetëm për Maqedoninë, por edhe për tërë rajonin, ndërsa u sh-

preh se integrimi funksionon vetëm përmes bashkëpunimit në politikë dhe ekonomi. "Stabiliteti dhe siguria afatgjate për rajonin dhe për BE-në mund të sigurohen vetëm nëse ky rajon bëhet pjesë e Unionit...këto nuk janë ëndrra, por jemi në rrugë të

mirë", tha Kurc. Ai shtoi se kriza e emigrantëve tregoi se Ballkani vendos për tërë Evropën. "BE perspektiva për Ballkanin Perëndimor duket më mirë se kurdoherë...Vendet nga rajoni janë në rrugë të mirë drejt BE-së", tha Kurc.



## BIZNESI I NDËRTIMIT

## NATO SHTON VLERËN E PATUNDSHMËRIVE

Biznesi i ndërtimit në vend sugjeron se tani është koha për të investuar në patundshmëri për shkak se pas hyrjes në NATO pritet rritja e vlerës së pronave të patundshme.

Koha Fisnik PASHOLLI



Shkup, 25 tetor - Siguria që do të vinte nga anëtarësimi eventual i shtetit në Aleancën Veriatlantike, pritet që të shtrenjtojë çmimin e banesave në Maqedoni. Kompanitë ndërtimore thonë se hyrja në NATO do të stabilizojë tregun e patundshmërive, duke shtuar se edhe shtrenjtimi i materialeve ndërtimore në mënyrë shtesë ndikon në rritjen e kostos së ndërtimit të banesave. Kjo dëshmohej edhe përmes të dhënave statistikore, sipas të cilave vetëm në tremujorin e dytë të këtij viti janë rritur harxhimet e materialeve për 6.4 për qind dhe të punëtorëve për 10.6 për qind në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në ndërkohë, biznesi i ndërtimit

në shtet sugjeron se tani është koha për të investuar në patundshmëri për shkak se pas hyrjes në NATO, pritet rritja e vlerës së pronave të patundshme.

“Me vetë hyrjen në NATO pritet që të rritet edhe çmimi i banesave për shkak se ky anëtarësim nënkupton stabilitet. Pra kur kemi stabilitet, me siguri se edhe vlera e pronës është më e madhe. Andaj të gjithë që kanë blerë patundshmëri me vetë hyrjen e shtetit në Aleancën Veriatlantike do të fitojnë vlerë shtesë, ndërsa të tjerët që dëshirojnë të blejnë prona, tani është koha që ta bëjnë këtë hap, për shkak se çmimet tani janë më të pranueshme, ndërsa pas hyrjes ato do të shtrenjtohen. Pra, të gjithë

që mendojnë në këtë drejtim apo kanë kursime, udhëzohen që të investojnë në patundshmëri për shkak se do të kenë përfitime, duke pasur parasysh faktin se realisht çmimet duhet të shtrenjtohen për së paku 20 për qind”, thotë Ivica Jakimovski, kryetar i Odës së Ndërtimtarisë pranë Lidhjes së Odave Ekonomike të Maqedonisë.

Statistika nga ana tjetër tregon se në mesatare çmimi i banesave është afër 700 euro. Megjithatë shpalljet e ndryshme tregojnë se diku shiten banesa edhe me dyfishin e këtij çmimi në varësi prej lokacionit si dhe pajisjes së banesës.

Sipas Entit të Statistikës së Maqedonisë, çmimi i banesave në vend në vitin e kaluar ishte 41.822

denarë apo 680 euro. Kjo paraqet një çmim për 3 për qind më të ulët në raport me vitin 2016.

Në Shkup, si kantierin më të madh të ndërtimit në Maqedoni dhe tregun kryesor të shitblerjes së banesave, një metër katror në mesatare në vitin 2017 shitej së paku sipas statistikës zyrtare me një çmim prej 43 710 denarë apo 710 euro që është për 14 për qind më pak në raport me vitin 2016. Në vendbanimet e tjera në Maqedoni në mesatare, një metër katror shitej me 32 001 denarë apo 520 euro që është për 2.2 për qind në pak se në vitin 2016. Në ndërkohë, analiza e fundit të Agjencisë së Kadastrës tregojnë se mbi 5000 banesa në Maqedoni janë të pa shitura, ndërsa po vijon ndërtimi i 10.500 banesave që duhet të vendosen në shitje. Analizat e kadastrës më tej tregojnë se në tre muajt e parë të këtij viti në totalin e shitblerjes së patundshmërive dominojnë pronat e vjetra me 4400 marrëveshje për shitblerje, ndërsa janë shitur edhe 700 banesa të reja. Ndër lokacionet më atraktive për blerjen e banesave mbeten komunat Aerodrom dhe Karposh në Shkup, ndërsa është rritur edhe numri i banesave të shitura në tre muajt e vitit 2017 në Tetovë dhe Kumanovë.

## TETOVË, POLICIA DËRGON 1000 LËNDË PËR DY MUAJ

## RRITEN LËNDËT, ULET NUMRI I GJYKATËSVE

Në të kaluarën, në Tetovë ka patur 29 gjykatës, kurse ky numër u ul në 22 deri në vitin 2016, kur edhe sërish kishte lëvizje të gjykatësve në instanca më të larta dhe tashmë për një rajon me rreth 200 mijë banorë, përgjegjës janë 19 gjykatës, sidomos tani kur ka rritje të numrit të lëndëve të cilët vijnë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 25 tetor - Në Gjykatën Themelore të Tetovës, tani 19 gjykatës punojnë në të gjitha fushat që mbulon kjo gjykatë. Nga një total prej 19.500 lëndë të këtij viti, të pazgjidhura nga viti i kaluar kanë qenë 4155 lëndë dhe këtë vit 15.303 raste janë aplikuar shtesë. Deri më tani 14.219 raste janë zgjidhur, ndërsa 5234 raste të tjera janë në procedurë. “Shumica e rasteve janë në procedurë për kundërvajtje ose mbi 1000 raste janë pranuar nga SPB-Tetovë pas përfundimit të pushimit vjetor, por janë shpërndarë edhe në mesin e gjyqtarëve, prandaj shpresat janë që ato të zgjidhen deri në fund të vitit. Të gjitha vendimet e gjykatave janë hartuar dhe publikuar rregullisht në sistemin AKMIS dhe në faqen tonë të internetit”, tha gjykatësja Verka Kostoska. Ajo thotë se vetëm brenda dy muajve të fundit janë rritur lëndët që kanë ardhur nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë.

“Është rritur numri i lëndëve në sferën e kundërvajtjeve dhe lëndëve civile. Deri në shtator janë regjistruar 2099 lëndë civile, prej të cilëve 629 janë nga viti i kaluar, ndërsa 1471 janë të reja. Sa i përket lëndëve që i takojnë kategorisë së kundërvajtjeve, gjithsej janë regjistruar 2561, prej të cilëve 409 të vjetra, ndërsa 2561 janë të reja. Prej tyre janë zgjidhur 2114”, informoi Kostoska. Dominojnë lëndët kundërvajtëse dhe civile, kurse ankesat nga viti në vit kanë shënuar rënie në lidhje me punën e gjykatësve. “Deri në vitin 2000, gjatë periudhës prej 12 muajve, janë pranuar nga 110 ankesa ndaj punës së gjykatësve,

kurse ky numër tash ka rënë dukshëm edhe atë - pra në vitin 2014 ka pasur 11 ankesa, ndërsa vitin 2015 ky numër është rreth 10 ankesa ndaj gjykatësve. Kjo tregon se puna e gjykatësve shkon duke u përmirësuar. Nëse një gjykatës sjell ndonjë vendim në favor të ndonjë palë pa pasur bazë ligjore, atëherë vendimi anulohet në Gjykatën e Apelit. Çdoherë kur kthehet vendimi, gjykatësit i shënohen pikë negative. Ka shumë akuza për gjykatat, por duhet që të ketë fakte dhe argumente, sepse ka instanca që e kontrollojnë punën e gjykatësve, por edhe të gjykatave në përgjithësi”, thonë nga Gjykata e



Tetovës.

Në ndërkohë, në vitin 2015 në Gjykatën e Tetovës janë zgjidhur 27.200 lëndë, ndërsa janë bartur për vitin 2016 rreth 5900 lëndë. Në gjykatën e Tetovës, informoi Kostovska, nuk ka lëndë më të vjetra se gjashtë muaj. Ndryshe, në të kaluarën, në Tetovë ka patur 29 gjykatës, kurse ky numër u ul në 22 deri në vitin 2016, kur edhe sërish kishte lëvizje të gjykatësve në instanca më të larta dhe tashmë për një rajon me rreth 200 mijë banorë, përgjegjës janë 19 gjykatës, sidomos tani kur ka rritje të numrit të lëndëve të cilët vijnë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë.

## STUDENTËT NË GJYKATË

Ndryshe, studentët nga fakultetet Juridike të Universitetit Shtetëror të Tetovës dhe ata të Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë dje vizituan Gjykatën Komunale në qytet si pjesë e Ditës së hapur në kuadër të krenimit të 25 tetorit si Dita Evropiane e të Drejtës Civile. Zëdhënësjja e gjykatës së Tetovës, gjykatësja Verka Kostoska

informoi për situatën, si dhe për veprimet e rasteve nga ana e gjykatësve. Në kuadër të vizitës së djeshme në Gjykatën Themelore të Tetovës, juristët e ardhshëm u takuan me kryetarin e Gjykatës, Hasan Asani, vizituan disa lokalitete dhe departamente të gjykatës, ndërsa morën pjesë edhe në një nga seancat gjyqësore.

## Tender për furnizues universal me energji elektrike

Shkup, 25 tetor - Kompanitë furnizuese me energji elektrike më së voni deri më 3 dhjetorë duhet të aplikojnë në tenderin publik që Qeveria e shpalli në shtator, sipas Ligjit të ri për energjetikë. “Tenderin për zgjedhje të furnizuesit universal e shpalli Qeveria, ndërsa Komisioni Rregullator për Energjetikë (KRE) nuk ka informacione se cilët nga furnizuesit janë të interesuar të paraqiten në shpallje. Ne vetëm ishim të detyruar ti përgatisim kriteret në bazë të të cilave duhej të shpallet tenderi dhe ti dorëzojmë te Qeveria. Para se ti dorëzojmë kriteret deri te Qeveria, organizuam disa mbledhje të përbashkëta me furnizuesit me qëllim që t’ua prezantojmë kriteret dhe ti dëgjojmë vërejtjet e tyre dhe në atë mënyrë ti përmirësojmë kriteret. Vërejtjet e dhëna i inkorporuam dhe i dorëzuam deri te Qeveria. Nga ai moment deri tani Qeveria e udhëheqë atë proces”, deklaroi kryetari i KRE-së Marko Bislimovski. Ai njoftoi se deri te emërtimi i furnizuesit të ri universal atë obligim do ta bëjë EVN Maqedoni me qëllim, siç tha, të sigurohet në furnizimin me energji elektrike të të gjithë konsumatorëve dhe sipas Ligjit për Energjetikë. “Nëse askush nuk paraqitet, me Ligjin janë parashikuar shumë mënyra, mes të cilave edhe obligimi për shpallje të një tenderi tjetër, si dhe KRE ti propozojë Qeverisë se si të veprojnë në procedurën e mëtejshme, përkatësisht nëse do të shkojë edhe me një tender ose do të bëhen konsultime me furnizues të caktuar”, tha Bislimovski dhe shtoi se shpreson që në tenderët do të paraqiten furnizues të energjisë elektrike. Në Maqedoni për momentin janë aktiv tetë furnizues me energjinë elektrike të cilët në mënyrë aktive u shesin konsumatorëve, ndërsa janë mbi 20 licenca për furnizim me energji elektrike. “Të gjitha parakushtet për treg konkurrues të energjisë elektrike tashmë ekzistojnë në Maqedoni. Ne jemi vendi i vetëm në rajon në të cilin ka tetë furnizues aktiv me energji elektrike, ndërsa edhe përqindja jonë e liberalizimit real është më i lartë në rajon”, potencoi Bislimovski. Ai tha se karakteristike është që Maqedonia është vendi i vetëm në rajon ku një kompani private e cila nuk ka dalë nga ndonjë ish ndërmarrje vertikale është furnizuesi më i madh me energjinë elektrike të tregut. (Q.A)

“TITANIK 3” SËRISH PËR PARREGULLSITË ZGJEDHORE

# PROCESVERBALET U KORRIGJUAN PA VULËN E KRYETARËVE

Zgjedhjet lokale në Çair gjatë vitit 2013, ndonëse deri në ora 19:00 kishin kaluar në mënyrë më të rregullt, parregullsitë dhe shkeljet ligjore, sipas dëshmitarëve, kanë ndodhur pasi materiali zgjedhor është dorëzuar në Komisionin Zgjedhor në Çair. Dëshmitarët të cilët folën të enjten për rastin “Titanik 3” thanë se korrigjimin e procesverbaleve nuk e kishin bërë ata, ndërsa deputetin Alimi fare nuk e kanë parë në Komunë apo komisione zgjedhore



dite, të enjten e pyeti se vallë ai e kishite nënshkruar dhe vulosur një procesverbale të korrigjuar.

“Ky nuk është nënshkrimi e as vula ime”, tha shkurt dëshmitari Ajdini. Mes tjerash, ai potencoi se ditën e zgjedhjeve nuk e kishte parë apo takuar asnjërin prej të akuzuarve, Ejup Alimin apo Ismet Gurin. Për dallim nga Ajdini, dëshmitari tjetër në rastin “Titanik 3”, Nazmi Ramani, tha se pasi ka përfunduar procesi zgjedhor dhe votat janë numëruar në Këshillin Zgjedhor, ku ai ka qenë kryetar, i gjithë materiali zgjedhor është dërguar në Komunën e Çairit, ku dhe ka qenë i pozicionuar Komisioni Zgjedhor i kësaj komune.

“Me të arritur në komunë, para na doli Qani Toçi dhe Sedat Kubur. Na i kërkuan procesverbalet dhe të njëjtat na i kthyen për pak kohë. Të njëjtat ishin të korrigjuara, të shlyera dhe të vulosura me vula të vogla. Brenda kësaj kohe vërejtja prezencën e Ismet Gurit (i akuzuar), nga zyra e të cilit Toçi hynte dhe dilte. Atë ditë nuk kam pasur asnjë farë kontakti apo bisede me Gurin. Përderisa Ejup Alimin atë ditë nuk e kam parë fare”, theksoi dëshmitari Ramani.

Ndryshe, dëshminë e saj të enjten e dha edhe zëvendësanëtarja e Komisionit Zgjedhor në Çair, për zgjedhjet lokale të vitit 2013, Martina Antiq, e cila po ashtu e vërtetoi faktin se procesi zgjedhor atë ditë kishte kaluar në mënyrë më të mirë.

“Gjithçka shkonte në rregullt, derisa dy apo tre ditë pas zgjedhjeve, dëgjova se anëtari i Komisioni Shtetë-

ror të Zgjedhjeve, Bedredin Ibrahim, kishte kundërshtuar zgjedhjet në Çair, pasi sipas tij, nuk janë përputhur votat mes vete. Njëkohësisht dëgjua se Ibrahim kishte urdhëruar arrestimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit Zgjedhor. Për këtë arsye, në anëtarët e Komisionit e realizuam një takim joformal, në të cilën nuk morën pjesë kryetari i Komisionit Zgjedhor në Çair, Blerim Haxheri, anëtari Qani Toçi dhe sekretari Ismet Guri. Në këtë takim, të gjithë supozuam se lidhje me këtë vepër mund të ketë Guri”, tha dëshmitarja Antiq gjatë rrëfimit të saj në rastin “Titanik 3”.

Përfaqësuesi i aktakuzës - PSP, lidhur me këtë lëndë u shpreh se edhe gjatë tre apo katër seancave të ardhshme në këtë lëndë do të prezantohen dëshmitarë. Sipas tyre, akuzat e ngritura kundër Alimit dhe Gurit pritet ti vërtetojnë dëshmitarët që vijojnë, në mesin e të cilëve është edhe dëshmitari Qani Toçi. Përveç dëshmitarëve, PSP gjatë periudhës së ardhme pritet të prezantojë edhe dëshmi materiale, gjegjësisht materiale që burojnë nga përgjimet e jashtëligjshme.

Ndryshe, deputeti i BDI-së, Ejup Alimi dhe anëtari i kësaj partie Ismet Gurit, nga PSP akuzohen për prishje dhe shkelje të procesi zgjedhor. Megjithatë, për Alimin deri më sot nuk është gjetur asnjë dëshmi që të njëjtin e implikon në falsifikimin e zgjedhjeve në Çair, pasi i njëjti ishte i deleguari i BDI-së për Qytetin e Shkupin dhe jo për Komunën e Çairit. Seanca e radhës për këtë lëndë vazhdon me datë 30 tetor.

Koha

Omer XHAFERI

Shkup, 25 tetor - Korrigjimi i procesverbale për zgjedhjet lokale të vitit 2013 në Komunën e Çairi ishin temë diskutimi në seancën e fundit për rastin “Titanik 3”. Dëshmitarët e propozuar nga Prokuroria Speciale Publike, një pjesë e të cilëve ishin edhe të vetë palës mbrojtëse, thanë se procesi zgjedhor deri në orë 19:00 të zgjedhjeve në fjalë kishte kaluar pas një shkelje apo parregullsi. Rrëfimin e tij si dëshmitar në seancën e ditës së enjte e dha Ajdin Ajdini, i cili në vitin 2013, në shkollën fillore “Tejefuz”, kishte qenë kryetar i një Këshilli Zgjedhor.

“Atë ditë gjithçka është zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore. Pastaj, me përmbylljen e vendotimeve, ne kemi qëndruar në klasa dhe kemi filluar me numrin e votave. Për këtë detyrë zgjedhet një person nga Këshilli Zgjedhor. Numri i procesverbaleve të përgatitur atë ditë ka qenë i madh. Saktësisht nuk më kujtohet. Të gjithë ishin të shënuara me numra, siç ishin 16, 20 e kështu me radhë. Kur jemi të korrigjimi i procesverbaleve, duhet të theksohet se ligjërisht na takon neve sipas nevojës ti korrigojmë. Për këtë arsye, edhe vulat i mbajmë me veti”, tha dëshmitari Ajdini.

Prokurorja speciale Fatim Fetaj, duke ia përkujtuar dëshmitarit Ajdini procesverbalet e nënshkruara të asaj

## Dy të paditur për tentim-vrasje në Batincë

Shkup, 25 tetor - Prokuroria Themelore Publike e Shkupit ka dhënë urdhër për zbatim të procedurës hetimore kundër dy personale për shkak ekzistimit të dyshimit se si bashkëpunëtorë kanë kryer vepër penale “tentim vrasje” nga neni 123 paragrafi 1 në lidhje me nenin 19 dhe nenin 22 nga Kodi Penal. “Personat dyshohet se më 22.10.2018 në fshatin Batincë, me pa-

ramendim kanë tentuar ta privojnë nga jeta një person. Derisa i dëmtuari e ka drejtuar automjetin motorik të blinduar ‘BMW 750’ me targa gjermane në rrugë dhe ka kaluar në afërsi të varrezave, dy të dyshuarit kanë shtënë drejtë tij me kallashnikov. I dëmtuari është ndalur me automjetin, ndërsa kur të dyshuarit i janë afruar me armë në duar, ai e ka lënë

automjetin në lëvizje dhe ka ikur”, thuhet në komunikatën e Prokurorisë. Njëri prej të dyshuarve është privuar nga liria dhe i dëmtuari ka bërë identifikimin e tij, ndërkaq i dyshuari tjetër, theksohet në komunikatë, nuk është i qasshëm për organet e policisë dhe për të Ministria e Punëve të Brendshme ka dhënë flet-arrest qendror.

## KRONIKË

### Sulmohet mjeku në Spitalin e Tetovës

64 vjeçari Xh.E nga fshati Glogjë, i punësuar si mjek në Spitalin klinik të Tetovës, të mërkurën ka denoncuar se rreth orës 09 e 15 minuta, deri sa ka qenë në vendin e punës, ka qenë i sulmuar fizikisht nga personi B.F. 40 vjeçar nga fshati Odër, gjithashtu i punësuar në të njëjtin spital, si dhe bashkëshortja e personit B.F., me të cilën denoncuesi Xh. E. paraprakisht ka pasur një zënkë verbale. Menjëherë pas denoncimit të rastit, personi B.F është privuar nga liria dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

### Rrahje në Tetovë

28 vjeçari A.E. nga Tetova, të mërkurën ka denoncuar se rreth orës 15.00, derisa me tre persona tjerë ka qëndruar përpara zyrës së avokatit në rrugën “Strushka” në Tetovë, pronë e babait të tij, pasi që paraprakisht një mashkull dhe një femër kanë pasur një zënkë verbale, ku më vonë është vërtetuar se bëhet fjalë për personin M.B. 30 vjeçar i cili është afruar ku e ka sulmuar fizikisht dhe ka ikur nga vendi. Diku më vonë personi, M.B dhe N.B. 30 vjeçare nga Tetova, janë thirrur në Stacionin policorë në Tetovë, dhe pas zbardhjes së plotë të rastit, do të pasojnë edhe padi adekuate.

### Zbulohet heroinë dhe marihuanë në Tetovë

Pjesëtarët e policisë nga Sektori për Punë të Brendshme Tetovë, të mërkurën prej ora 16 e 30 minuta deri ora 17 e 20 minuta, kanë kryer bastisje në shtëpinë dhe hapësirat ndihmëse të 37-vjeçarit F.U. nga Tetova, në rrugën “Shtipska” në Tetovë. Gjatë bastisjes së realizuar me urdhër të gjykatësit, është gjetur sasi heroine, ndërsa tek 38 vjeçari E.I. gjithashtu nga Tetova, i cili ka qenë së bashku me personin F.U., është gjetur marihuanë. Dy personat janë privuar nga liria dhe pason zbardhje e plotë e rastit.

### Plagoset duke lëvizur në fushë

20 vjeçari E.M. nga fshati Vrapçisht i Gostivarit, të mërkurën ka denoncuar se më datën 18 të këtij muaji, rreth orës 15.00, duke ecur në këmbë në rrugën e fushave, e cila shpie drejtë autostradës Gostivar-Tetovë, ka qenë i lënduar nga një gëzhjojë plumbi nga pushkë ajrore, në pjesën e qafës. Pas dhënies së ndihmës mjekësore në Spitalin e Gostivarit, është dërguar në Kompleksin e klinikave “Nënë Tereza” në Shkup për mjekim të mëtutjeshëm. Merren të gjitha masat dhe aktivitetet, për zbardhjen e plotë të rastit.

### Aksidentohet një biçiklistë

Të mërkurën orës 14 e 20 minuta, në rrugën “Kiro Ristovski Dërc” në Tetovë, ka ndodhur një aksident trafiku në të cilën kanë marrë pjesë vetura e tipit “Golf” me targa të Tetovës, e drejtuar nga 25vjeçari B.B. nga Tetova dhe një biçikletë të cilën e ka drejtuar 37 vjeçari A.A. nga Tetova. Çiklisti i lënduar, është dërguar në Spitalin klinik të Tetovës, ku pas dhënies së ndihmës mjekësore, është mbajtur për mjekim të mëtutjeshëm. Janë kryer hetimet dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

### Tetovë, shpëtohet shtetasja e Ukrainës

Të mërkurën rreth orës 18 e 30, në afërsi të vendit të quajtur stanet e Shipkovicës, të cilat gjenden poshtë Kodrës së Diellit, pjesëtarët e policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë kanë gjetur dhe ndihmuar shtetasen e Ukrainës, F.O. 21vjeçare, e cila është humbur, duke u lëshuar nga pjesa malore e quajtur “Sidoll” ku ukrainasja bashkë me dy shokët e saj 27-vjeçarin J.M. nga Gjermania, dhe 20 vjeçarin R.V. nga Izraeli, kanë qenë në kamping diku në afërsi. Pasi e kanë dorëzuar te shokët e saj, të tre kanë vazhduar me kampingun së bashku, njoftoi zëdhënësi i Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë, Fatmir Rexhepi. (U.H)

Dy shtetet shqipfolëse, Shqipëria dhe Kosova renditen shumë ulët sa i takon të ardhurave. Në rajon, të ardhurat më të larta i ka Mali i Zi me 8644 dollarë për frymë, duke u renditur e 79-a në botë, e ndjekur nga Serbia me 6815 dollarë (vendi 88), Maqedonia me 5953 dollarë (95) dhe Bosnjë Hercegovina me 5704 dollarë (e 100)

Shkup, 25 tetor - Si Shqipëria dhe Kosova renditen të fundit në Evropë (pa përfshirë vendet e ish-Bashkimit Sovjetik) për të ardhurat për frymë, sipas të dhënave të fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtare, që ka përditësuar shifrat në "Pasqyrën Ekonomike Globale" të tetorit 2018. Për vitin 2018, Shqipëria vlerësohet të ketë të ardhura për frymë prej 5261 dollarësh, në vend të 102 nga 191 shtete, duke u përmirësuar me katër vende në raport me 2017-n, kur ishte në pozicionin e 106. Kosova, me të ardhura prej për frymë prej 4324 dollarësh, renditet e 112-a.

Në rajon, të ardhurat më të larta i ka Mali i Zi me 8644 dollarë për frymë, duke u renditur e 79-a në botë, e ndjekur nga Serbia me 6815 dollarë (vendi 88), Maqedonia me 5953 dollarë (95) dhe Bosnjë Hercegovina me 5704 dollarë (e 100). Prej vitesh Shqipëria, një vend i bekuar me shumë pasuri natyrore e pozicion të lakmueshëm gjeografik, nuk po arrin që të rrisë të ardhurat me ritme më të shpejta se fqinjët dhe shtetet e zhvilluara të BE-së (i ashtuquajtur i konvergencës), duke mbetur më e varfra në Evropë, se bashku me Kosovën.

Nivelin më të lartë të PBB-së për frymë në rajon e ka Mali i Zi, sa 45 për qind e mesatares së BE-së. Pas

TË ARDHURAT PËR BANORË NË EVROPË

## KOSOVA E SHQIPËRIA TË FUNDIT, MAQEDONIA E 95-ta



69	Malaysia	9,415	9,755	10,704	11,339	12,063	12,794	13,607	14,423
70	Argentina	12,709	14,463	10,667	9,055	9,767	10,353	10,926	11,482
71	St. Lucia	9,420	9,607	10,042	10,546	10,903	11,184	11,449	11,724
72	Kazakhstan	7,658	8,762	9,977	10,447	10,998	11,605	12,316	13,153
73	China	8,116	8,643	9,633	10,099	10,971	11,853	12,774	13,780
74	Mexico	8,815	9,319	9,614	9,866	10,282	10,733	11,208	11,705
75	Brazil	8,701	9,896	9,127	9,180	9,560	9,976	10,418	10,885
76	Bulgaria	7,496	8,077	9,080	9,504	10,187	10,841	11,568	12,293
77	Nauru	7,824	8,575	9,037	8,853	8,881	8,906	8,999	9,167
78	Turkey	10,817	10,537	8,716	7,615	8,868	10,017	10,645	11,026
79	Montenegro	7,028	7,678	8,644	8,988	9,538	10,075	10,698	11,275
80	Gabon	7,082	7,373	8,385	8,556	8,922	9,266	9,518	9,948
81	Botswana	6,959	7,584	8,168	8,317	8,693	9,071	9,467	10,050
82	Dominican Republic	7,189	7,478	7,891	8,267	8,673	9,081	9,507	9,966
83	St. Vincent and the G	7,000	7,124	7,506	7,847	8,189	8,550	8,960	9,389
84	Turkmenistan	6,412	6,643	7,412	8,073	8,724	9,485	10,325	11,259
85	Peru	6,178	6,732	7,118	7,362	7,707	8,054	8,419	8,802
86	Thailand	5,970	6,591	7,084	7,570	8,011	8,452	8,907	9,400
87	Dominica	8,220	7,879	6,860	7,626	8,288	8,745	9,128	9,418
88	Serbia	5,428	5,961	6,813	7,199	7,839	8,490	9,211	9,969
89	Colombia	2,900	6,380	6,761	7,049	7,217	7,441	7,729	8,076
90	Libya	2,804	4,740	6,639	7,803	8,356	9,076	9,920	10,916
91	South Africa	5,316	6,180	6,560	6,609	6,801	6,972	7,166	7,346
92	Suriname	5,703	5,870	6,506	6,882	7,201	7,722	7,997	8,356
93	Ecuador	6,046	6,217	6,301	6,278	6,291	6,348	6,426	6,517
94	Belarus	5,022	5,727	6,020	6,372	6,638	6,904	7,209	7,671
95	FYR Macedonia	5,188	5,474	5,951	6,141	6,536	6,917	7,354	7,798
96	Paraguay	5,260	5,600	5,934	6,229	6,559	6,913	7,257	7,663
97	Namibia	4,864	5,589	5,923	6,140	6,514	6,848	7,213	7,578
98	Fiji	5,232	5,528	5,877	6,231	6,607	7,005	7,421	7,868
99	Iraq	4,505	4,950	5,793	6,117	6,210	6,318	6,455	6,607
100	Bosnia and Herzegovina	4,808	5,181	5,704	5,917	6,338	6,751	7,233	7,731
101	Jamaica	4,956	5,193	5,393	5,476	5,686	5,919	6,170	6,434
102	Albania	4,132	4,543	5,201	5,448	5,880	6,338	6,834	7,393
103	Islamic Republic of Ir	5,027	5,290	5,222	4,006	4,052	4,153	4,285	4,412
104	Belize	4,842	4,806	4,830	4,890	4,932	4,961	4,995	5,035

Mali të Zi, renditet Serbia dhe Maqedonia, ku të ardhurat për frymë janë sa 37 për qind e mesatares europiane. Edhe për Konsumin Aktual Individual (ACI), një tregues i mirëqenies materiale të familjeve në

Evropë, Shqipëria është e fundit, me 37 për qind të mesatares së Bashkimit Evropian. Nivelin më të lartë të këtij treguesi në rajon e ka Mali i Zi, ku Konsumi Aktual Individual është sa 56 për qind e mesatares së BE-së

(dyfish më shumë se Shqipëria). Më pas renditet Serbia, ku treguesi ACI është sa 47 për qind e mesatares europiane. Maqedonia dhe Bosnja kanë të njëjtin nivel të treguesit të Konsumit aktual Individual më 41 për qind. Shteti që ka të ardhurat për frymë më të larta në botë është Luksemburgu, me rreth 114 mijë dollarë të vlerësuar për 2018-n, sipas shifrave të FMN-së.

Në vend të dytë është Zvicra, me 83.5 mijë dollarë, e ndjekur nga Norvegjia me 82 mijë dollarë, Makao në Kinë me 81.5 mijë, Islanda me 75.7 mijë dollarë. Më pas në listë renditen Irlanda, Katari, Shtetet e Bashkuara, Singapori dhe dhjetëshja myllet nga Danimarka, shkruan 'monitor'. Në kontrast, shtetet me të ardhura më të ulëta për frymë janë Burundi dhe Sudani i Jugut, me rreth 307 dollarë për frymë secili.

PUBLIKOHET RAPORTI I RI I EUROSTAT-it

## SHQIPTARËT REKORDER PËR LEJE QËNDRIMI NË BE

Pas Shqipërisë, për 2017-n me numrin më të lartë lejesh qëndrimi të lëshuara renditet Serbia, ku rreth 40 mijë qytetarë të saj u pajisën për herë të parë me leje qëndrimi nga vendet e BE-së. Shtetasve të Maqedonisë iu lëshuan rreth 16 mijë leje qëndrimi nga vendet e BE-së, ku edhe këtu mbizotëronin lejet e qëndrimit për arsye familjare

Bruksel, 25 tetor - Në dhjetë vitet e fundit 560 mijë shqiptarë janë pajisur për herë të parë me leje qëndrimi në vendet e Bashkimit European, sipas të dhënave të pu-

blikuara nga Eurostat. Numri i shqiptarëve që janë pajisur me leje qëndrimi në 10 vitet e fundit në vendet e BE-së, përllogaritet të jetë sa 19.5% e popullsisë aktuale të Shqipërisë, bazuar kjo në të dhënat e Eurostat për lejet e qëndrimit, INSTAT për popullsinë.

Sipas të dhënave të Eurostat, pjesa më të madhe të lejeve të qëndrimit është lëshuar për arsye familjare. Shqipëria ka shënuar rekord për numrin e lejeve të qëndrimit në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit, ku prej 2008-s qytetarët shqiptarë kanë kryesuar për numrin e tyre. Rekordin e lejeve të qëndrimit të lëshuara për herë të parë këto 10 vjet u shënuan në 2008-ën, ku sipas Eurostat, u pajisën me leje qëndrimi gati 100 mijë shqiptarë. Më pas numri lejeve hyri në trend rënës, ku në 2013

kapi nivelin më të ulët prej 31 mijë aplikimesh, por duke mbajtur rekordin në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Pas 2013-s numri i lejeve të qëndrimit u rrit sërish, nga 2014 deri 2017-n u pajisën me leje qëndrimi për herë të parë rreth 200 mijë shqiptarë. Kjo përkon me valën e re të emigracionit, ku aplikimet për azil në 2015-n arritën mbi 60 mijë. Në vitin 2017, numri i lejeve të qëndrimit të lëshuara për shqiptarët nga vendet e BE-së ishte 51 mijë e 600, ku rreth 29 mijë u dhanë për arsye familjare, rreth 2000 për arsye shkollimi dhe 5 mijë për punë.

Pas Shqipërisë, për 2017-n me numrin më të lartë lejesh qëndrimi të lëshuara renditet Serbia, ku rreth 40 mijë qytetarë të saj u pajisën për herë të parë me leje qën-

drimi nga vendet e BE-së. Në ndryshim nga qytetarët shqiptarë pjesa më e madhe e serbëve kanë marrë lejet e qëndrimit për arsye punësimi, rreth 17 mijë, 13 mijë për arsye familjare dhe 2400 për arsye shkollimi. Në vend të tretë, për numrin më të lartë të lejeve të qëndrimit renditet Kosova, ku sipas të dhënave në databazën e Eurostat vetëm gjatë 2017-s janë marrë rreth 26 mijë leje të reja qëndrimi, pjesa më e madhe e të cilave janë lëshuar për arsye familjare. Ndërsa shtetasve të Maqedonisë iu lëshuan rreth 16 mijë leje qëndrimi nga vendet e BE-së, ku edhe këtu mbizotëronin lejet e qëndrimit për arsye familjare. Në rajon numrin më të ulët të lejeve të qëndrimit e ka Mali i Zi, ku sipas Eurostat, u pajisën në 2017-n 2500 qytetarë.

## Aktiviteti kreditor i sektorit bankar rritet për 2.7 për qind

Shkup, 25 tetor - Pas rënies së realizuar sezonale në tremujorin e parë të vitit, aktiviteti kreditor i sektorit bankar në kuartalin e dytë realizoi rritje prej 2.7 për qind, kumtoi dje Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (BPRM). Sipas Raportit për rreziqet në sistemin bankar që e aprovoi sot Këshilli i BPRM-së, kontribut më të madh për rritjen e aktivitetit në tregun kreditor pati sektori "amvisëri", por edhe kreditimi i sektorit korporativ ishte solid dhe pati kontribut të konsiderueshëm drejt ndryshimit për kuartalin të aktivitetit kreditor. Rritja prej 2,5 për qind tek depozitat në kuartalin e dytë del prej depozitave të ndërmarrjeve, me kontribut të mëtejshëm pozitiv dhe të depozitave të amvisërive.

Në kuartalin e dytë, rritja e kredive jonfunktionale ishte 2,1 për qind dhe ishte më se e pranishme në portfolion kreditor korporativ të bankave. Rritja kuartale e kredive jofunkionale të amvisërive u përshpejtua deri në nivelin prej tre për qind për çka kontribut më të madh dhanë kreditë konsumatore të miratuara në afat më të gjatë. Për shkak të rritjes solide të aktivitetit kreditor të bankave, pjesëmarrja e jofunksionaliteteve në kreditë e përgjithshme në tremujorin e dytë të vitit nuk ndryshoi në raport me kuartalin paraparak dhe është 5,1 për qind. Në Raportin e aprovuar është shënuar edhe se solvenca apo aftësia pagesore e sistemit bankar shënon përmirësim të vogël, me ç'rast norma e përshtatshmërisë së kapitalit arriti 16,5 për qind. Ekspozimet e drejtpërdrejta të sistemit bankar në rrezik valutor dhe rrezik prej ndryshimit të normave të interesit në portfolion e aktiviteteve bankare akoma janë të vogla dhe marrin pjesë me 6.5 dhe 4.9 për qind. Në seancë, Këshilli i shqyrtoi dhe e aprovoi edhe Vendimin për rezervë të obligueshme, në të cilin ndryshimet kanë të bëjnë me rezervën e obligueshme për bankat afariste që ruhet në euro.

Ndërlikime të karakterit teknik dhe korigjimet sa i takon porosive për pajisjet skenike kanë qenë disa prej arsyeve që sollën një tjetër spostim të datave të parashikuara për përfundimin e projektit për rikonstruktimin e Teatrit Shqiptar. "Tani kur gjërat po finalizohen, do të ishte mëkat të përshpejtojmë lindjen e krijesës së re, që ka kohë që e presim ne dhe publiku ynë...", thotë drejtori Karaga

SHTYHET INAUGURIMI

# NGA TETORI NË JANAR, TEATRI SHQIPTAR ME DATË TË RE



ADEM KARAGA

**Kaloi një periudhë e gjatë dhe e mundimshme për teatrin tonë. Tani kur gjërat po finalizohen, do të ishte mëkat të përshpejtojmë lindjen e krijesës së re, që ka kohë që e presim ne dhe publiku ynë. Ju siguroj që ajo që do të lindë do të justifikojë sakrificën e Teatrit dhe publikut tonë**

Koha Evis HALILI

Shkupi, 25 tetor - Tetori nuk do të jetë muaji i përfundimit të punimeve në Teatrin Shqiptar. Afati për përfundimin e punimeve ndërtime është zhvendosur për në fund të këtij viti, ndërsa në muajin janar të vitit të ardhshëm, do të finalizohet i tërë projekti. Ndërlikime të karakterit teknik dhe korigjime sa i takon porosive për pajisjet skenike kanë qenë disa prej arsyeve që sollën një tjetër spostim të datave të parashikuara për përfundimin e projektit për rikonstruktimin e Teatrit Shqiptar. Sipas drejtorit Adem Karaga, këto janë minutat e fundit të pritjes që do të shfrytëzohen për ta përfunduar si duhet projektin, si nga aspekti ndërtimor, ashtu edhe nga arredimi i brendshëm dhe përzgjedhja e aparaturave me bashkëkohore skenike.

"Kaloi një periudhë e gjatë dhe e mundimshme për teatrin tonë. Tani kur gjërat po finalizohen, do të ishte mëkat të përshpejtojmë lindjen e krijesës së re, që ka kohë

## 2019, VITI I TEATRIT SHQIPTAR

Gjatë këtij viti, aktivitetin e limituar skenik që e zhvillon brenda Teatrit të Komedisë prej disa vitesh, Teatri Shqiptar e ka kompensuar me pjesëmarrjen në shumë festivale në vend dhe jashtë dhe shpërblimin me një numër rekord çmimesh. Me shfaqjet "C", "Biondi Qeni", "Gratë", "Makbethi", "Gjymtimi", "Shfaqja që shkon mbrapsht" dhe "Vdekja e Dantonit", Teatri Shqiptar është prezantuar me dinjitet në skenat e festivaleve në "Flaka e Talias" në Gjilan, Bursë, "Vojdan Çernodrinski" në Manastir, Vera e Ohrit, Festivalin Mbarëkombëtar në Tiranë, Festivali "Martin

Mekdona", në Perm të Rusisë, Festivalin e Dibrës, Festivalin e Komedisë në Kumanovë dhe Festivalin e Tetovës. Është vlerësuar me katër çmime - Shfaqja më e mirë dhe tetë çmime të tjerë për regjinë më të mirë, aktorin më të mirë, e të tjera. Me pjesën "Gratë", gjatë muajit nëntor Teatri Shqiptar do të jetë pjesë e Festivalit "Othello" në Gostivar (8 nëntor) dhe Festivalit "Kadri Roshi" në Cjirrokastër (15 nëntor). Me "Vdekja e Dantonit" në Teatrin Kombëtar të Prishtinës (23 nëntor) dhe me shfaqjen "C" do të prezantohet në Shkup (26 nëntor), Gostivar (27 nëntor) dhe Kërçovë (28 nëntor).

që e presim ne dhe publiku ynë. Ju siguroj që ajo që do të lindë do të justifikojë sakrificën e Teatrit dhe publikut tonë", thotë drejtori Karaga për KOHA.

Për këtë vit, Qeveria ka ndarë për Teatrin Shqiptar një fond prej 338 milionë denarë për përfundimin e punimeve, 88 milionë denarë të akorduara me rebalancin e buxhetit. Zhvendosja e afatit të punimeve ndërtimore nga tetori në

dhjetor është kërkuar nga mbikëqyrësit e projektit, edhe pse në muajin korrik u premtua se dorëzimi i objektit nga kompania e ndërtimit nuk do zgjaste më shumë se tre muaj. Premtimi u bë pas inspektimit të punimeve edhe nga ministri i Kulturës, Asaf Ademi, ministri i tretë i kulturës që bëhet gati të presë shiritin e inaugurimit.

Rikonstruktimi i objektit ka nisur në vitin 2014, nga ish-ministrja

e Kulturës, Elizabeta Kançevska Mileska, i prezantuar si një projekt kapital i Qeverisë. Në muajt e fundit të mandatit të saj, Kançevska premtoi përfundimin e projektit. Të njëjtin premtim e dha edhe ish-ministri i Kulturës, Robert Allagjuzovski dhe përfaqësues të tjerë të Qeverisë. Projekti rikonstruktues hasi në një sërë pengesash, fillimisht punimet u pezulluan që në vitin e parë pas falimentimit të kom-

panisë italiane që duhej të merrej me rikonstruktimin. Më pas, në mungesë të planit fillestar, projektantët hasën në probleme teknike në terren, ndërsa kufizimet financiare dhe buxheti i vogël që i akordohet çdo vit shkaktuan po ashtu zvarritjen e punimeve. Gjatë realizimit të projektit, statika dhe arkitektura e teatrit nuk kanë pësuar ndryshime dhe realizuesit i kanë qëndruar besnik projektit fillestar.

Transformimi i teatrit do të ndodhë në pjesën e instalimeve dhe pajisjet elektrike, maqinorike... përfshirë edhe instalimet për sistemin e sigurisë, ndriçimi, rikonceptimi i enterierit me nuancat që sfumohen nga gri në indigo, ndriçimi led i foajesë, vendosja e disa minishatërvanëve e të tjera.

Kryetari i Komunës së Çairit, Visar Ganiu ndërkohë u shpreh se kjo është vetëm një segment nga shumë projekte tjera të përbashkëta të planifikuara me NP "Parqet dhe gjelbërimet" për rregullimin e hapësirave të gjelbërta përgjatë gjithë territorit të Komunës

## ÇAIRI BËHET ME "PARKUN E GËZIMIT"



ne të Maqedonisë, Bujar Osmani, sot para qytetarëve të Çairit promovuan parkun "Parku i gëzimit" një hapësirë e re e gjelbër në territorin e Komunës së Çairit.

Për dy muaj me radhë ishte punuar në sipërfaqen e parkut prej 3900 m2, duke ia mundësuar të gjitha standardet bashkëkohore.

Gjatë promovimit të parkut, Muça u shpreh se ky park do ti sjell gëzim banorëve të kësaj lagje, ndërsa karakteristikë e veçantë e këtij parku është se lidh tri shkolla dhe të njëjtin mund ta shfrytëzojnë edhe pacientët e poliklinikës së Çairit pasi është në afërsi të saj. Kryetari i Komunës së Çairit, Visar

Ganiu ndërkohë u shpreh se kjo është vetëm një segment nga shumë projekte tjera të përbashkëta të planifikuara me NP "Parqet dhe gjelbërimet" për rregullimin e hapësirave të gjelbërta përgjatë gjithë territorit të Komunës. Si shtoi se vetëm me kontribut të këtyre të përbashkët institucional, Çairi do të jetë çdo ditë më i bukur dhe më i pastër.

"Nuk do të ndalemi këtu, kemi edhe shumë projekte tjera për të bërë, duke synuar të realizojmë atë të cilën e kemi premtuar në kohën e zgjedhjeve. Do të investojmë në parqe dhe do të krijojmë hapësira të reja të gjelbërta, mirëpo presim që të njëjtat të ruhen nga ana e qytetarëve. Ndërkaq siç jemi zotuar gjatë zgjedhjeve, prioritet i komunës tonë do të mbetet gjelbërimi dhe largimi i zonave të uzur-

puara. Njëkohësisht punojmë edhe në zgjidhjen e shumë problemeve tjera që e tangojnë komunën tonë", tha Ganiu.

Komuna e Çairi për një kohë të gjatë has në mungesë të zonave të gjelbërta dhe rritje të ndërtimeve të objekteve, por siç theksoi Ganiu, nga komuna do të kërkojnë që në planet detale të ndërtimit të parashihen gjelbërime dhe parkingje, sepse vetëm në këtë mënyrë do të mund të investojnë dhe ndërtojnë në Komunën e Çairit.

Drejtori Muça ndërkaq paralajmëroi se në Çair do të realizohen edhe pesë projekte tjera, të cilat do të fillojnë në ndërkohë, duke apeluar njëkohësisht deri tek qytetarët që ti mbështesin dhe të kujdesen, sepse te gjitha këto hapësira të gjelbërta janë në të mirë të tyre.

Koha Remzije BILALI

Shkup, 25 tetor - Kryetari i Komunës së Çairit, Visar Ganiu, së bashku me drejtorin e Ndërmarrjes Publike "Parqe dhe gjelbërimet" - Shkup, Ardijan Muça dhe zëvendëskryeministrin për çështje evropia-

Në bazë të nenit 46, 47, 48 dhe nenit 49 të Ligjit për shfrytëzimin dhe disponimin me sendet në pronësi të shtetit dhe me sendet në pronësi të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/15..21/18) dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 44-8614/1 nga data 2 tetor të vitit 2018, Komisioni për disponim me sendet e tundshme dhe të patundshme në pronësi të Republikës së Maqedonisë, shfrytëzues Ministria e Financave e publikon këtë:

### SHPALLJE nr. 4/2018

#### për shitjen e parë të sendeve të tundshme me anë të ankandit publik elektronik

#### I. LËNDA E SHITJES ME ANË TË ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

1. Lëndë të shitjes janë sende të tundshme - automjete motorike udhëtimi edhe atë:

Nr.r	Marka e automjetit	Lloji	Regjistrimi	Viti i prodhimit	Numri i shasisë	Fuqia e motorit	Vendet ulëse	Ngjyra e karrocierisë	Vlera e vlerësuar
1	Seat	Ibiza	SK-234-KH	2000	VSSZZZ6K1R161295	44	5	E kaltër metalike /99	24.500,00
2	Seat	Ibiza	SK-314-KH	2001	VSSZZZ6KZ1R249146	44	5	E kaltër 91	24.500,00
3	Seat	Ibiza	SK-362-KD	2000	VSSZZZ6Z1R130400	44	5	E kaltër e mbyllur metalike /99	30.650,00
4	Seat	Ibiza	ST-009-OS	2001	VSSZZZ6KZ 172539	44	5	E kaltër e mbyllur /99	18.400,00
5	Seat	Ibiza	SK-347-KI	2000	VSSZZZ6KZ1R 162612	44	5	E kaltër e mbyllur /98	24.500,00
6	Seat	Ibiza	KU-8972-AC	2000	VSSZZZ6KZ1R 171175	44	5	E kaltër /91	24.500,00
7	Opel	Astra	SK-975-NO	2002	WOLOTGF6925261275	55	5	E gjelbër metalike 43	27.550,00
8	Mercedes	E - 200	SK-402-JI	2000	WDB2100351B080136	100	5	E gjelbër e mbyllur metalike 43	58.300,00
9	Volkswagen	Passat	SK-2158-AE	1999	WWWZZZ3BZYE250412	110	5	E zezë /20	61.150,00
10	Fiat	Punto	ST-367-RD	1997	ZFA17600000807304	40	5	E kuqe /74	22.350,00
11	Fiat	Punto	ST-959-IR	1997	ZFA17600000811369	40	5	E bardhë 01	17.900,00
12	Skoda	Felicija	ST-200-ME	1996	TMBEEA614-TO246272	43	5	E gjelbër e mbyllur /36	21.350,00

Të përfshira në Vendimin për shitjen e sendeve të tundshme të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr.44-8614/1 nga data 2 tetor të vitit 2018.

#### 1.1. Çmimi fillestar:

Çmimi fillestar i sendit të tundshëm në ankandin publik elektronik nga Nr.r 1 është 24.500,00 denarë. Çmimi fillestar i sendit të tundshëm në ankandin publik elektronik nga Nr.r 2, është 24.500,00 denarë. Çmimi fillestar i sendit të tundshëm në ankandin publik elektronik nga Nr.r 3 është 30.650,00 denarë. Çmimi fillestar i sendit të tundshëm në ankandin publik elektronik nga Nr.r 4 është 18.400,00 denarë. Çmimi fillestar i sendit të tundshëm në ankandin publik elektronik nga Nr.r 5 është 24.500,00 denarë. Çmimi fillestar i sendit të tundshëm në ankandin publik elektronik nga Nr.r 6 është 24.500,00 denarë. Çmimi fillestar i sendit të tundshëm në ankandin publik elektronik nga Nr.r 7 është 27.550,00 denarë. Çmimi fillestar i sendit të tundshëm në ankandin publik elektronik nga Nr.r 8 është 58.300,00 denarë. Çmimi fillestar i sendit të tundshëm në ankandin publik elektronik nga Nr.r 9 është 61.150,00 denarë. Çmimi fillestar i sendit të tundshëm në ankandin publik elektronik nga Nr.r 10 është 22.350,00 denarë. Çmimi fillestar i sendit të tundshëm në ankandin publik elektronik nga Nr.r 11 është 17.900,00 denarë. Çmimi fillestar i sendit të tundshëm në ankandin publik elektronik nga Nr.r 12 është 21.350,00 denarë.

#### 1.2. Garancia bankare:

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 490,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendit të tundshëm nga Nr.r.1.

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 490,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendit të tundshëm nga Nr.r.2.

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 613,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendit të tundshëm nga Nr.r.3.

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 368,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendit të tundshëm nga Nr.r.4.

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 490,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendit të tundshëm nga Nr.r.5.

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 490,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendit të tundshëm nga Nr.r.6.

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 551,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendit të tundshëm nga Nr.r.7.

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 1.166,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendit të tundshëm nga Nr.r.8.

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 1.223,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendit të tundshëm nga Nr.r.9.

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 447,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendit të tundshëm nga Nr.r.10.

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 358,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendit të tundshëm nga Nr.r.11.

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 427,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendit të tundshëm nga Nr.r.12.

#### 1.3. Data e mbajtjes së ankandit publik:

Ankandi publik për shitjen e sendeve të tundshme nga pika 1 do të realizohet në formë elektronike në datë 15.11. 2018, me fillim në ora 10:00.

#### 1.4. RISHIKIMI I SENDEVE TË TUNDSHME

Të gjithë subjektet e interesave mund të kenë informacion të menjëhershëm të sendeve të tundshme pas njoftimit dhe marrëveshjes në tel. 02 3255629, person për kontakt Bilent Mustafoski - bilent.mustafoski@finance.gov.mk.

#### II. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik kanë të gjithë personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj që mund të fitojnë të drejtën e pronësisë të sendeve të patundshme në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin.

#### III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK

Paraqitja për pjesëmarrje në ankandin publik bëhet në formë elektronike në këtë faqe të internetit: [e-aukcii.finance.gov.mk](http://e-aukcii.finance.gov.mk)

Parashtruesit duhet të dorëzojnë edhe këto dokumente:

- **për Nr.r. 1:** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendit të tundshëm në vlerë prej **490,00 denarë** me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- **për Nr.r. 2:** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendit të tundshëm në vlerë prej **490,00 denarë** me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- **për Nr.r. 3:** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendit të tundshëm në vlerë prej **613,00 denarë** me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- **për Nr.r. 4:** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendit të tundshëm në vlerë prej **368,00 denarë** me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- **për Nr.r. 5:** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendit të tundshëm në vlerë prej **490,00 denarë** me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- **për Nr.r. 6:** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendit të tundshëm në vlerë prej **490,00 denarë** me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- **për Nr.r. 7:** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendit

të tundshëm në vlerë prej **551,00 denarë** me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- **për Nr.r. 8:** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendit të tundshëm në vlerë prej **1.166,00 denarë** me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- **për Nr.r. 9:** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendit të tundshëm në vlerë prej **1.223,00 denarë** me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- **për Nr.r. 10:** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendit të tundshëm në vlerë prej **447,00 denarë** me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- **për Nr.r. 11:** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendit të tundshëm në vlerë prej **358,00 denarë** me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë; dhe

- **për Nr.r. 12:** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendit të tundshëm në vlerë prej **427,00 denarë** me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

Si dhe:

a) **për personat juridikë**

- gjendja rrjedhëse nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht dokument adekuat i lëshuar nga organi përkatës nga shteti ku është regjistruar subjekti juridik jo më i vjetër se 6 muaj nga dita e lëshuar;

b) **për personat fizikë**

- kopje të letërnjoftimit valid apo të dokumentit të udhëtimit.

**Garanci bankare në vlerë prej 490,00 për sendin e tundshëm nga pika Nr.r. 1**  
**Garanci bankare në vlerë prej 490,00 për sendin e tundshëm nga pika Nr.r. 2**  
**Garanci bankare në vlerë prej 613,00 për sendin e tundshëm nga pika Nr.r. 3**  
**Garanci bankare në vlerë prej 368,00 për sendin e tundshëm nga pika Nr.r. 4**  
**Garanci bankare në vlerë prej 490,00 për sendin e tundshëm nga pika Nr.r. 5**  
**Garanci bankare në vlerë prej 490,00 për sendin e tundshëm nga pika Nr.r. 6**  
**Garanci bankare në vlerë prej 551,00 për sendin e tundshëm nga pika Nr.r. 7**  
**Garanci bankare në vlerë prej 1.166,00 për sendin e tundshëm nga pika Nr.r. 8**  
**Garanci bankare në vlerë prej 1.223,00 për sendin e tundshëm nga pika Nr.r. 9**  
**Garanci bankare në vlerë prej 447,00 për sendin e tundshëm nga pika Nr.r. 10**  
**Garanci bankare në vlerë prej 358,00 për sendin e tundshëm nga pika Nr.r. 11**  
**Garanci bankare në vlerë prej 427,00 për sendin e tundshëm nga pika Nr.r. 12,**  
**deri në afatin e fundit për paraqitje dorëzohet edhe në formë të shkruar (në origjinal) deri te Komisioni për disponimin me sendet e tundshme dhe të patundshme në pronësi të Republikës së Maqedonisë, shfrytëzues Ministria e Financave, në adresë rr. „Dame Gruëv”nr. 12, Shkup, me vërejtje në zarf “MOS HAP”**

#### IV. AFATI PËR PARAQITJE

Për pjesëmarrje në ankandin publik, pjesëmarrësit duhet të paraqiten në formë elektronike deri në fund të ditës së 14-të, llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes në gazetën ditore dhe në faqen e internetit, respektivisht duke përfshirë edhe datën 09.11.2018.

Komisioni në afat prej tre ditësh pas mbarimit të kohëzgjatjes së shpalljes, të gjithë parashtruesve të cilët në sistemin e ankandit publik elektronik janë paraqitur me të gjitha dokumentet e duhura, të cekura në pikën III të shpalljes, do u dorëzojë shifër (fjalëkalim) dhe emër shfrytëzuesi për pjesëmarrje në ankandin publik, ndërsa parashtruesve të cilët nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë do u dërgojë njoftim me arsyetimin se nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.

#### V. MËNYRA DHE PROCEDURA PËR ZBATIMIN E ANKANDIT PUBLIK

1. Ankandi publik zbatohet në pajtim me dispozitat në nenin 26, 48 dhe 49 nga Ligji për shfrytëzimin dhe disponim me sendet në pronësi të shtetit dhe me sendet në pronësi të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/15..21/18).

2. Që ankandi publik të realizohet nevojitet të ketë së paku një pjesëmarrës.

3. Për ofrues më të volitshëm në ankandin publik konsiderohet pjesëmarrësi i cili ka ofruar çmimin e fundit, që paraqet vlerën më të lartë për shitje të sendeve të tundshme.

4. Ofruesi më i volitshëm është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim për zgjedhje, të paguajë mjete në pajtim me çmimin e arritur përfundimtar nga ankandi, në të kundërtën nuk do të vazhdohet me lidhjen e kontratës, ndërsa garancia bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe ofruesi në periudhë prej 1 viti nuk do mund të marrë pjesë në cilin do ankand publik të ardhshëm për sendet e tundshme.

5. Bartësi i të drejtës së pronësisë me ofruesin më të volitshëm, do të lidh kontratë për shitblerje në afat prej 15 ditë pune pas kryerjes së pagesës së çmimit të sendeve të tundshme.

Shpenzimet materiale për solemnizim të marrëveshjes për shitblerje të sendeve të tundshme, do ti mbulojë blerësi - ofruesi më i volitshëm.

6. Pjesëmarrësit në ankand publik kanë të drejtë ankese vetëm në raport me procedurën e ankandit publik. Ankesa dorëzohet tek Komisioni në afat prej 3 ditësh nga dita e mbajtjes së ankandit publik. Komisioni vendos lidhur me ankesën me vendim në afat prej 5 ditësh nga pranimi i ankesës. Kundër vendimit të Komisionit mund të paraqitet ankesë tek Komisioni Shtetëror për Vendim-marrje në Procedurë Administrative dhe procedura e punës në shkallën e dytë.

#### IV. FAQJA E INTERNETIT KU DO TË MBAHET ANKANDI PUBLIK

Ankandi publik do të realizohet në mënyrë elektronike në këtë faqe të internetit:

[e-aukcii.finance.gov.mk](http://e-aukcii.finance.gov.mk)

Komisioni për disponim me sendet e tundshme dhe sendet e patundshme në pronësi të Republikës së Maqedonisë shfrytëzues Ministria e Financave



Në bazë të nenit 22, 23 dhe nenit 24 të Ligjit për shfrytëzim dhe disponim me sendet në pronësi të shtetit dhe me sendet në pronësi të komunës („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 78/15...21/18) dhe Vendimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 44-3856/1 nga data 10 korrik të vitit 2018, nr. 44-6013/1 nga data 10 korrik të vitit 2018, nr. 44-5273/1 nga data 19 qershor të vitit 2018 dhe nr. 44-6990/1 nga data 22 gusht të vitit 2018, Komisioni për disponim me sendet e tundshme dhe sendet e patundshme në pronësi të Republikës së Maqedonisë, shfrytëzues Ministria e Financave e publikon këtë:

SHPALLJE nr. 3/2018

për shitjen e parë të sendeve të patundshme në Ohër, Prilep, Tetovë dhe Kërçovë me anë të ankandit publik elektronik

### I. LËNDA E SHITJES PËRMES ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

1. Lëndë e shitjes janë sende të patundshme që gjenden në Ohër në PK. nr. 1586 pjesa 1, v.th. „Dupki”, të regjistruara në Fletën e pronësisë nr. 596 për KK Ramne edhe atë:

- Ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 4, kati BO, numër 1, dedikimi për pjesë të veçantë/të përbashkët nga ndërtesa BA, me sipërfaqe prej 18 m<sup>2</sup>.

- Ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 1, kati PR, nr 1, dedikimi për pjesë të veçantë/të përbashkët nga ndërtesa BA, me sipërfaqe prej 47 m<sup>2</sup>.

- Ndërtesa 2, dedikimi i ndërtesës A1-1, hyrja 1, kati PR, nr 1, dedikimi për pjesë të veçantë/të përbashkët nga ndërtesa G, me sipërfaqe prej 19 m<sup>2</sup>.

- Ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, kati PR, numër 1, dedikimi për pjesë të veçantë/të përbashkët nga ndërtesa SN, me sipërfaqe prej 24 m<sup>2</sup>.

- Ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 2, kati PR, numër 1, dedikimi për pjesë të veçantë/të përbashkët nga ndërtesa HN, me sipërfaqe prej 21 m<sup>2</sup>.

- Ndërtesa 1, ndërtimi për ndërtesën A1-1, hyrja 3, kati K1, numër 2, dedikimi për pjesë të veçantë/të përbashkët nga ndërtesa BA, me sipërfaqe prej 60 m<sup>2</sup> dhe

- Ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 3, kati K1, numër 2, dedikimi për pjesë të veçantë/të përbashkët nga ndërtesa SN, me sipërfaqe prej 24 m<sup>2</sup>.

Të përfshira në Vendimin për shitjen e sendeve të patundshme në Ohër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 44-3856/1 nga data 10 korrik të vitit 2018.

#### 1.1. Çmimi fillestar:

Çmimi fillestar i sendeve të patundshme nga pika 1, në ankandin publik elektronik është 3.748.591,00 denarë.

#### 1.2. Garancia bankare:

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 74.972,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendeve të patundshme nga pika 1.

#### 1.3. Data e mbajtjes së ankandit publik:

Ankandi publik për shitjen e sendeve të patundshme nga pika 1 do të realizohet në formë elektronike në datë 15.11.2018, me fillim në ora 11:00.

1.4. Në përputhje me shkresën e Komunës së Ohrit nr. 20-10722/2 të datës 24.08.2018 për PK nr.1586/1, KK Ramne sipas ekstraktit nga dokumentacioni planor urbanistik, dedikimi i ndërtimit është shtëpi individuale banimi.

Vlera e përgjithshme e vlerësuar të sendeve të patundshme të përcaktuara në pikën 1 është 3.748.591,00 denarë.

2. Lëndë e shitjes janë sende të patundshme që gjenden në Prilep në rr. “P. Koteska” të regjistruara në Fletën e pronësisë nr. 32540 për KK Prilep edhe atë:

- Ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën- objekt në menaxhim tjetër, hyrja 1, kati PR, me sipërfaqe prej 21 m<sup>2</sup>, të PK. nr. 21471, pjesa 3 dhe

- Ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën- objekt në menaxhim tjetër, hyrja 1, kati PR, me sipërfaqe të brendshme prej 21 m<sup>2</sup> në PK. nr. 21471, pjesa 4.

Të përfshira në Vendimin për shitjen e sendeve të patundshme në Prilep të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 44-6013/1 nga data 10 korrik të vitit 2018.

#### 2.1. Çmimi fillestar:

Çmimi fillestar i sendeve të patundshme nga pika 2, në ankandin publik elektronik është 528.215,00 denarë.

#### 2.2. Garancia bankare:

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 10.564,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendeve të patundshme nga pika 2.

#### 2.3. Data e mbajtjes së ankandit publik:

Ankandi publik për shitjen e sendeve të patundshme nga pika 2 do të realizohet në formë elektronike në datë 15.11.2018, me fillim në ora 12:00.

2.4. Në përputhje me shkresën e Komunës së Prilepit nr. 10-1317/3 të datës 16.08.2018 për PK. 21471/3 dhe PK. nr. 21471/4, KK Prilep sipas ekstraktit nga dokumentacioni planor urbanistik ndërtim, dedikimi për ndërtimin është hapësirë afariste dhe pjesa tjetër hapësirë publike.

Vlera e përgjithshme e sendeve të patundshme të vendosura në pikën 2 është 528.215,00 denarë.

3. Lëndë e shitjes janë sende të patundshme që gjenden në Tetovë në PK nr. 5578 v.th. Kllukovë, të regjistruara në Fletën e pronësisë nr. 35084 për KK Tetovë-2 edhe atë:

- Ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën - objekt jashtë biznesit afarist, hyrja nr.1, kati 1 me sipërfaqe prej 503 m<sup>2</sup>.

- Ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën - objekt jashtë biznesit afarist, hyrja nr.1, kati PO me sipërfaqe prej 502 m<sup>2</sup>.

- Ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën - objekt jashtë biznesit afarist, hyrja nr.1, kati PR në sipërfaqe prej 502 m<sup>2</sup> dhe

- Ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën - llozha, ballkone dhe terraca, hyrja nr.1, kati PR me sipërfaqe prej 10 m<sup>2</sup>.

Të përfshira në Vendimin për shitje të sendeve të patundshme në Tetovë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 44-5273/1 nga data 19 qershor të vitit 2018.

#### 3.1. Çmimi fillestar:

Çmimi fillestar i sendeve të patundshme nga pika 3, në ankandin publik elektronik është 46.284.194,00 denarë.

#### 3.2. Garancia bankare:

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 925.684,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendeve të patundshme nga pika 3.

#### 3.3. Data e mbajtjes së ankandit publik:

Ankandi publik për shitjen e sendeve të patundshme nga pika 3 do të realizohet në formë elektronike në datë 15.11.2018, me fillim në ora 13:00.

3.4. Në përputhje me shkresën e Komunës së Tetovës nr. 10-2413/2-1 të datës 01.03.2018 për PK nr. 5578, KK Tetovë-2 sipas ekstraktit nga dokumentacioni planor urbanistik, dedikimi për ndërtimin është biznes i vogël.

Vlera e përgjithshme e sendeve të patundshme të vendosura në pikën 3 është 46.284.194,00 denarë.

4. Lëndë e shitjes janë sende të patundshme që gjenden në Kërçovë në PK nr. 5984, pjesa 4, rr.“Pod Krushinë” të regjistruara në Fletën e pronësisë nr. 57051 për KK Kërçovë 9 edhe atë:

- Ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën B4, hyrja 1, PR, dedikimi për pjesë të veçantë/të përbashkët nga ndërtesa HA, me sipërfaqe prej 75 m<sup>2</sup>.

- Ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën B4, hyrja 1, BO, dedikimi për pjesës të veçantë/të përbashkët nga ndërtesa P, me sipërfaqe prej 38 m<sup>2</sup>.

Të përfshira në Vendimin për shitjen e sendeve të patundshme në Kërçovë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 44-6990/1 nga data 22 gusht të vitit 2018.

#### 4.1. Çmimi fillestar:

Çmimi fillestar i sendeve të patundshme nga pika 4, në ankandin publik elektronik është 1.015.980,00 denarë.

#### 4.2. Garancia bankare:

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 20.320,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendeve të patundshme nga pika 4.

#### 4.3. Data e mbajtjes së ankandit publik:

Ankandi publik për shitjen e sendeve të patundshme nga pika 4 do të realizohet në formë elektronike në datë 15.11.2018 me fillim në ora 14:00.

4.4. Në përputhje me shkresën e Komunës së Kërçovës nr. 10-2255/2 të datës 04.09.2018 për PK nr. 5984/4, KK Kërçovë 9 sipas ekstraktit nga dokumentacioni planor urbanistik dedikimi për ndërtimin është zonë punuese (shërbime, deponi, biznes i vogël).

Vlera e përgjithshme e sendeve të patundshme të vendosura në pikën 4 është 1.015.980,00 denarë.

### II. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik kanë të gjithë personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj që mund të fitojnë të drejtën e pronësisë të sendeve të patundshme në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin.

### III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK

Paraqitja për pjesëmarrje në ankandin publik bëhet në formë elektronike në këtë faqe të internetit: [e-aukci.finance.gov.mk](http://e-aukci.finance.gov.mk)

Parashtruesit duhet të dorëzojnë edhe këto dokumente:

- **për pikën 1:** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendeve të patundshme në vlerë prej **74.972,00** denarë me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- **për pikën 2** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendeve të patundshme në vlerë prej **10.564,00** denarë me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- **për pikën 3** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendeve të patundshme në vlerë prej **925.684,00** denarë me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- **për pikën 4** garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendeve të patundshme në vlerë prej **20.320,00** denarë me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

Si dhe:

#### a) për personat juridikë

- gjendja rrjedhëse nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht dokument adekuat i lëshuar nga organi përkatës nga shteti ku është regjistruar subjekti juridik jo më i vjetër se 6 muaj nga dita e lëshuar;

#### b) për personat fizikë

- kopje të letërnjoftimit valid apo të dokumentit të udhëtimit.

**Garanci bankare në vlerë prej 74.972,00 denarë për sendet e patundshme nga pika 1, garanci bankare në vlerë prej 10.564,00 denarë për sendet e patundshme nga pika 2, garanci bankare në vlerë prej 925.684,00 denarë për sendet e patundshme nga pika 3 dhe garanci bankare në vlerë 20.320,00 denarë për sendet e patundshme nga pika 4, deri në afatin e fundit për paraqitje dorëzohet edhe në formë të shkruar (në origjinal) deri te Komisioni për disponimin me sendet e tundshme dhe të patundshme në pronësi të Republikës së Maqedonisë, shfrytëzues Ministria e Financave, në adresë rr. „Dame Gruev”nr.12, Shkup, me vërejtje në zarf “MOS HAP”.**

### IV. AFATI PËR PARAQITJE

Për pjesëmarrje në ankandin publik, pjesëmarrësit duhet të paraqiten në formë elektronike deri në fund të ditës së 14-të, llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes në gazetën ditore dhe në faqen e internetit, respektivisht duke përfshirë edhe datën 09.11.2018.

Komisioni në afat prej tre ditësh pas mbarimit të kohëzgjatjes së shpalljes, të gjithë parashtruesve të cilët në sistemin e ankandit publik elektronik janë paraqitur me të gjitha dokumentet e duhura, të cekura në pikën III të shpalljes, do u dorëzojë shifër (fjalëkalim) dhe emër shfrytëzuesi për pjesëmarrje në ankandin publik, ndërsa parashtruesve të cilët nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë do u dërgojë njoftim me arsyetimin se nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.

### V. MËNYRA DHE PROCEDURA PËR ZBATIMIN E ANKANDIT PUBLIK

1. Ankandi publik zbatohet në pajtim me dispozitat në nenin 26 nga Ligji për shfrytëzim dhe disponim me sendet në pronësi të shtetit dhe me sendet në pronësi të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 78/15...21/18).

2. Që ankandi publik të realizohet nevojitet të ketë së paku një pjesëmarrës.

3. Për ofrues më të volitshëm në ankandin publik konsiderohet pjesëmarrësi i cili ka ofruar çmimin e fundit, që paraqet vlerën më të lartë për shitje të sendeve të patundshme.

4. Ofruesi më i volitshëm është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim për zgjedhje, të paguajë mjete në pajtim me çmimin e arritur përfundimtar nga ankandi, në të kundërtën nuk do të vazhdohet me lidhjen e kontratës, ndërsa garancia bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe ofruesi në periudhë prej 1 viti nuk do mund të marrë pjesë në cilin do ankand publik të ardhshëm për sendet e patundshme.

5. Bartësi i të drejtës së pronësisë me ofruesin më të volitshëm, do të lidh kontratë për shitblerje në afat prej 15 ditë pune pas kryerjes së pagesës së çmimit të sendeve të patundshme.

Tatimin e qarkullimit dhe shpenzimet noteriale për solemnizim të marrëveshjes për shitblerje të sendeve të patundshme, do ti mbulojë blerësi - ofruesi më i volitshëm.

6. Pjesëmarrësit në ankand publik kanë të drejtë ankese vetëm në raport me procedurën e ankandit publik. Ankesa dorëzohet tek Komisioni në afat prej 3 ditësh nga dita e mbajtjes së ankandit publik. Komisioni vendos lidhur me ankesën me vendim në afat prej 5 ditësh nga pranimi i ankesës. Kundër vendimit të Komisionit mund të paraqitet ankesë tek Komisioni Shtetëror për Vendim-marrje në Procedurë Administrative dhe procedura e punës në shkallën e dytë.

### IV. FAQJA E INTERNETIT KU DO TË MBAHET ANKANDI PUBLIK

Ankandi publik do të realizohet në mënyrë elektronike në këtë faqe të internetit:

[e-aukci.finance.gov.mk](http://e-aukci.finance.gov.mk)

Komisioni për disponim me sendet e tundshme dhe sendet e patundshme në pronësi të Republikës së Maqedonisë, shfrytëzues Ministria e Financave

# Evropa të ndryshojë qasjen ndaj Arabisë Saudite



Nga  
Julien Barnes-Dacey

Zhdukja dhe vdekja e mundshme e gazetarit saudit Xhmal Kashogi, na jep një tjetër mesazh të frikshëm mbi gjendjen aktuale të Lindjes së Mesme. Vdekja e tij e pretenduar është tragjike, por thekson ndërkohë edhe shkallën e mosndëshkimit absolut të krimeve, që po përjeton i gjithë rajoni, duke përfshirë edhe një shtet që është ndoshta aleati më i afërt rajonal i Evropës dhe Perëndimit. Arabia Saudite ka mohuar me forcë çdo përfshirje në zhdukjen e Kashogit, por mosdalja e tij nga konsullata saudite e Stambollit, e ka vendosur Riadin në pozitën e një fajtori të dyshuar. Burime të qeverisë turke, pohojnë se ekzistojnë prova që dëshmojnë se gazetari është vrarë brenda në konsullatë.

Në shumë aspekte sjellja e dyshimtë e Arabisë Saudite, është përfaqësuese e më gjerë e dukurisë së përkeqësimit të ndjeshëm të respektimit të normave ndërkombëtare në të gjithë rajonin, dhe madje globalisht, duke marrë parasysh arrestimin e fundit të kreut kinez të Interpolit nga Pekini, dhe të shënjestrimin të pretenduar të Rusisë ndaj qytetarëve të saj në Mbretërinë e Bashkuar.

Nëse vërtetohet të jetë orkestruar nga Arabia Saudite, vrasja e dyshuar e Kashogit, nuk do të përfaqësonte shkeljen më të hapur të këtyre standardeve gjatë viteve të fundit, me natyrën e luftës në Jemen, që meriton një vëmendje shumë më të madhe. Por, duke pasur parasysh afërsinë e marrëdhënies midis shteteve evropiane dhe Arabisë Saudite, skandali i fundit, po i detyron qeveritë evropiane të vënë në pikëpyetje marrëdhëniet e perceptuara si të pakushtëzuara me shtetet e Gjirit. Në tërësi, evropianët kanë të ngjarë të vazhdojnë t'i japin përparësi interesave të perceptuara strategjike dhe ekonomike me Arabinë Saudite.

Por sjellja e vendit arab, po e ekspozon gjithnjë e më shumë dobësinë e konceptit, se përqaftimi është qasja më e mirë. Administrata amerikane, ka refuzuar të ushtrojë presion ndaj Riadit gjatë muajve të fundit, edhe pse Donald Trump po kërkon tani me ngulm përgjigje mbi fatin e Kashogit. Nëse evropianët dështojnë të ushtrojnë një presion të fortë ndaj Riadit, për të marrë një përgjigje më të madhe për veprimet e veta, ata rrezikojnë ta inku-



rajojnë atë drejt zgjedhjeve edhe politikave më të rrezikshme. Qeveritë evropiane, duhet më së paku të kërkojnë që Arabia Saudite të pranojë një hetim të pavarur mbi fatin e Kashogit.

Por një proces i tillë, ka rrezik të përqendrohet më shumë në gjetjen e një rruge të shpëtimit të fytyrës nga kriza, sesa në zbardhjen e asaj që ka ndodhur vërtet. Nëse Riadi i beson vërtet pretendimeve të tij, se nuk ka gisht në zhdukjen e gazetarit, nuk duhet të ketë frikë nga një hetim i pavarur. Por evropianët, duhet ta shoqërojnë këtë qasje me

presion të përtërirë ndaj aleatëve të tyre të ngushtë në Riad, për të hequr dorë nga politikat rajonale kundërproduktive. Kjo nuk do të ishte ndryshe nga mënyra se si evropianët, me të drejtë në mënyrë të vazhdueshme, nxisin vendet e tjera si Irani, të ndalojnë politikat e tyre agresive rajonale. Evropianët nuk kanë qenë miopë ndaj natyrës problematike të disa politikave saudite, por përgjigja e tyre e preferuar, ka qenë pëshpëritja e ndikimit moderues në "veshët" e sauditëve. Princi saudit i kurorës dhe sundimtari de fakto i vendit, Muhamed bin Salman

**Evropianët nuk janë në gjendje të luajnë një rol vendimtar në moderimin e sjelljes saudite, për aq kohë sa administrata amerikane dikton efektivisht sjelljen e sauditëve. Duket se mbështetja e pakushtëzuar amerikane për Arabinë Saudite, e cila bazohet kryesisht mbi një antipati të përbashkët ndaj Iranit, ka nxitur impulset më të këqija të mbretërisë**



(MBS), ka gëzuar një mbështetje të madhe ndërkombëtare që nga viti 2015, kur babai i tij u bë mbret.

Qeveritë perëndimore e shohin MBS-në si mjet për një transferim të qetë breznor të pushtetit, si dhe autor të një programi reformash urgjentisht të nevojshme, të cilat gëzojnë një mbështetje të fortë në vend. Reformat e tij janë përqendruar në thellimin e diversifikimit ekonomik, aq shumë të nevojshëm për të zvogëluar varësinë nga të ardhurat e naftës, si dhe në një shkallë të moderuar të liberalizimit social. Duke iu druajtur një dështimi saudit për të menaxhuar në mënyrë efektive sfidat e brendshme, qeveritë evropiane e kanë mbështetur në tërësi këtë agjendë të brendshme. Por që nga fillimi, është i qartë që ky vizion shoqërohet nga nuanca të forta autoritare, me MBS që të njëjtën kohë i mbyll gojën çdo zëri opozitar në vend.

Kjo ka përfshirë shënjestrimin e atyre, që do të dukeshin më së miri si "motori" i agjendës së deklaruar të reformave, duke përfshirë burgimin e pjesëtarëve të komunitetit të biznesit privat dhe aktivisteve femra, që udhëheqin kauzat për të drejta më të mëdha për gratë. Dhe zhdukja

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 24 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

e gazetarit Kashogi, i përshtatet këtij "modeli". Mbështetës për një kohë të gjatë i sistemit mbretëror saudit, dhe ish-këshilltar i një princi të shquar, Kashogi u shfaq si një kritik i spikatur, megjithëse ende i modruar, i MBS pas largimit vendi i tij në qershorin e vitit 2017. Zhdëkja e tij e dyshuar dhe vrasja e mundshme në Turqi, nëse provohet se është organizuar nga Arabia Saudite, përbën një njollë të rëndë për udhëheqjen saudite.

Nxitja për reformat e brendshme, shoqëron një politikë të jashtme po aq agresive dhe të ashpër që synon përballjen me armiqtë e perceptuar rajonale. Shembulli më i qartë është lufta në Jemen, ku Arabia Saudite ka shqetësimet legjitime të sigurisë, duke pasur parasysh praninë e rebelëve huthi, të mbështetur nga Irani në kufirin e saj jugor.

Por politikat ushtarake të mbretërisë, e kanë çuar shtetin jemenas drejt kolapsit, dhe kanë shkaktuar katastrofën më të rëndë humanitare në botë. Diku tjetër, bllokada e vazhdueshme e Katarit, e udhëhequr nga Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, ka paralizuar Këshillin e Bashkëpunimit të Gjirit, që ishte më parë një nga organet ndërshtetërore më funksionale të rajonit. Thuhet gjithashtu se Riadi mori peng nga Libani, kryeministrin Sad Haririn në vitin 2017, duke e detyruar atë të jepte dorëheqjen - një hap që më vonë u anulua - për shkak të besimit të sauditëve, se qeveria libaneze është nën kontrollin e Iranit. Të mbledhura bashkë, këto vetëm sa kanë shtuar në mënyrë të rrezikshme mosmarrëveshjet rajonale, edhe nëse sauditët i kanë disa shqetësime legjitime.

Hiper-agresiviteti i brendshëm dhe rajonal i vendit, duhet t'i detyrojë politikëbërësit evropianë të vënë në pikëpyetje qasjen e tyre aktuale ndaj Riadit. Por ajo është e kushtëzuar në masë të madhe nga frika se çdo qëndrim më i ashpër, do të prishë marrëdhëniet, duke përfshirë edhe ato në sferën e rëndësishme ekonomike. Evropianët nuk janë në gjendje të luajnë një rol vendimtar në moderimin e sjelljes saudite, për aq kohë sa administrata amerikane dikton efektisht sjelljen e sauditëve. Duket se mbështetja e pakushtëzuar amerikane për Arabinë Saudite, e cila bazohet kryesisht mbi një antipati të përbashkët ndaj Iranit, ka nxitur impulset më të këqija të mbretërisë. Një kërkesë e vendosur dhe e përbashkët evropiane, për një hetim transparent mbi vendndodhjen e Kashogit dhe një përgjigje e përshtatshme në mënyrë të duhur ndaj rezultateve të saj, mund të luajë ende një rol në formësimin e sjelljes së vendit arab. Këtu është e domosdoshme që Britania e Madhe dhe Franca, të cilat janë më afër Arabisë Saudite, të jenë në një front të bashkuar me partnerët evropianë.

Fakti që edhe Trump po bën pyetje në lidhje me këtë episod të fundit, ofron një hapësirë të kufizuar, për të nisur një ndryshim të kursit ndaj Riadit. Kjo është urgjentisht e nevojshme, duke pasur parasysh rrezikun e zmadhimit më të gjerë në rajon të kësaj dukurie. Arabia Saudite mbetet një lojtar jetike, për ata që kërkojnë zgjidhje të qëndrueshme për sfidat e thella të Lindjes së Mesme, dhe Evropa duhet të shtojë përpjekjet e veta, për të gjetur zgjidhje për konfliktet e shumta rajonale. Por vdekja e dyshuar e Kashogit duhet të imponojë një llogaridhënie të vonuar, çka do të thotë se biznesi nuk mund të vazhdojë normalisht nëse politikat e Riadit dëshmojnë kaq shumë të dëmshme për synimin e përbashkët të stabilizimit të Lindjes së Mesme.

(European Council of Foreign Relations)

## Urrejtja që po na konsumon



Nga Alexander SOROS



Jemi shumë larg ditëve kur Senatori John McCain kundërshtoi vetë mbështetësit e tij gjatë fushatës së 2008, për të mbrojtur në mënyrë patriotike kundërshtarin e tij, z.Obama - e gjitha sepse ai besonte që shëndeti i demokracisë sonë, ishte më i rëndësishëm se sa fitoret e tij personale politike. Ne kemi nevojë të gjejmë rrugën drejt një diskursi të ri politik, i cili hedh poshtë demonizimin e të gjithë kundërshtarëve politikë

Të hënën pasdite, një pajisje shpërthyes u dërgua në shtëpinë e babait tim në veri të qytetit të Nju Jorkut. Një pjesëtar vigjilent i stafit pikasi rrezikun dhe telefonoi policinë. Fatmirësisht, autoritetet mundën ta shpërthejnë në mënyrë të sigurt pajisjen. Të mërkurën, Shërbimi i Fshehtë tha se kishte kapur pajisje të ngjashme shpërthyes, që ishin dërguar në zyrat e ish presidentit Barack Obama dhe ish Sekretares së Shtetit, Hillary Clinton. Jemi të gjithë të kënaqur që askush nuk u lëndua, dhe mirënjohës për ata që na ruajtën. Por incidenti ishte thellësisht shqetësues - si kërcënim jo thjesht për sigurinë e familjes sonë, fqinjëve, kolegëve dhe miqve, por edhe të ardhmen e demokracisë amerikane.

Familja ime është mësuar me veprimet armiqësore të atyre që hedhin poshtë filozofinë tonë, politikën tonë dhe vetë identitetin tonë. Im atë u rrit në hijen e regjimit nazist në Hungari. Gjyshi im siguroi dokumenta me emra të rremë, me qëllim që ata t'i mbijetonin mësymjes kundër hebrenjve të Budapestit; ai ndihmoi

shumë të tjerë të bënin të njëjtën gjë. Pas luftës, teksa komunistët morën pushtetin, im atë u arratis për në Londër, ku studioi në London School of Economics, përpara se të niste atë që do të bëhej një karrierë e suksesshme në financë.

Por leksionet e fillimeve të jetës së tij nuk i humbi kurrë. Sipërmarrja e tij më e madhe filantropike, Open Society Foundations, luajti një rol udhëheqës në mbështetjen e tranzicionit nga komunizmi, në shoqëri më demokratike, në disa pjesë të ish Bashkimit Sovjetik dhe më pas u zgjerua për të mbrojtur praktikën demokratike në demokracitë ekzistuese. Im atë e di mirë se puna e tij filantropike, edhe pse jopartiake, është "politike" në një kuptim të gjerë: Ajo synon të mbështesë ata që promovojnë shoqëri ku gjithsecili ka një zë. Ka një listë të gjatë njerëzish që e konsiderojnë këtë propozim të papranueshëm, dhe im atë është përballur me shumë sulme gjatë këtij rrugëtimi, shumë prej tyre të mbushur me helmin e antisemitizmit.

Por diçka ndryshoi në vitin 2016. Më herët, sulmet kundër tij ishin të kufizuar në skajet ekstremiste, mes supremacistëve të bardhë dhe nacionalistëve që kërkonin të lëkundnin vetë themelet e demokracisë. Por me fushatën presidenciale të Donald Trumpit, gjërat u përkeqësuan. Supremacistët e bardhë dhe antisemitistët si Dadid Duke mbështetën fushatën e tij. Në spotin e fundit në televizion të Trumpit spikaste im atë; Janet Yellen, shefja e Federal Reserve; dhe Lloyd Blankfein, shefi i Goldman Sachs - të gjithë hebrenj - në mesin e një gjuhe të ashpër që fliste për "interesa speciale" dhe "interesa speciale globale". Xhindi u lejuar të dalë nga shishja, dhe tani do të duhen shumë breza për ta rifutur, dhe kjo nuk u kufizua vetëm në SHBA.

Në Hungari, Kryeministri Viktor Orban nisi një fushatë antisemitiste me postera, duke akuzuar padrejtësisht tim atë, se donte të mbushte Hungarinë me mi-

grantë. Kjo përfshiu vendosjen e fytyrës së tim eti në dyshemenë e tramvajëve në Budapest, me qëllim që njerëzit të shkelnin mbi të. E gjithë kjo për t'i shërbyer agjendës së Orban. Tani kemi atentate me bombë. Ndërkohë që përgjegjësia është e individit apo individëve që dërguan këto pajisje vdekjeprurëse në shtëpinë time, si dhe në zyrat e Z. Obama dhe Znj. Clinton, unë nuk mund ta shoh të shkëputur nga normalja e re e demonizimit politik, që ka pllakosur sot. Unë padyshim nuk kam iluzionin që urrejtja e drejtuar kundër nesh është unike. Ka shumë njerëz në SHBA dhe përreth botës që kanë ndjerë forcën e kësaj fryme të ligë. Tashmë është bërë shumë "normale" që, njerëzit që thonë atë që mendojnë, të gjenden përballë armiqësive personale, mesazheve plot urrejtje në mediat sociale dhe kërcënimeve me vdekje.

Është bërë gjithashtu normale që organizatat, të cilat bëjnë punë të rëndësishme pro demokracisë të përballen me kërcënime ekzistenciale, për shkak se pranojnë mbështetje nga fondacionet që krijojnë im atë. Dhe gjithashtu është bërë normale që, udhëheqësit politikë të cilët kur marrin detyrën, betohen të mbrojnë të gjithë qytetarët, në vend të kësaj ndjekin një politikë përçarjeje dhe urrejtjeje.

Jemi shumë larg ditëve kur Senatori John McCain kundërshtoi vetë mbështetësit e tij gjatë fushatës së 2008, për të mbrojtur në mënyrë patriotike kundërshtarin e tij, z.Obama - e gjitha sepse ai besonte që shëndeti i demokracisë sonë, ishte më i rëndësishëm se sa fitoret e tij personale politike. Ne kemi nevojë të gjejmë rrugën drejt një diskursi të ri politik, i cili hedh poshtë demonizimin e të gjithë kundërshtarëve politikë. Një hap i parë do të ishte që të votonim për të refuzuar ata politikanë, që janë përgjegjës për tronditjen e institucioneve të demokracisë sonë. Dhe duhet ta bëjmë tani, përpara se të jetë shumë vonë. (New York Times)

**Mungesa e gjumit çon tek mendimet për vetëvrasje!**



Shkencëtarët amerikanë kanë gjetur se sasia e gjumit më pakë se gjashtë orë gjatë natës trefishon mendimet për vetëvrasje të rinjtë e moshës nga 13 deri në 19 vjeç.

Gjatë studimit, rezultatet e të cilat janë publikuar në revistën "JAMA Pediatrics", janë përdorur të dhënat e Hulumtimit i Sjelljeve të Rrezikshme të Rinjtë të kryer në mes të shkurtit të vitit 2007 dhe majit të vitit 2015. Në studim, pjesëmarrësit janë ndarë në tre grupe, persona që flenë tetë orë ose më shumë, shtatë orë dhe gjashtë orë ose më pak, ndërsa janë analizuar sjelljet e konsideruara si shumë të rrezikshme të këto grupe. Në studim u konstatua se të rinjtë që flenë më pak se gjashtë orë në natë, në krahasim me ata që flenë tetë orë ose më shumë, kanë tre herë më shumë sjellje të rrezikshme, siç janë mendimet për vetëvrasje, planifikimi ose tentativa për vetëvrasje. Studimi ka analizuar edhe sjellje të tjera të rrezikshme, siç janë drejtimi i makinës në gjendje të dehur, përdorimi i alkoolit, duhanit dhe lëndëve narkotike, si dhe agresiviteti. Ndryshe, Hulumtimit i Sjelljeve të Rrezikshme të Rinjtë ka treguar se mbi 70 për qind e të rinjve të shkollave të mesme flenë më pak se tetë orë.

# VITAMINA B12, PËR ÇFARË SHËRBEN DHE NË ÇFARË USHQIMESH GJENDET

Është e vështirë të kesh një mangësi të vitaminës B12, sepse grumbullohet në trup për shumë vite. Megjithatë, ato mund të arrijnë një mangësi të kësaj vitamine për shkak të dietës së tyre të bazuar në ushqimet bimore, duke mos marrë sasinë e duhur

Vitamina B12 është e domosdoshme për trupin tonë, sidomos për shëndetin e mirë të sistemit nervor, por jo vetëm! Le të shohim për çfarë shërben kjo dhe cilat janë rreziqet e mungesës. Vitamina B12, është pjesë e kompleksit të vitaminave B dhe merret nga trupi ynë përmes ushqimit. Funksioni i saj kryesor është të mbajë qelizat nervore të shëndetshme dhe të ndihmojë rritjen e qelizave të kuqe të gjakut, duke parandaluar aneminë. Ushqimet që përmbajnë vitaminën B12 janë: peshqit, mishi, qumështi dhe vezët, ndërsa thujse plotësisht mungojnë në ushqimet bimore. Është e vështirë të kesh një mangësi të vitaminës B12, sepse grumbullohet në trup për shumë vite. Megjithatë, ato mund të arrijnë një mangësi të kësaj vitamine për shkak të dietës së tyre të bazuar në ushqimet bimore, duke mos marrë sasinë e duhur.

- Çfarë është Vitamina B12? Ajo kontribuon në gjendjen e shëndetit të sistemit nervor: vita-



mina B12 ndihmon në mbrojtjen e nervave pasi ndikon në formimin e cipës së trurit duke e mbrojtur atë nga goditjet e jashtme dhe sulmet nervore. Ajo gjithashtu parandalon një rënie në vëllimin e trurit, i cili gjatë viteve mund të shkaktojë probleme në kujtesë.

Ajo ndihmon në formimin e qelizave të kuqe të gjakut dhe forcon sistemin imunitar: përveç për të ndihmuar në formimin e qelizave të kuqe të gjakut, vitamina B12, gjithashtu promovon rritjen duke ndihmuar për të parandaluar aneminë. Së bashku me acidin folik, ajo kontribuon edhe në formimin e qelizave të bardha të gjakut dhe gjithashtu ndihmon për të rritur sistemin imunitar. Ajo stimulon formimin e muskujve: siç e kemi parë vitamina B12 rrit prodhimin e qelizave të kuqe të gjakut që janë thelbësore për rritjen e muskujve, ato ofrojnë oksigjen dhe lëndë ushqyese. Ata që

praktikojnë sporte në një nivel konkurrues, në fakt, shpesh e marrin këtë vitaminë në formë të shtesave.

E mirë për mëlçinë dhe eshtrat: vitamina B12, për shkak të aftësisë së saj për rigjenerimin e qelizave të mëlçisë, është e dobishme në rastet e hepatitit apo cirroza, sëmundjet që prekin mëlçinë. Ajo gjithashtu arrin të ketë një efekt pozitiv në kockat sidomos kur është fjala për artritet që shoqërohet me anemi. Cilat janë ushqimet që përmbajnë vitaminë B12? Vitamina B12 gjendet në ushqime me origjinë shtazore, ndërsa ato me origjinë bimore nuk i përmbajnë ato. Ja ku ndodhet në sasi të mëdha:

MISHI: për të përmbajtur shumë vitaminë B12 është mishi i kuq: 100 gr. e mishit të kuq përmban 6 mikrogramë (mg) të vitaminës B12, ndërsa e njëjta sasi e mëlçisë përmban rreth 80 mg.

PESHKU: gjithashtu dhe peshku përmban një sasi të mirë të vitaminës B12: skumbri, sardelet, por edhe karkalecat, gaforret dhe midhjet.

Produktet e qumështit dhe vezët: vezët përmbajnë vitaminë B12, 2 mg. për 100 gramë produkti (vezët e pulave) dhe produktet e qumështit që përmbajnë një sasi më të vogël: rreth 0.5 mg për 100 gram. Një sasi e vogël e vitaminës B12 gjendet gjithashtu në fasule, arra dhe fara luledielli.

- Sa vitaminë B12 duhet të marrë në ditë? Kërkesa e përditshme e vitaminës B12 është 2.4 mikrogram (mg) në ditë për të rriturit. Doza që rritet në 2.6 për gratë shtatzëna.

- Simptomat dhe pasojat e mungesës së vitaminës B12. Një mungesë e vitaminës B12 mund të shkaktojë dëme në sistemin nervor ose një formë anemi të rëndë, anemi të dëmshme.

## Rrit masat tumorale, shkaktari në tryezat tona

Sheqeri ndikon në zhvillimin e kancerit dhe ushqen avancimin e tij, një detaj që mund të përdoret për të zbatuar dietat efektive për pacientët me kancer. Kjo ka rezultuar në një ekip studiuesish holandezë të cilët kryen një projekt të përbashkët kërkimor mbi këtë eksperiment i cili zgjati nëntë vjet, duke filluar në vitin 2008.

Është procesi metabolik ku qelizat e kancerit konvertojnë sasi më të mëdha të sheqerit të laktatit sesa indet e shëndetshme. Kjo është një tipar i njohur mirë për shkencëtarët dhe madje përdoret

për të diagnostikuar disa neoplazma, siç janë ato në tru, megjithëse lidhja midis sheqerit dhe kancerit ka ende disa anë të errëta. Shkencëtarët kanë vërejtur në eksperiment se sheqeri i ndërmjetësuar nga fruktoza 1.6-biofosfat lidhet me aktivizimin e proteinave RAS, të cilat janë përgjegjëse për shumëfishimin e qelizave tumorale. Nga eksperimenti i bërë nuk dilnin qartë të gjitha ndikimet që sheqeri kishte në zhvillimin e qelizave tumorale sepse qëndronin dhe disa qeliza të pa eksperimentuara të cilat nuk lidheshin me pro-

teinat Ras. Ky detaj mund të shfrytëzohet në të ardhmen për të zhvilluar dietat që mund të kufizojnë përhapjen e kancerit. Megjithë rezultatet e arritura, për Thevelein dhe kolegët shkaku kryesor mbetet i panjohur.

"Hulumtimi ynë tregon se si konsumi i sheqerit nga qelizat kanceroze të çon në një cikël të mbyllur të stimulimit të vazhdueshëm të zhvillimit dhe rritjen e kancerit, kështu që është në gjendje të shpjegojë lidhjen mes forcës e efektit dhe agresivitetin e tumorit", nënvizoi prof. Johan Thevelein.



# SI TË NJIHNI NJË GËNJESHTAR



Kur përpiqet t'ju shpjegojë diçka në mënyrë tepër të ndërlikuar, kini parasysh se mund të jetë duke iu mashtruar. Kur është fjala për personat që i njihni mirë, psikologu Hemmings thotë se dallohen shumë lehtë nga mimika e fytyrës

Askujt nuk i pëlqen që të gënjejehet për situata apo ngjarje të caktuara, sidomos nëse është gënjyer nga partneri/ja, miqtë apo kolegët. Por ka disa mënyra për të mos rënë pre e gënjeshtrave. Një nga këto është gjuha e trupit dhe parë nga ky këndvështrim, mund ta kuptoni fare lehtë nëse dikush po ju gënjen. Kjo mund të funksionojnë në rastet e personave që i njihni prej kohësh.

Psikologu i sjelljes Jo Hemmings shpjegon se nuk mund ta njihni gjuhën e trupit të një personi që është i huaj për ju, dhe nuk

mund ta kuptoni kur ju gënjen ose jo. Megjithatë edhe këtu ekziston një sekret. Kur përpiqet t'ju shpjegojë diçka në mënyrë tepër të ndërlikuar, kini parasysh se mund të jetë duke iu mashtruar. Kur është fjala për personat që i njihni mirë, psikologu Hemmings thotë se dallohen shumë lehtë nga mimika e fytyrës.

**NJË SHOK.** Duke supozuar se e njihni mirë këtë person, jeni të familjarizuar edhe me shprehjet e tij të fytyrës. Kur përpiqet t'ju gënjejnë, ata skuqen në fytyrë nga ankthi që kanë, mund të kafshojnë buzën, shmangin kontaktin direkt në sy ose përpiqen që t'ju injorojnë sa më shpejt. Ju do ta kuptoni se diçka nuk shkon.

**NJË KOLEG NË PUNË.** Ndryshe nga një mik të cilin e njihni në një ambient personal, një koleg pune mund të mos shfaqë karakterin e

tij të vërtetë në mjedisin profesional. Kështu do të jetë më e vështirë për të kuptuar gënjeshtrën tek ai/ajo. Megjithatë, përqëndrohuni te gjestet trupore më shumë se sa te mimika e fytyrës për personat që nuk i njihni aq mirë. Zakonisht kolegët në punë përdorin krahët dhe duart e tyre, duke i shtrirë më shumë apo e kundërta, se sa zakonisht. Ndryshimi nga sjellja e zakonshme që bën në ambientin e punës është çelësi i sekretit. Edhe mënyra e të folurit është një aspekt. Nëse flet shumë shpejt apo shumë ngadalë se zakonisht, mund të mos jetë duke thënë të vërtetën.

**PARTNERI/JA.** Partneri apo partnerja është personi më i afërt se kushdo tjetër në jetën tuaj. Ju mendoni se e njihni mjaft mirë dhe e dalloni fare lehtë kur ju gënjen, por gaboheni. Në fakt e

kundërta është e vërtetë. Që do të thotë se partneri/ja ndryshon sjelljen e zakonshme kur gënjen. Kështu, partneri/ja tregon më shumë përkujdes ndaj jush, duke ju thënë se kurrë nuk do t'ju gënjejë apo kurrë nuk do t'ju akuzojë për gënjeshtra në mënyrë që të justifikojë veprimet e tij/saj.

**NJË PUNONJËS NË RESTORANT APO NË DYQANE.** Me persona të tillë që mund të haseni rrallë apo shumë rrallë, nuk keni se si ta njihni gjuhën e tyre të trupit. Një person i tillë, i cili mund të jetë duke mbrojtur veten apo biznesin e tij duke thënë një gënjeshtrë për të shmangur një situatë të vështirë, është i prirur që të japë arsye komplekse dhe të ndërlikuar. Në këtë mënyrë, ata "blejnë kohë" për të menduar çfarë të thonë, ose mund të jetë një përpjekje për t'ju ngatërruar.



## Arsim i detyrueshëm në moshën 3-vjeçare

Fëmijët në Francë do ta nisin shkollën nga moshë 3-vjeçare. Projekt-ligji i ri i dërguar në parlament nga ministri francez i arsimit Jean-Michel Blanquer përcakton nisjen e mësimdhënies së detyrueshme në kopshtet publike dhe private. "Është një masë emblematike që do të hyjë në fuqi që prej vitit shkollor 2019 që është shkolla e detyrueshme për fëmijët që në moshën 3 vjeçare. Mësimdhënia e detyrueshme është një vendim historik nga ana e presidentit", tha Jean-Michel Blanquer, ministër francez i Arsimit. Arsimi i detyrueshëm në moshën 3 vjeçare, është një premtim i presidentit Emmanuel Macron. Për shefin e Elizësë, fëmijët në atë moshë nxënë më shumë dhe në mënyrë më të shpejtë. Megjithatë nisma ka hasur kundërshti, për vështirësitë në zbatimin e saj dhe për kostot ekonomike. Ky vendim vjen pak muaj pas atij për të ndaluar celularët dhe pajisjet teknologjike në bankat e shkollave të ciklit të parë, që gjithashtu ngjalli debat të gjerë në Francë.

## Depresivët jetojnë në Islandë, më të lumturit në Ruman

Eurostat publikoi statistikat për 2014: Vendet e Lindjes janë më të qetë, në Itali 5,5% e popullsisë vuajnë nga depresioni me një hendek të madh midis burrave dhe grave

Në 15 shtete anëtare të BE-së, depresioni kronik i vetëvlerësuar arriti kulmin në grupin e moshës 75-vjeçare dhe në shtatë shtete të tjera anëtare ishte më e larta në mesin e njerëzve të moshës 55 dhe 64 vjeç. Europianët që jetojnë në qytete kanë më shumë gjasa të raportojnë çrregullime kronike të depresionit. Të dhënat u shpërndanë nga Eurostat me rastin e Ditës

Botërore të Shëndetit Mendor më 10 tetor. Shifrat për depresionin kronik vijnë nga vala e dytë e humltimit europian mbi kujdesin shëndetësor (EHIS), i disponueshmi më i fundit, i cili u krye në mes 2013 dhe 2015 dhe personave të moshës 15 vjeç e lart. Vala tjetër e sondazhit do të bëhet në vitin 2019.

**TË DHËNAT.** Islanda kishte përqindjen më të lartë të popullsisë së saj që përjeton depresion kronik dhe kuota me dy shifra u regjistruan gjithashtu në Irlandë, Portugal, Gjermani dhe Finlandë. Përqindja e njerëzve që raportojnë depresion ishte më pak se 4% në Republikën Çeke, Qipro, Bullgari dhe Ruman. Më shumë probleme për gratë sesa për burrat në secilin nga shtetet. Përqindja e grave që kanë raportuar depresion kronik arriti 17% në Portugal, duke kontribuar në hendekun më të madh gjinor. Ndarjet e të paktën 5 pikë

përqindjeje janë regjistruar gjithashtu në Spanjë, Letoni dhe Suedi dhe pjesërisht në Itali.

**GRUPET E MOSHAVE.** Për të moshuarit, sipas Eurostat, depresioni ka peshën e vet: një në 10 europianë të moshës 75 vjeç e lart kanë raportuar depresion kronik. Ndër grupet e moshave nga më të rinjtë në moshën më të vjetër, përqindja e njerëzve që raportojnë depresionin rritet me vjetërsinë. Eurostat ka regjistruar një prevalencë relativisht të ulët të depresionit kronik midis të rinjve. Në të kundërt, përqindjet më të larta të njerëzve që raportojnë depresion kronik në Suedi ishin midis moshës 25 dhe 34 vjeç (13.1%), ndërsa në Danimarkë ata ishin midis 35-44 (9. %). Modeli në Islandë ishte pothuajse e kundërta e zhvillimeve të përgjithshme të vërejtura për të gjithë BE-28: përqindja më e lartë e popullsisë që regjistroi depresionin kronik u regjistrua në



mes të 15 dhe 24 vjeç (21.7%), një rënie në 7.9% midis 65 dhe 74 vjeç, përpara se të rritet në 10.0% për ata të moshës 75 vjeç e lart.

**NË QYTETET MË TË TRISHTUARA.** Me përjashtim të faktorëve demografikë të analizuar deri më tani, prevalenca e depresionit kronik ndikohet nga shkalla e ur-

banizimit. Popullsia që jeton në qytet ka më shumë gjasa të vuajë nga depresioni kronik. Në vitin 2014, 7.8% e njerëzve që jetonin në qytet raportuan se vuanin nga depresioni. Kjo përqindje ishte më e lartë se për ata që jetojnë në periferi (7.1%) dhe në zonat rurale (6.2%).

Qeveria ka depozituar në Kuvend projektligjin për regjimin e posaçëm në burgje për të dënuarit e sigurisë së lartë. Gazetarja e Report Tv, Esiona Konomi ka zbardhur draftin me projektligjin që parashikon rritjen e sigurisë në burgje.

Për të burgosurit dhe të paraburgosurit e sigurisë së lartë parashikohet zero kontakt me botën jashtë, ndërsa takimet do të regjistrohen me audio dhe video. Ata mund të takojnë familjarët apo ti telefonojnë vetëm njëherë në muaj, ndërsa gjithçka do të jetë e regjistruar. Kësaj kategorisë të të burgosurve do t'u ndalohej përdorimi i vlerave monetare që vijin nga jashtë.

Gjithashtu parashikohet kufizimi i orarit të ajrimit për të burgosurit deri në 1 orë në ditë. Të burgosurit kanë të drejtën e ankimit për këto masa që parashikohen në projektligjin.

Me kërkesë të të dënuarit ose të paraburgosurit, pas një periudhe njëvjeçare, ministri i Drejtësisë mund të rivlerësojë nëse janë kushtet për vazhdimin e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave ndaj të dënuarit ose të paraburgosurit.

Pas depozitimit projektligji do të kalojë në komisione më pas në Kuvend për t'u votuar. Nisma e qeveria ka për qëllim izolimin e të burgosurve, elementë të caktuar

# SI DO BËHET IZOLIMI I KOKAVE TË KRIMIT NË BURG



## ÇFARË ËSHTË MODELI ITALIAN "41-BIS"?

**Thelbi i regjimit "41-bis" është nevoja për të penguar komunikimin e të burgosurve me njerëz të jashtëm. Duke bërë këtë, pengohen bosët e mafies që të kishin komunikime të mundshme me organizatat kriminale. Kështu, atyre u bllokohet mundësia që bosët të japin urdhra për vrasje dhe krime ndërkohë që ishin të burgosur. Limitimi i numrit të takimeve me familjarët, është një ndër**

**rregullat strikt, ku saktësohet sipas ligjit Italian, maksimumi 1 takim në muaj. Po ashtu ndalohej kontakti fizik me familjarët, ndërsa çdo bisedë mes tyre është e regjistruar. Të burgosurit kanë mundësinë e një telefonate 10 minuteshë në muaj, edhe ajo e regjistruar. Të burgosurit i ndalohej çdo objekt personal në qeli, si stilolaps, blloqe apo lekë.**

me rrezikshmëri të lartë rezultojnë drejtojnë aktivitetin nga qelia.

Nisma ligjore bazohet në modelin italian, e njohur me emrin "41-bis". Të dënuarit apo të dyshuarit për krim të organizuar, mafia apo terrorizëm nuk do të kenë më asnjë kontakt me njerëz të bren-

shëm apo të jashtëm.

Sistemi "41-bis" u aplikua për herë të parë në Itali në vitin 1992, si një nevojë dhe domosdoshmëri për të ndaluar komunikimin e të burgosurve të rrezikshëm me njerëz të jashtëm, për të mos vijuar drejtimin e organizatave

mafioze.

Kjo masë u prezantua në vitin 1992, kohë kur humbën jetën Giovanni Falcone dhe Paolo Boerselino, si mburojë specifike për anëtarët e grupit mafioz Cosa Nostra dhe grupe të tjera të ngjashme me të./ Shqiptarja.com.

## Kosova s'është e gatshme për mësimdhënës të profilizuar

Këshilltari në Ministrinë e Arsimit, Valmir Gashi, i tha Radio Kosovës se pas përfundimit të debatit në mes të drejtorëve dhe mësimdhënësve, është rekomanduar që mos të fillohet me profilizim klasor por në të ardhmen të bëhet profilizimi lëndor



zuar për një klasë të caktuar.

Ministria e Arsimit ka hequr dorë nga procesi i profilizimit të mësimdhënësve prej klasës së parë deri në të pestën, edhe pse vetë ajo kishte planifikuar që këtë të nisë nga ky vit shkollor.

Këshilltari në Ministrinë e Arsimit, Valmir Gashi, i tha Radio Kosovës se pas përfundimit të debatit në mes të drejtorëve dhe mësimdhënësve, është rekomanduar që mos të fillohet me profilizim klasor por në të ardhmen të bëhet profilizimi lëndor.

"Pasi që kanë përfunduar të gjitha debatet, konkluzionet dhe

rekomandimet që kanë dalë nga ky debat në lidhje me politikën fillestare, nuk është shprehur ndonjë vullnet për të filluar aplikimin e këtij profilizimi. Nga këto debate ka lindur ideja që profilizimi të jetë lëndor" ka thënë Gashi.

Gashi theksoi po ashtu se në të ardhmen do të bashkëpunojnë me Fakultetin e Edukimit, që fakulteti të përgatisë kuadro, në mënyrë që profilizimi kur të ndodhë të jetë me lehtë i zbatueshëm.

"Ka mbetur që në të ardhmen të bashkëpunojmë me Fakultetin e Edukimit, fillimisht fakulteti të nxjerrë kuadro të kualifikuar që në

të ardhmen cilido profilizim të ndodhë të jetë më lehtë i zbatueshëm" tha Gashi. Ndërkaq, kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, Rrahman Jasharaj, tha për Radio Kosovën se sindikata në fillim e ka kundërshtuar profilizimin klasor dhe ka rekomanduar ministrinë që profilizimi të jetë lëndor. "SBASHK-u, që vetë janë arsimtarë, e di më mirë se çfarë mund të shkojë më mirë në arsim. Ne kemi qenë kategorikë kundër kësaj që të mos bëhet dhe ndjehe mi mirë që kjo dështoi, ngase është e tmerrshme që për pesë vite nxënësve t'u ndërrohen pesë mësues. Ne jemi që mësimdhënësit të profilizohen në ato lëndë që janë më të përgatitur, pra, të kemi profilizim lëndor" ka thënë Jasharaj.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, muaj më parë ka organizuar debat publik me temën "Profilizimi i mësimdhënësve nga klasa I-V", ku pjesëmarrës kanë qenë zyrtarë të MASHT-it, drejtorë të drejtorive komunale të Arsimit, përgjegjës të Fakultetit të Edukimit dhe ekspertë të arsimit./Zëri



## Serbia nis fushatën për refuzimin e Kosovës në Interpol

Ministri i Brendshëm i Serbisë, Nebojsa Stefanović, njoftoi të enjten se u ka shkruar të gjitha vendeve anëtare të Interpolit dhe ua ka parashtruar, sipas tij – arsyet politike, policore e juridike pse Kosova nuk mund të bëhet anëtare e kësaj organizate, njoftojnë mediat serbe.

Stefanović përmend Rezolutën 1244 si një arsye juridike, por edhe Rezolutën e vetë Interpolit, sipas të cilës anëtare e tij mund të jetë vetëm ai vend i cili është anëtar ose vëzhgues në Kombet e Bashkuara, ndërsa Kosova s'është as anëtare e as vëzhguese. Ai ka përmendur pranimin e Palestinës, që është vëzhguese në OKB.

Si arsye politike, Stefanović ka përmendur se Kosova është pjesë e Serbisë dhe se aktualisht zhvillohet dialogu në kushtet e statusit neutral, ndërsa pranimi i Kosovës do të shkelte këtë status.

Po mbajtën anën e Prishtinës, jeni kundër Beogradit, meqë Beogradi ka indikacione të qarta se Kosova do të shfrytëzonte anëtarësimin në Interpol për të ngritur aktakuza kundër ushtarëve e policëve serbë.

Ndërkaq si arsye policore ministri serb i Brendshëm ka përmendur se Kosova edhe tash, përmes UNMIK-ut ka kontakt me Interpolin dhe mund të bëjë kërkime në të gjitha bazat e të dhënave dhe të shohin aktakuzat.

Anëtarësimin, sipas tij, Kosova e do jo për të luftuar kriminalitetin, por si dëshmi të pavarësisë, transmeton Koha.net. Asambleja e Përgjithshme e Interpolit zhvillohet nga 18 deri më 21 nëntor 2018 në Dubai, rikujton Koha.net.

Papa Françesku është shprehur disa herë se e vlerëson disiplinën e beqarisë, por kjo mund të ndryshojë pasi nuk është doktrinë e sanksionuar nga kisha

Vatikani po shqyrton mundësinë e një ndryshimi të madh në gjirin e kishës katolike. Përballja sidomos vitet e fundit me skandalet seksuale të priftërinjve dhe rënia e numrit të këtyre të fundit po e detyron Atin e Shenjtë të shyrtojë hedhjen e një hapi të ri, që thyen një nga tabutë më të mëdha të katolicizmit: lejimin e martesës për priftërinjtë.

Papa Françesku ka thirrur një takim me peshkopët e Amerikës së Jugut, vitin e ardhshëm. Takimi do të ketë temë kryesore gjendjen e vështirë në të cilën është vënë kisha në këtë rajon, ku shërbejnë shumë pak priftërinj. Gjatë këtij sinodi pritet të ngrihet edhe çështja e pranimit të martesës për priftërinjtë.

Një dokumentar me këtë temë, i shfaqur në televizionin italian, pritet t'i shërbejë këtij ndryshimi. "Zgjedhja: Priftërinjtë dhe dashuria" është dokumentari që tregon historinë e dhjetëra priftërinjve në 4 vende të Europës, që ose jetojnë me gra larg syve të kishës ose janë larguar prej gjirit të saj vetëm sepse nuk u lejohet martesa. Sipas dokumentarit, shumë prej tyre do të ktheheshin me de-

REFORMË HISTORIKE NË KISHËN KATOLIKE

## PAPA PO MENDON T'U LEJOJË PRIFTËRINJVE MARTESËN?



shirë në shërbesat fetare nëse kisha e pranon lidhjen e tyre me gratë.

Këta priftërinj kanë krijuar komunitetet e tyre brenda kishës dhe marrin pjesë në meshat e së dielës. Në fakt, Papa Françesku e ka parë edhe më herët si mundësi lejimin e martesës për priftërinjtë, si një mënyrë për të mbushur boshllëqet e krijuara në kishat e Amerikës Latine, veçanërisht në Amazonë.

Vocatio është një shoqatë në Itali e krijuar nga priftërinjtë të martuar. Ata i kanë shkruar Papa Françeskut një letër, me të cilën i

shprehin solidaritetin dhe gatishmërinë për t'i ardhur në ndihmë kishës, që po përballlet me skandalet seksuale në shumë vende të botës.

Sipas kreut të kësaj shoqate, Rosario Mocciaro, i martuar në mënyrë civile në vitin 1977, të paktën 5 mijë meshkuj në Itali i kanë braktisur shërbesat fetare si priftërinj dhe rreth 1/3 e tyre do të ktheheshin nëse kisha ua pranonte martesën.

Papa Françesku po shqyrton mundësinë që priftërinjtë të martuar të lejohen të shërbejnë në ki-

shë, me kushtin që të kenë të ashtuquajturat "virtute të provuara", në latinisht viri probati.

Kushti që një prift të qëndrojë beqar është kthyer në traditë për kishën katolike që prej shekullit të njëmbëdhjetë. Për shkak se nuk është një doktrinë, ky rregull nuk është zbatuar kudo njësoj. Psh kishat e Lindjes lejojnë që një prift i martuar të kryejë shërbesat fetare. Papa Françesku është shprehur disa herë se e vlerëson disiplinën e beqarisë, por kjo mund të ndryshojë pasi nuk është doktrinë e sanksionuar nga kisha.



## Vrasja e Khashoggi e paramenduar

Prokurori i përgjithshëm i Arabisë Saudite deklaroi sot se në bazë të informacioneve të ofruara nga Turqia, të dyshuarit e akuzuar për vrasjen e gazetarit Jamal Khashoggi kanë kryer një akt të paramenduar, sipas një deklaratë zyrtare të publikuar në Riad. "Hetimet vijojnë", shtoi prokurori gjatë komunikatës. Jamal Khashoggi, gazetari dhe kundërshtari saudit u vra më 2 tetor brenda konsullatës saudite në Stamboll. Pasi përgënjeshtroi vdekjen e tij, Riadi nën presionin ndërkombëtar paraqiti disa versione ku fillimisht citoi një grindje që përfundoi keq më pas duke konfirmuar se vrasja ishte kryer gjatë një operacioni të paautorizuar, dhe ku princi i kurorës Mohammed ben Salmane, i konsideruar si politikan i hekurt i mbretërisë, nuk kishte qenë i informuar. Sipas zyrtarëve turq, Khashoggi u vra nga një ekip agjentësh të ardhur nga Riadi. Në total, 18 të dyshuar, të gjithë sauditë u arrestuan në Arabinë Saudite dhe disa drejtues të shërbimit sekret u shkarkuan nga detyra. /ATSH



## Etiopia emëron presidenten e parë grua

Parlamenti etiopian sot emëroi presidenten e parë grua të vendit, Sahle-Work Zewde, transmeton Klan Kosova. Emërimi i saj u bë me votim unanim gjatë seancës së përbashkët speciale të dy dhomave të parlamentit: Dhoma e Përfaqësuesve të Popullit dhe Dhoma e Federatës. Parlamenti miratoi emërimin e Zeede si presidente me votim unanim, duke e bërë kështu presidentin e parë grua të Etiopisë. Sipas ligjit në Etiopi, pozita e presidentit është më shumë ceremoniale dhe me më pak fuqi ekzekutive. Fuqitë më të larta ekzekutive i përkasin kryeministrit, i cili gjithashtu është edhe komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura. Zewde gjithashtu shërbeu si kreu i zyrës së OKB-së në Kenia dhe ka një profil të gjatë diplomatik, duke shërbyer si ambasadore e Etiopisë në shumë vende.

## NATO i tregon muskujt Ruisë me manovrat gjigante

NATO-ja nisi këtë të enjte në Norvegji manovrat më të mëdha ushtarake prej fundit të Luftës së Ftohtë, një mënyrë për t'i rikujtuar Ruisë solidaritetin e Aleatëve pavarësisht dyshimeve të shfaqura nga ana e Donald Trump.

Rreth 50 000 ushtarë, 10 000 automjete, 65 anije dhe 250 avionë nga 131 shtete pritet të marrin pjesë në stërvitjen "Trident Juncture 18" për të stërvitur Aleancën e Atlantikut për t'i ardhur në ndihmë një prej anëtarëve të saj në rast

agresioni. "Hapësira e sigurisë në Europë është përkeqësuar ndjeshëm këto vitet e fundit", theksoi sekretari i përgjithshëm i NATO-s, norvegjezi Jens Stoltenberg.

"Trident Juncture" dërgon një mesazh të qartë kombeve tona dhe çdo kundërshtari potencial.

"NATO-ja nuk kërkon konfrontimin, por ajo është e gatshme të mbrojë të gjithë aleatët kundrejt të gjitha kërcënimeve", pohoi ai gjatë një konference shtypi të mbajtur të mërkurën. /ATSH



## Macron zhvendos dhomën e shtypit jashtë Pallatit Elysee



Zyra e presidentit francez, Emmanuel Macron ka konfirmuar se një dhomë e re për shtyp do të krijohet jashtë Pallatit Presidential Elysee në Paris pavarësisht protestave nga mediat, raporton WAFF 48. Pallati Elysee tha të mërkurën se dhoma e re do të përfundojë deri në fund të vitit për të "ofruar kushte më të mira pune për një numër më të madh të gazetarëve". Shoqata Presidenciale e Shtypit të Francës i kishte bërë thirrje presidentit Emmanuel Macron të rishqyrtojë vendimin e tij

për mbylljen e dhomës së shtypit brenda Pallatit Elysee. Por zyra e presidentit deklaroi se do të përdoret si një dhomë takimi për stafin e Pallatit Elysee. Zyra e tij tha se dhoma e re e shtypit do të mund të shfrytëzohet nga 36 gazetarë për tu ulur, krahasuar me vetëm 16 sa mund të ulen tani.

Një dhomë për shtyp ka qenë brenda Pallatit Elysee për më shumë se 40 vjet. Kritikët thonë se qendra e re e medias do të reduktojë qasjen e gazetarëve tek zyrtarët e qeverisë franceze.



Republika e Maqedonisë  
Komuna e Kërçovës

Në bazë të Ligjit për Tatim në pronë ( Gz. e RM-se, nr: 61/2004, 64/2005, 92/2007, 102/2008, 35/2011, 53/2011, 84/2012, 154/2015, 192/15 dhe 23/16) kurse në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative ( Gz. e RM-së nr. 38/2005, 110/2008, 118/2008 dhe 51/2011, 145/15, Kryetari i Komunës së Kërçovës shpall:

#### SHPALLJE PUBLIKE

Për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët posedojnë pronë në Territorin e Komunës së Kërçovës, për të cilat nuk është kryer dorëzimi i rregullt i aktvendimeve për vitin 2018, njoftohen që të ndërmarrin hapat vijuese:

1. Personat fizik dhe juridik të cilët posedojnë pronë në territorin e Komunës së Kërçovës, a për të cilat nuk është kryer dorëzimi i rregullt i Aktvendimeve për Tatim në Pronë, janë të obliguar që ti marrin aktvendimet për Tatim në pronë për vitin 2018, 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit të shpalljes.

2. Obligimet në pajtim me Aktvendimin për Tatim në pronë jeni të detyruar ti paguani përfundimisht me vitin 2018.

Obligimet mund ti paguani në fletëpagesat vijuese

Pranuesi	Ilogaria e Thesarit
Banka e pranuesit	Banka Popullore e RM-se
Ilogaria	10000000063095

Nr.rend.	Iloji i tatimit	Llogaria pagesore	Shifra kalimtare
1.	Tatimi në pronë për persona juridik	840-134-02512	713113
2.	Tatim në pronë për persona fizik	840-134-02507	713111

Kjo shpallje hyn në fuqi me ditën e publikimit të saj dhe llogarit se pala është njoftuar me shkrim përmes dërgesës së drejtë. Për pasojat negative ( pagesë e dhunshme, ndëshkim në para, shpenzime plotësuese etj ) që eventualisht mund të shfaqen, ato do t'i mbulojë vetë pala.

Në qoftë se keni kryer pagesa që nuk janë evidentuar, ose nevojitet të behet nivelizim i tyre mbi bazën e borxhit, Ju lutemi t'i drejtoheni Komunës së Kërçovës, Njësia për tatim dhe taksa komunale, Zyra nr. 27, për të dorëzuar dëshmitë për pagesat e kryera ose kontaktoni në adresën e mëposhtme.

rr."Boris Kidriq", nr. 1  
e-mail:kercova2013@yahoo.com

Nr. 09-2701/2  
24.10.2018.

Komuna e Kërçovës  
Kryetar  
Fatmir Dehari

Në bazë të nenit 17, 18, 19 dhe nenit 20 nga Rregullorja për mënyrën e kryerjes së ekskursioneve për nxënësit dhe aktivitete tjera të lira për nxënësit e shkollave fillore nr. 07-9992/2 nga 05.06.2014, SHFK "Video Podgorec" - Koleshinë, komuna Novo Selë, publikon:

#### SHPALLJE PUBLIKE

Për grumbullimin e ofertave për organizimin e ekskursioneve dhe aktivitete tjera të lira

1. Ekskursion treditör për nxënësit e klasës së nëntë në ralicionin: Koleshinë-Negotinë-Kavadar-Prilep-Manastir-Krushevë-Ohër-Strugë-Vevçani-Dibër-Gostivar-Shkup-Koleshinë.

2. Ekskursion dyditor për nxënësit e klasës së gjashtë në ralicionin: Koleshinë-Probishtip-Kratovë-Kriva Palankë-Kumanovë-Shkup-Koleshinë

3. Ekskursion njëditor me nxënësit e klasës së tretë në ralicionin: Koleshinë-Strumicë-Shkup dhe anasjelltas.

Ofruesi duhet t'i plotësojë kushtet në pëlqim me Rregulloren për mënyrën e kryerjes së ekskursioneve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera të lira për nxënësit e shkollave fillore.

Shpallja zgjat 5 ditë nga dita e publikimit.

Ofertat të parashtrihen në adresën në vijim: SHFK "Video Podgorec" - Koleshinë, Koleshinë nr.88 komuna Novo Selë.

SHFK "Video Podgorec"- Koleshinë  
Drejtor  
Slagjana Radojčić

Në bazë të neneve 114, 166, 172 dhe 227 nga Ligji për arsim të lartë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/2018) dhe neneve 9, 10 dhe 34 nga Rregullorja për kriteret dhe procedurat për përzgjedhje të titujve mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe atyre bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup - tekst i pastruar (shpallje universitare nr. 274/2013- tekst i konsoliduar), në pëlqim me vendimin e këshillit mësimor-shkencor dhe artistik, Dekanati i UKIM Fakulteti i arteve dramatike shpall

#### KONKURS

Për përzgjedhjen e një mësuesi për të gjithë titujt mësimor-shkencor nga fusha e arteve dramatike, nga sfera (disiplina) e hulumtimeve:

##### • Teatrollogjia (Fjalimi skenik dhe teknika e zërit në gjuhën turke) (60802)

**Kushtet:** Kandidatët që do të paraqiten në konkursin duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme nga Ligji për arsim të lartë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2018), si dhe kushtet sipas kriterëve ekzistues të dhëna në Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje të titujve mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, atyre bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup. Kandidatët që do të konkurrojnë duhet të dorëzojnë: fletëparaqitje, biografi e shkurtër, deklaratë që i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës, dokumentet me të cilat dëshmohet plotësimi i rregullave dhe vërtetimi për shtetësi. Orari i punës për mësuesin është i caktuar në pëlqim me aktet e Fakultetit. Konkursi zgjat 8 ditë nga dita e publikimit.

Fletëparaqitjet me dokumentacionin e duhur të dorëzohen në UKIM Fakulteti për artet dramatike në Shkup rr."Rugjer Boshkoviq" nr.22 Shkup.

UKIM Fakulteti për artet dramatike  
Shkup

P.nr. 1071/2016



Përmbareuesi Vanço Markovski nga Tetova, rr. Ilindenska nr. 64 në bazë të kërkesës për zbatimin e përbarimit nga kreditori Memet Salahi nga Tetova me vendbanim në f. Bogovinë, bazuar në dokumentin përbarues ODU 711/14 nga 13.10.2014 në noter Ivo Serafimovski Tetovë, kundër debitorit Alit Veseli nga Tetova me vendbanim në f. Zhelinë, për zbatimin e përbarimit në vlerë 4.674.00,00 denarë më ditë 24.10.2018 e sjell këtë:

#### VENDIM PËR SHITJE PUBLIKE GOJORE

(Në bazë të nenit 167 paragrafi 1, neni 169 paragrafi 1 dhe neni 170 paragrafi 1 nga Ligji për përbarim - Gazeta zyrtare e RM nr. 35/2005, 50/2006, 08/2008, 53/2009, 50/2010, 53/2010, 88/2010, 171/2010, 148/2011 dhe 187/2013, në lidhje me nenin 265 nga LP, Gazeta zyrtare e RM nr. 72/2016)

**PËRCAKTOHET** shitje me ankand publik gojor të pasurive të patundshme të debitorit nën hipotekë Alit Veseli nga Tetova me vendbanim në f. Zhelinë të përcaktuara si:

2/9 pjesë ideale nga pasuritë e patundshme të debitorit nën hipotekë Alit Veseli e përshkruar në listën e pronave LP nr. 1314 për KK Zhelinë që udhëhiqet nën AKP e RM - Departamenti Tetovë me indikacionet kadastrale: PK.nr. 1237, pjesa 2, e v.q. Klisura, kultura kadastrale: 11000, klasa 5 në sipërfaqe prej 840 m<sup>2</sup>; PK.nr. 1238, e v.q. Klisura, kultura kadastrale: 11000, klasa 5 në sipërfaqe prej 3.775 m<sup>2</sup>;

1/3 pjesë ideale nga pasuritë e patundshme në pronë të debitorit nën hipotekë Alit Veseli e përshkruar në listën e pronave LP nr. 694 për KK Jançishte që udhëhiqet pranë AKP e RM - departamenti Tetovë me indikacionet kadastrale: PK.nr. 345, e v.q. Orçe, kultura kadastrale: 11000, klasa 3, në sipërfaqe prej 7.000 m<sup>2</sup>;

1/3 pjesë ideale e pasurive të patundshme në pronë të debitorit nën hipotekë Alit Veseli e përshkruar në listën e pronave LP nr. 1314 për KK Zhelinë JASHTË R. N që udhëhiqet nën AKP e RM - departamenti Tetovë me indikacionet kadastrale:

PK.nr. 377, e v.q. Kopaç, kultura kadastrale: 15000, klasa 3 në sipërfaqe prej 479 m<sup>2</sup>; PK.nr.648, e v.q. Klisura, kultura kadastrale: 11000, klasa 7 në sipërfaqe prej 500 m<sup>2</sup>; PK.nr. 72, e v.q. Sladze, kultura kadastrale: 11000, klasa 4 në sipërfaqe prej 7.837 m<sup>2</sup>; PK.nr. 73, e v.q. Sladze, kultura kadastrale: 11000, klasa 4 në sipërfaqe prej 3.671 m<sup>2</sup>;

Shitja do të mbahet me 20.11.2018 në orën 11:00 në hapësirat e përbaruesit Vanço Markovski, në rr. Ilindenska nr. 64 Tetovë.

Vlera fillestare e pasurive të patundshme, e vërtetuar me përfundimin e përbaruesit Vanço Markovski l.nr. 1071/2016 nga 22.10.2018, arin shumën 2.012.283,00 denarë si çmim fillestar për shitjen e pasurive të patundshme të cilat nuk mund të shiten në ankandin e parë publik edhe atë:

1. 2/9 pjesë ideale nga pasuritë e patundshme të debitorit nën hipotekë Alit Veseli e përshkruar në listën e pronave LP nr. 1314 për KK Zhelinë që udhëhiqet nën AKP e RM - Departamenti Tetovë me indikacionet kadastrale: PK.nr. 1237, pjesa 2, e v.q. Klisura, kultura kadastrale: 11000, klasa 5 në sipërfaqe prej 840 m<sup>2</sup> është vlerësuar me shumën prej 172.200,00 denarë; PK.nr. 1238, e v.q. Klisura, kultura kadastrale: 11000, klasa 5 në sipërfaqe prej 3.775 m<sup>2</sup> është vlerësuar me shumën prej 773.875,00 denarë; Ose vlera totale e 2/9 e pjesës ideale të pasurive të patundshme të debitorit nën hipotekë Alit Veseli e përshkruar në listën e pronave LP nr. 1314 për KK Zhelinë që udhëhiqet nën AKP e RM - Departamenti Tetovë është vlerësuar me shumën prej 946.075,00 denarë.

2. 1/3 pjesë ideale nga pasuritë e patundshme në pronë të debitorit nën hipotekë Alit Veseli e përshkruar në listën e pronave LP nr. 694 për KK Jançishte që udhëhiqet nën AKP e RM - departamenti Tetovë me indikacionet kadastrale edhe atë: PK.nr. 345, e v.q. Orçe, kultura kadastrale: 11000, klasa 3, në sipërfaqe prej 7.000 m<sup>2</sup> është vlerësuar me shumën prej 373.333,00 denarë;

3. 1/3 pjesë ideale e pasurive të patundshme në pronë të debitorit nën hipotekë Alit Veseli e përshkruar në listën e pronave LP nr. 1313 për KK Zhelinë JASHTË R. N që udhëhiqet nën AKP e RM - departamenti Tetovë me indikacionet kadastrale edhe atë:

PK.nr. 377, e v.q. Kopaç, kultura kadastrale: 15000, klasa 3 në sipërfaqe orëj 479 m<sup>2</sup> është vlerësuar me shumën prej 20.756,00 denarë; PK.nr.648, e v.q. Klisura, kultura kadastrale: 11000, klasa 7 në sipërfaqe prej 500 m<sup>2</sup> është vlerësuar me shumën prej 20.000,00 denarë PK.nr. 72, e v.q. Sladze, kultura kadastrale: 11000, klasa 4 në sipërfaqe prej 7.837 m<sup>2</sup> është vlerësuar me shumën prej 444.096,00 denarë; PK.nr. 73, e v.q. Sladze, kultura kadastrale: 11000, klasa 4 në sipërfaqe prej 3.671 m<sup>2</sup> është vlerësuar me shumën prej 208.023,00 denarë;

Ose vlera totale e 2/9 e pjesës ideale të pasurive të patundshme të debitorit nën hipotekë Alit Veseli e përshkruar në listën e pronave LP nr. 1313 për KK Zhelinë që udhëhiqet nën AKP e RM - Departamenti Tetovë është vlerësuar me shumën prej 692.875,00 denarë;

Pronat e patundshme shiten individualisht, por përparësi në bërje do të ketë ai që do të ofrojë një shumë unike për të gjitha pasuritë e patundshme në paketë. Pasuria e patundshme është e ngarkuar me këto ngarkesa dhe detyra: HIPOTEKA e themeluar e rendit të parë në favor të kreditit Memet Salahi nga Tetova me vendbanim në f. Bogovinje, me dokument përbarues Akti notarial 711/14 nga 13.10.2014 në noter Ivo Serafimovski nga Tetova.

Debitori i cili, si pronar jeton në banesën ose ndërtesën familjare të shitur, nuk e posedon më të drejtën të jeton aty, dhe është i detyruar që ndërtesën, përkatësisht banesën ta lëshojë në afat prej 60 ditë nga dita e sjelljes së vendimit për dorëzimin e pronës së patundshme, nëse nuk e bënë atë, atëherë përbaruesi me propozim të blerësit me dhunë do ta bëjë zbrazen e ndërtesës përkatësisht banesës me dhunë. Në ankandin publik mund të marrin pjesë vetëm personat që më parë kanë parashtruar garanci që i takon 1/10 (një e dhjeta) e vlerës së përcaktuar të pasurisë së patundshme.

**Pagesa e shumës në emër të garancisë bëhet në xhiro Ilogarinë e përbaruesit me nr. 210061160430277 e cila udhëhiqet në NLB Bankën AD Shkup dhe numri tatimor 5028006130976.**

Ofruesëve, oferta e të cilëve nuk pranohet, garancia kthehet menjëherë pas mbylljes së ankandit publik.

Ofruesi më i favorshëm - blerësi i pasurisë së patundshme është i detyruar ta dorëzojë shumën e plotë të pasurisë së patundshme, në afat prej 15 ditë nga dita e shitjes, në të kundërtën do të përcajtohet shitje e re, kurse mjetet nga garancia e bërë konsiderohen si mjete të paguara të përbarimit.

Ky konkluzion do të publikohet në mjetet për informim publik NOVA MAKEDONIA dhe KOHA.

Konkluzioni do t'u parashtrohet palëve, kreditorëve nën hipotekë, pjesëmarrësve të procedurës, personave të cilët kanë regjistruar ose kanë të drejtë ligjore të përparësisë në bërje dhe deri te organi kompetent i drejtorisë.

Për PËRBARUES  
Vanço Markovski

ZËVENDËSPËRBARUES  
Sasho Perovski

Në bazë të nenit 172 dhe 176 nga Ligji për arsim të lartë (Gazeta zyrtare e RM nr. 82/2018) dhe me propozimin e Këshillit mësimor-shkencor vendimi nr. 02-726/14 nga 16.10.2018, Dekani i Fakultetit për shkenca bujqësore dhe ushqim - Shkup në përbërje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup, shpall

#### KONKURS

Për përzgjedhjen e një mësuesi për të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën mësimore-shkencore BLETARI

##### 40400- Klasifikimi i sferave mësimore-hulumtuese, fushave dhe zonave

**Kushtet:** Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet e përgjithshme të theksuara në nenin 166 nga Ligji për arsim të lartë (Gazeta zyrtare e RM nr. 82/2018) dhe kushtet e veçanta në bazë të Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhjen e titujve mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe atyre bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup (gazeta universitare nr. 274/13).

Kandidatët që do të konkurrojnë duhet të dorëzojnë: fletëparaqitje, biografi të shkurtër, dokumente me të cilat dëshmohet plotësimi i kushteve.

Dokumentet duhet të dorëzohen në origjinal ose kopje e vërtetuar në noter.

Orari i punës së mësuesit është i përcaktuar në bazë të akteve të Fakultetit dhe orari i orëve sipas semestrave.

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet në bazë të Ligjit për arsim të lartë dhe Rregullorja për kriteret dhe procedurat për zgjedhjen e titujve mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe atyre bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup.

Fletëparaqitja bashkë me dokumentacionin e kompletuar të dorëzohen në Fakultetin për shkenca bujqësore dhe ushqim-Shkup, rr."16-ta Makedonska brigada" nr. 3 Shkup.

Afati i paraqitjes është 8 ditë nga dita e publikimit.

Fletëparaqitjet jo të kompletuara dhe të dorëzuara me vonesë nuk do të merren në mbikëqyrje.

##### FAKULTETI PËR SHKENCA BUJQËSORE DHE USHQIM-SHKUP UNIVERSITETI "SHËN KIRILI DHE METODIJ" NË SHKUP

Në bazë të nenit 114 dhe nenit 176 nga Ligji i arsimit të lartë ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 82/2018), Dekani i Fakultetit filozofik pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup, shpall

#### KONKURS

1) Për zgjedhjen e një (1) mësuesi në të gjithë titujt mësimor-shkencor në sferat mësimore shkencore: Psikologji e përgjithshme (shifra 51000) dhe Psikologjia e arsimit dhe edukimit (shifra 51005) për kohë prej 5 (pesë) vjet.

Kandidatët, përveç kushteve të përgjithshme duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 164 dhe neni 166 nga Ligji për arsim të lartë ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 82/2018) dhe me aktet tjera të universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup dhe në Fakultetin Filozofik në Shkup.

Për aplikimin, kandidatët duhet të dorëzojnë :

- biografi të shkurtër (CV), me kopje të vendimit për zgjedhje të titujve mësimor-shkencor, nëse ata kanë zgjedhje të mëparshme në titujt mësimor-shkencor,
- vërtetim për shkallë të fituar të arsimit - doktor i shkencave nga sfera e shkencës për të cilën zgjidhet,
- certifikatë shtetësie
- deklaratë për përbushjen e kushteve të përgjithshme dhe atyre të veçantë për vendin e punës dhe listë të botimeve shkencore dhe profesionale të publikuara, nga një kopje të botimeve,
- vërtetim për aftësi shëndetësore të përgjithshme për vendin e punës
- dëshmi që vendimi gjyqësor i formës së prerë nuk i ka vendosur ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarive ose detyrave.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim të lartë dhe aktet tjera të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup dhe në Fakultetin Filozofik në Shkup.

Orari i punës i mësuesit për titujt mësimor-shkencor është i përcaktuar në përputhje me aktet e Fakultetit Filozofik.

Rroga bruto fillestare e mësuesit është rreth 61.030,00 denarë.

Procedura e konkursit për përzgjedhje të titujve mësimor-shkencor dhe titujt shoqëruar zgjat më së shumti 6 muaj llogaritur nga dita e publikimit të konkursit.

Dokumentet të dorëzohen në Fakultetin Filozofik në Shkup, bul. "Goce Dellçev" nr. 9A - Shkup, në afat prej 8 ditëve llogaritur nga dita e publikimit të konkursit në shtypin ditor.

Informata më të hollësishme në numrin telefonik 02 3116-520

**Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093**



IPADI ËSHTË BËRË BIBERON, E SMARTPHONET LOJËRA PËR TË RRRITURIT

# NA DUHET NJË ALFABETIZIM I RI



Nga Maryanne WOLF

Herën tjetër kur të hipni në avion, hidhni një sy përreth. iPad është biberoni i ri për të sapolindurit dhe fëmijët e vegjël. Ata që tashmë shkojnë në shkollë lexojnë nëpër smartphone; meshkujt më të mëdhenj nuk lexojnë aspak, por do t'i shikoni të përkulur mbi videolojërat e tyre. Prindërit dhe pasagjerët e tjerë lexojnë në Kindle ose kalojnë me shpejtësi emaila dhe lajme. Në padijen e pjesës më të madhe prej nesh, një ndryshim jo i perceptueshëm, por epokal, i bashkon të gjithë këta njerëz: në circuitin neuronal që ndodhet në themelin e aftësisë trurit për të lexuar po ndodh me shpejtësi një transformim që do të ketë pasoja për të gjithë, nga fëmijët në çerdhe deri tek të rriturit.

Siç e dimë nga kërkimet e neuroshkencëtarëve, më shumë se 600 vite më parë, alfabetizimi i ka imponuar trurit të specit tonë nevojën e një circuiti të ri. Ky circuit është zhvilluar, duke kaluar nga mekanizmi i thjeshtë që shërben për të dekodifikuar informacione elementare, si numri i dhive në një tufë, në trurin jashtëzakonisht kompleks dhe në gjendje të lexojë që kemi sot. Nga kërkimet e mia kam kuptuar se truri i aftë të lexojë mundëson zhvillimin e disa prej proceseve tona mendore dhe afektive më të rëndësishme, të tilla si brendësimi i dijes, arsytimi analogjik dhe aftësia deduktuese; përvetësimi i një pikëpamjeje të ndryshme nga e jona është në origjinën e simpatisë; analiza kritike dhe intuita. Kërkime të tjera në zhvillim e sipër na paralajmërojnë mbi rrezikun që hasin të gjitha këto procese thelbësore të lidhur me "leximin e thellë" me modalitetet e reja të leximit digjital.

Nuk bëhet fjalë për një kundërvënje të thjeshtë midis leximit në letër dhe atij digjital. Siç ka shkruar Sherry Turkle, studiuesja e Massachusetts Institute of Technology (MIT), shoqëria nuk gabon kur fut një novacion, por nuk mban parasysh dëmet që mund të shkaktohen. Në këtë moment kalimi nga kultura e shtypit në letër në atë dixhital, shoqëria duhet të përballojë problemet që dalim - dëmet që po i shkaktohen circuitit memorial të leximit ekspert, aftësisë që fëmijët dhe studentët tanë nuk



**Kur lexojmë një tekst në ndonjë pajisje digjitale, truri jonë nuk arrin ta kapë kompleksitetin, të provojë simpati apo të perceptojë bukuri. Duhet një alfabetizim i ri**

po zhvillojnë - dhe të mendosh se çfarë mund të bëhet lidhur me to. Dimë nga studime të ndryshme se qeniet njerëzore nuk e fitojnë aftësinë e të lexuarit me rrugë gjenetike, siç fitojnë të shikuarit dhe të folurit. Për t'u zhvilluar, circuiti i të lexuarit ka nevojë për një mjedis të veçantë dhe u përshtatet kërkesave të këtij mjedisi, nga sistemet e ndryshme të shkrimit tek karakteristikat e mjeteve që përdor. Nëqoftëse mjeti predominues favorizon procese të shpejta, mundëson që të bëhen shumë gjëra njëkohësisht dhe të menaxhohet një sasi e madhe informacioni - si mjeti aktual digjital - circuiti i të lexuarit përshtatet.

Siç shkruan Patricia Greenfield, psikologe e University of California Los Angeles (UCLA), rezultati është që truri do t'i kushtojë më pak kohë dhe vëmendje këtyre proceseve të leximit të thellë që kërkojnë më shumë kohë, si për shembull arsytimi deduktiv, analiza kritike dhe simpatia, por që janë të domosdoshme për t'u kuptuar në çdo moshë. Është kjo që mbështesin gjithnjë e më shumë edukatorët dhe ekspertët psikologjike e lëndësh humaniste. Mark Edmundson, studiues i Letërsisë Angleze dhe pedagog universitar,

ka vërejtur se shumë studentë refuzojnë të lexojnë klasikët e '800 dhe të '900, pasi nuk kanë më durim që të përballojnë tekste të gjata, të vështira dhe të dendura me domethënie. Por ky "mosdurim konjitiv" i studentëve duhet të na preokupojë më pak se ajo që qëndron në themelin e tij: paaftësia potenciale e një numri të madh studentësh për të lexuar në një nivel analize kritike të mjaftueshme sa për të kuptuar kompleksitetin e mendimit dhe argumentimin e teksteve impenjues, qoftë nëse kemi të bëjmë me libra literature dhe shkence në universitet, për një testament, për një kontratë apo për pyetje qëllimisht të deformuara të cilave do të duhet t'u përgjigjen kur si qytetarë të thjeshtë do të thirren për të marrë pjesë në një referendum.

Studimet të ndryshme kanë demonstruar edhe se tek studentët e shkollave të mesme dhe të universiteteve përdorimi ekranit mund të ketë një seri efektshëm preokupues mbi aftësinë e të kuptuarit të asaj që lexojnë. Në Stavanger të Norvegjisë, psikologjia Anne Mangen dhe kolegët e saj kanë provuar që të verifikojnë se në çfarë mënyre gjimnazistët e kuptojnë të njëjtin tekst të lexuar në pajisje të ndryshme, duke ju bërë atyre një seri pyetjesh lidhur me një tregim, tema e të cilit mund t'i interesonte çdo adoleshenti (një histori dashurie dhe seksi), i titulluar "Jenny mon amour". Gjysma e tyre e kishte lexuar në Kindle dhe tjetra në letër. Ka rezultuar që studentët të cilët kishin lexuar versionin letër e kishin kuptuar më mirë se ata që e kishin lexuar në digjital, në mënyrë të veçantë qenë më të aftë të kujtonin detaje dhe ta rindërtonin tregimin në mënyrë kronologjike. Ziming Liu i San Jose State University ka kryer një seri

studimesh në të cilat rezultojnë se "norma e re" është që të kalohet një tekst në vend që të lexohet, duke u ndalur vetëm mbi disa fjalë. Tashmë shumë njerëz përdorin skemën F o a Z, lexojnë rreshtin e parë dhe e kalojnë pjesën tjetër të tekstit duke kërkuar fjalë kyçe. Kur kryhet ky operacion, truri ynë e redukton kohën e kushtuar proceseve të leximit të thellë. Me fjalë të tjera, nuk kemi kohë që të kapim kompleksitetin, të kuptojmë ndjenjat e të tjerëve, të perceptojmë bukurinë dhe të formulojmë mendimet tona.

Karin Littau dhe Andrew Piper kanë vërejtur një dimension tjetër të fenomenit: atë fizike. Grupi i formuar prej tyre dhe nga Anne Manger nënvizon se duke lexuar në letër prekja shton një faktor të rëndësishëm bollëku informacioneve, një lloj "gjeometrie" fjalëve, dhe një "realitet" hapësiror tekstit. Siç vëren Piper, qeniet njerëzore kanë nevojë të dinë se ku janë të vendosur në kohë dhe në hapësirë, pasi një gjë e tillë ju mundëson që të kthehen tek gjërat dhe t'i rishqyrtojnë, domethënë të përdorin atë që quhet "teknologjia e përsëritjes". Si për lexuesit e rinj, ashtu edhe për ata më të rritur, përsëritja është e rëndësishme pasi kërkon aftësinë e të kthyerit prapa, të verifikojë e të vlerësojë kuptimin e vet të një teksti. Në këtë pikë, problemi është se çfarë ndodh me të kuptuarin kur i drejtohesh një ekrani, mungesa e realitetit hapësiror të cilit i shkurajon që të kthehen prapa.

Ekspertët e mjeteve amerikane të informimit Lisa Guernsey e Michael Levine, gjuhëtarja e American University, Naomi Baron dhe konjitivistja Tami Katzir nga Haifa University, kanë studiuar efektet e mjeteve të ndryshme të informimit, në mënyrë të veçantë tek të

rinjtë. Nga kërkimi i Katzir ka dalë se efektet negative e leximit në ekran duken të qarta qysh nga klasa e 4-ët apo e 5-të, me pasoja jo vetëm mbi kuptimin, por edhe mbi zhvillimin e simpatisë. Mundësia që analiza kritike, simpatia dhe procese të tjera të leximit të thellë të bëhen "dëme kolaterale" të pavullnetshme të kulturës tonë digjitale nuk është një problem që ka të bëjë vetëm me kundërvënien midis leximit në letër dhe leximit digjital.

Është çështje sesi fillojmë të lexojmë në çdo pajisje dhe sesi kjo influencën jo vetëm mbi atë që lexojmë, por edhe mbi qëllimin për të cilin lexojmë. Dhe nuk ka të bëjë vetëm me të rinjtë. Atrofizimi gradual i analizës kritike dhe i simpatisë na dëmton të gjithë. Influencën mbi aftësinë tonë për të dredhuar nën një bombardim konstant me informacione. Na inkurajon që të tërhiqemi në botën më familjare të informacioneve jo të kontrolluara, që nuk kërkojnë asnjë analizë, duke na ekspozuar ndaj rrezikut të "fake news" dhe të demagogjisë.

Në neuroshkencë ka një rregull të vjetër që vlen për të gjitha moshat: nëqoftëse nuk e përdor, e humb. Është një koncept mjaft i dobishëm nëse i aplikohet mendimit kritik, pasi implikon një zgjedhje. Historia e ndryshimit të trurit që lexon nuk ka mbaruar akoma. Posedojmë si diturinë, ashtu edhe teknologjinë për ta korrigjuar mënyrën tonë të ndryshme të të lexuarit përpara se të bëhet mjaft e rrënjësor. Nëqoftëse mendojmë për atë që rrezikojmë të humbasim, përveç fitimit të aftësive të reja të jashtëzakonshme që na ofron bota digjitale, atëherë kemi motiv për të qenë entuziastë, por edhe për të qenë vigjilentë. Duhet të kultivojmë një tip të ri truri: një tru të "bifabetizuar", në gjendje për firmat mendimi më të thella, duke përdorur si mjetet digjitale, ashtu edhe ato tradicionale. Nga këto varën shumë gjëra: aftësia e qytetarëve të një demokracie për të përfaqësuar pikëpamje të ndryshme dhe për ta dalluar të vërtetën nga gënjeshtria; aftësia e fëmijëve dhe nipërve tanë për të vlerësuar e krijuar bukuri dhe aftësia jonë për të shkuar përtej urisë aktuale të informacionit për të fituar dije dhe urtësinë e nevojshme në krijimin e një shoqërie të mirë.

*(Maryanne Wolf është profesore-shë e Qytetarisë dhe Shërbimit Publik dhe drejtore e Qendrës për Leximin dhe Kërkimin Gjuhësor në Departamentin "Eliot Pearson" të Studimit të Fëmijëve dhe Zhvillimit Njerëzor në "Tufts University")*

“Mjegullnajat e ardhacakëve” i Prof. Rami Veliut, është një libër kompleks. Libri është përmbledhje artikujsh të autorit, të botuar në shtypin ditor të Maqedonisë, të Kosovës e më gjerë. Shkrimet janë botuar kryesisht në periudhën e viteve 1991-2004.

Prof. Xhelal Zejneli


Me vokacion, autori është gjeograf, ndaj shkrimet e tij, e prekin çështjen shqiptare nga këndvështrimi i gjeografisë, si dhe i disiplinave të kësaj shkence. Mirëpo, duke qenë se autori ka në qendër të interesimit të vet shqiptarët, vetvetiu ka kaluar në trajtimin e kauzës së këtij populli. Duke u futur në kauzën shqiptare, autori, nga gjeografia s'ka mundur e të mos hyjë në dimensionin historik, politik dhe ideologjik të çështjes kombëtare shqiptare.

Ngashkrimet e autorit, bie në sy se kemi të bëjmë me një atdhetar të kulluar, të ngritur dhe të formuar. Çështje shqiptare, ai i qaset në mënyrë shkencore, racionale dhe pa patetikë dhe emocione. Me një fjalë, çështjes shqiptare, Prof. Veliu i qaset në mënyrë të argumentuar. Në të vërtetë, qëllimi i autorit të kësaj veprë madhore nuk ka qenë mbrojtja e shqiptarëve, por mbrojtja e së vërtetës mbi shqiptarët. Në rrethana normale, ky libër do të ishte i pranuar edhe nga autorët sllavo-maqedonas, veprat e të cilëve janë objekt i analizave dhe i studimeve kritike të Prof. Rami Veliut.

#### KUNDËRVËNIE NDAJ TEZAVE DENIGRUESE

Autori i librit, në shkrimet dhe në artikujt e vet u bënë ballë librave dhe teksteve shkollore të autorëve sllavo-maqedonas, të ngarkuar me urrejtje nacionale, me ksenofobi dhe me antishqiptarizëm. Veprat e tyre, Prof. Rami Veliu i paraqet si antishkencore, ndërsa autorët e këtyre veprave, si kuazi-intelektualë

# VEPËR KOMPLEKSE, E NDËRTUAR MBI ARGUMENTE SHKENCORE



dhe si pseudoshkencëtarë.

Libri i Prof. Rami Veliut fillon me një artikull të botuar në shtypin ditor të kohës, e që ka të bëjë me kombin dhe fenë. Çështjen e sipërthënë, ai e trajton në mënyrë të drejtë, të argumentuar dhe racionale. Ai e mbron tezën se populli ynë, më parë është shqiptar, e pastaj i takon njëres prej tri feve. Të përhëndësish në gjuhën amtare apo në gjuhën shqipe dhe jo në gjuhë të huaj, turke apo arabe, nuk do të thotë se je jomusliman apo edhe kundër fesë islame. Vetëm injorantët – dhe antishqiptarët – mund të mendojnë ndryshe.

Që prej vitit 1945 e këndeje, në Maqedoni janë botuar shumë tekste shkollore dhe vepra të tjera, me përmbajtje antishqiptare. Një vërsim veprash të tilla kemi pasur sidomos pas vitit 1991, domethënë në periudhën e pluralizmit politik dhe ideologjik. Si një intelektual i mirëfilltë, Prof. Rami Veliu, para shtrëmbërimeve të së vërtetës, nuk ri indiferent. Ai me penën e tij të fuqishme dhe me përgatitjen e lartë profesionale, ngre zërin e protestës dhe e mbron të vërtetën mbi popullin e vet. Për këtë arsye, ai përdor një literaturë të gjerë nga lëmi i gjeografisë, i disiplinave të kësaj shkence, nga fusha e historisë por edhe nga sfera e historisë dhe e ideologjisë politike. Në thurjen e

tezave të veta thellohet në shkencë, përdor metodat krahasuese si dhe një stil të qartë. Për t'i hedhur poshtë tezat e autorëve sllavo-maqedonas ap edhe serbë, Prof. Rami Veliu bazohet në burimet antike, në veprat e autorëve të huaj të qindvjeçarit XIX, në veprat e studiuesve gjermanë, austriakë, anglezë, francezë etj. Shpeshherë, ai i citon edhe veprat e studiuesve, përkatësisht të historianëve shqiptarë. Çdo mendim të vetin, ai e mbështet në literaturën shkencore duke e respektuar edhe teknikën e qasjes shkencore. Tezat e veta i argumenton duke shënuar autorin e veprës [cituat, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vendin dhe vitin e botimit si dhe faqen. Me fjalë të tjera, në artikujt e tij kemi një qasje shkencore të mirëfilltë. Vend të rëndësishëm në artikujt e këtij autori zë çështja e prejardhjes ilire të shqiptarëve, pastaj shtrirja e ilirëve në gadishullin ballkanik, përkatësisht në iliri, si dhe autoktonia e shqiptarëve. Po ashtu, ai ndalet edhe në çështjen e toponimeve iliro-shqiptare, sidomos në trojet etnike historike shqiptare.

#### STIGMATIZIM I ANAKRONIKËVE SLLAVË

Lidhur me sa më sipër, pohimet e veta i mbështet tek autorët antikë, për të vazhduar më pas edhe me studiuesit evropianë të

qindvjeçarit XIX, sikundër janë dijetari dhe diplomati austriak Johan Georg von Han (1811-1869), historiani suedez, një nga albanologët e parë, Hans Erich Thunman (1746-1778), gjeografi danez Konrad Maltte-Brun (1755-1826, Paris), studiuesi Uiljam Martin Lik (Leak, 1777-1869, ushtarak dhe përfaqësues politik i qeverisë angleze pranë oborrit të Ali pashë Tepelenës), historiani grek Konstantin Paporigopulos, e për të dalë edhe te ilirologu arbëresh i Zarës - Aleksandër Stipçeviçi.

Në vijim, Prof. Rami Veliu ndalet edhe te çështjet demografike në Maqedoni. Ai u kundërvihet autorëve sllavo-maqedonas të teksteve shkollore të arsimit fillor dhe të mesëm, përfshi edhe teksteve universitare, të hartuara mbi baza joshkencore dhe në frymën e Jovan Cvijiqit si dhe të pasardhësve të shkollës së tij, pseudoakademikëve serbomëdhenj. Prof. R. Veliu e stigmatizon në mënyrë shkencore dhe racionale konceptin anakronik dhe retrograd të institucioneve studimore sllave. Rezulton se teksteve të tilla i ushqejnë të rinjtë sllavomaqedonas me të dhëna të rrejshme për bashkëvendësit e tyre shqiptarë dhe mbjellin tek ata frymën e urrejtjes dhe të ndasive mbi baza ndërretnike, në një shtet me përbërje dyetnike e që mëton të ndërtohet si shtet binacional. Teksteve të tilla të gjeografisë, të historisë, artit muzikor, të njohurive mbi shoqërinë etj., janë përplot paragjykime për shqiptarët, ndaj me të drejtë Prof. R. Veliu kërkon që ato të hiqen nga përdorimi. Teksteve shkollore të tilla që i kundërshton guximshëm Prof. R. Veliu, madje pikërisht në kohën e botimit të tyre, janë në kundërshti edhe me parimet evropiane të funksionimit të shteteve dyetnike apo shumetnike. Ato janë në kundërshti me tendencën historike. Nuk ndërtohet bashkëjetesa duke e helmuar rininë me paragjykime

dhe ksenofobi.

Prof. R. Veliu ndalet edhe te çështja e migrimeve të popullsisë. Në disa shkrime, ai u kundërvihet pikëpamjeve të autorëve sllavomaqedonas – nusprodukte të ideologjisë garashaniniste. Në mënyrë shkencore i hedh poshtë tezat se shqiptarët në Maqedoni kanë ardhur nga Shqipëria, para një apo dy shekujve. Përkundrazi, ai e dëshmon me fakte se shqiptarët, kudo në Gadishullin Ballkanik janë rrënjës, d.mth. autoktonë, ndërsa ardhacakë janë vetë sllavët, të ardhur prej Karpateve. Se këta janë ardhacakë, flet edhe titulli i veprës së Prof. R. Veliut. Është një titull alegorik dhe ironik.

Në do artikuj, autori i kësaj veprë flet edhe për elaboratet e Vasa Çubrilloviqit dhe të Ivo Andriqit për dëbimin e shqiptarëve nga trojet e tyre etnike historike për në Turqi, duke mos lënë pa e përmendur edhe politikën represive të njërit prej simboleve të antishqiptarizmit – Rankoviqin.

Shqiptarët në gadishull, pohon autori i kësaj veprë, përbëjnë tërësi etnike, linguistike, etnokulturore dhe etnopsikologjike kompakte në tërë Gadishullin Ballkanik. Kufijtë ndërkaq, janë përcaktuar në bazë të vendimeve të padrejta dhe tragjike për shqiptarët – në Shën-Stefan, në Kongresin e Berlinit dhe në Konferencën e Ambasadorëve në Londër.

Sipas autorit të librit “Mjegullnajat e ardhacakëve” – Prof. Rami Veliu, rendi i ri në Evropë dhe në planin global, padrejtësitë historike të bëra ndaj shqiptarëve, duhet t'i korrigjojë. Një gjë e tillë do të ishte në funksion të paqes dhe të stabilitetit në rajon. Kjo do të ishte edhe në frymën e integritetit në strukturat euroatlantike.

Libri i bën nder autorit dhe paraqet thesar të çmuar për literaturën shqiptare, në rrafshin e mendimit politik dhe shkencor.

## “MBRETI IBI” NË NATËN E DYTË TË SKUPIFEST

Shkupi, 25 tetor - Në natën e dytë të Festivalit Ndërkombëtar të teatrit SkupiFest (ora 20.00) në skenën e Qendrës kulturore rinore u ngjit shfaqja “Mbreti Ibi”, sipas veprës së Alfred Jarry dhe regji nga Goran Jevtiq, produksion i DEV9T FESTIVAL (Beograd, Serbi). Pjesa Teatrorë “Mbreti Ibi” është vepër që lidh zhanrin vodvil me vulgaren, humorin pervers, që rezulton duke treguar anën e ligë e natyrës njerëzore, përmes një akti komik. Shfaqja është bërë spontanisht,

pothuajse si një thirrje për betejë, si mjete i vetëm i aktorëve për t'a shprehur qëndrimin e tyre ndaj mjedisit i cili artin e trajton si një formë parazitare, dhe mundohet që t'a asfiksojë dhe t'a zhbëjë. Në të interpretojnë aktorët Goran Jevtiq, Mirjana Djurdjeviç, Viktor Kish, Katarina Jovanoviç, Dimitrije Stajiq, Sava Stojanoviç, Marko Milosheviç, Sasha Niçiforoviç dhe Nemanja Ra-failoviç. Ngjarjet zhvillohen në një fabrikë të braktisur të tullave, një tokë të pajetë dhe të papastër, që

duket postapokaliptike dhe metaforikisht paraqet planetin në ditët e sotshme. Aktorët janë vendosur, në një instalacion skulpture prej njërit nga artistët më të talentuar bashkëkohorë, Viktor Kish, ndërsa atmosfera është plotësuar me filmat e Sërgjan Çesiq dhe Jonathan English, si dhe një krijim kostumesh ekstravagante nga Tijana Pavlov. Muzika e kompozuar nga Nemanja Aqimoviç, e cila bashkë me komponentët e tjera, si dhe përmes një trajtimi më ndry-



she të veprës së njohur, na sjell në një botë re, me një Ibi apokaliptik...

“Mbreti Ibi” është e vendosur si një performancë e luajtur, përmes së cilës ne duam të shprehim mendimin tonë për atë se çfarë po

ndodh në botën bashkëkohore – luftërat, refugjatët, të drejtave dhe lirive të njeriut, mediat, morali, mashtrimet, lakmia e pushtetarit, autoritetit, para, diktatura, dallimet klasore ... (E.H)

RANGLISTA E FIFA-s

# MAQEDONIA NUK LËVIZË, SHQIPËRIA BIE, KOSOVA NGRITET NJË VEND MË LARTË

Maqedonia ka ngelur në pozitën e 68 të renditjes së FIFA-s, aty ku ishte edhe muajin e kaluar. Shqipëria ka humbur tre pozicione nga vendi i 57 në të 60-in. Kosova muajin e kaluar radhiteshin në vendin e 138, ndërsa tani janë në pozitën e 137

Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 25 tetor - Reprerentacioni i Maqedonisë në futboll në publikimin e renditjes më të re nga FIFA nuk ka lëvizur asnjë pozitë. Fitorja ndaj Lihtenshtajnit në shtëpi me rezultatin 4:1 dhe humbja si mysafire ndaj Armenisë (4:0) nuk i kushtoi fare në renditjen më të re. Kështu që Maqedonia me 1338 pikë, ka ngelur në pozitën e 68 të renditjes së FIFA-s, aty ku ishte edhe muajin e kaluar. Përfaqësuesja e Maqedonisë muajin e ardh-



shëm do të zhvillojë edhe dy takime në kuadër të Ligës së Kombeve, ndaj Lihtenshtajnit dhe Gibraltarit. Me dy fitore eventuale Maqedonia do të arrijë që përsëri të ngritet në klasifikimin e FIFA-s. Nga ana tjetër, Shqipëria humbet tre pozicione në renditjen e përgjithshme të FIFA-s për muajin tetor. Kuqezinjtë kanë rrëshqitur nga vendi i 57-të në të 60-in pas dy ndeshjeve të fundit të zhvilluara këtë muaj. Në fakt, pritej një rënie e Shqipërisë pas humbjes 2-0 me Izraelin në Beer Sheva në Nations League, takim që u luajt vetëm pak ditë pas barazimit 0-0 me Jordaninë në miqësore. Kombëtarja e Kosovës është ngritur një vend më lart në

ranglistën e re. Në ranglistën e kaluar, Dardanët radhiteshin në vendin e 138, ndërsa tani janë në pozitën e 137. Kosova e ka arritur pozitën më të lartë në histori në këtë ranglistë të publikuar nga FIFA për muajin tetor. Ajo është ngritur për tri vende në krahasim me listën e publikuar në gusht. Kjo ngritje e Kosovës vjen pas ndeshje të zhvilluara në muajin tetor në kuadër të Ligës së Kombeve. Në ndeshjen e parë, kur e kishte pritur Maltën në shtëpi, në stadiumin "Fadil Vokrri", Kosova kishte siguruar fitore me rezultat 3-1. Ndërsa, në ndeshjen e dytë, kundër Ishujve Faroe, Dardanët kishin barazuar me rezultat 1-1. Këto

dy rezultate kanë bërë që Kosova të jetë në vendin e parë të grupit 3 të Ligës D në kuadër të Ligës së Kombeve, si dhe kanë bërë që Kosova të ngrihet edhe më lartë në renditjen e FIFA-s. Sa i përket kreut të listës, Belgjika e Franca ndanin vendin e parë në renditjen e muajit të kaluar, mirëpo derisa të dy përfaqësueset fituan një ndeshje dhe barazuan një në tetor, Belgjika doli e para me 1733 pikë, një më tepër se Franca që zë vendin e dytë. Belgjika e mposhti Zvicrën në ndeshjen e Ligës së Kombeve dhe barazoi me Holandën, ndërsa Franca e mposhti Gjermaninë në Ligën e Kombeve e u ndal nga Islanda e vogël.



## Lorik Cana po i kthehet futbollit, do ta blejë një skuadër evropiane

Në vigjiljen e një përballjeje emocionuese që rikthen imazhe të papërsëritshme në karrierën e tij futbollistike, Lorik Cana u kthye në vëmendjen e mediave para sfidës mes Marsejës dhe Lazios. Dy skuadra ngjyrat e të cilave ka mbrojtur ish-kapiteni i përfaqësueses shqiptare, do të përballen këtë të enjte në stadiumin "Velodrom" dhe për legjendën kuqez, nuk ka dyshime mbi mbështetjen. "Nuk ka asnjë paqartësi në tifozllëkun tim. Unë jam dhe do të mbetem një mbështetës i madh i olimpikut të Marsejës. Do doja të isha në stadium por kam një aktivitet bamirësie. Por Lazio më ka përfshirë në protokollin e ndeshjes së kthimit dhe do të jem në stadiumin Olimpico", tha Lorik Cana. Legjenda e futbollit shqiptar konfirmoi se shumë shpejt do të bëjë një hap të madh në karrierën jashtë fushës, por sërish të lidhur me sportin që do më shumë. "Ka disa negociata për blerjen e një klubi, por nuk mund të flas ende për këtë. Ky është një klub që nuk është pjesë e njëres nga pesë ligat më të mëdha evropiane, por do të jetë një vend i mirë për fituar eksperiencë. Duhet të shoh nëse ndjehem mirë në këtë rol dhe më pas mund të mendoj të shkoj në një klub më të madh. Më tepër synoj drejtimin sportiv. Të qenit trajner nuk më ka tërhequr kurrë", tha Cana. Cana vlerësoi gjithashtu Marsejën si një skuadër pretendente për të fituar Evropë Ligën, pavarësisht komplikimit të rrugëtimit pas rezultateve negative.

## Januzajt i duhet kohë për t'u kthyer në fushë

Mesfushori Adnan Januzaj po stërvitet rregullisht me skuadrën e Real Sociedadit. Por, mesfushorrit të Belgjikës i duhet ende punë në stërvitje. Trajneri i Real Sociedadit, Asier Garitano iniston se Januzaj ende nuk është i gatshëm për lojë. Januzaj u lëndua gjatë kampionatit botëror "Rusia 2018".

Këtë edicion nuk ka luajtur asnjë ndeshje në La Liga. I duhet ende kohë. "Po flasim për një djalosh i cili nuk ka luajtur që nga 28 qershor. Ai ka vetëm pesë stërvitje me grupin dhe është kohë e shkurtër që ai të luaj menjëherë", ka thënë Garitano për "noticiasdegipuzkao.es".



## Celina i jep shenja trajnerit Challandes

Bersant Celina nuk ishte ftuar fare nga selektori Bernard Challandes për dy ndeshjet e tetorit në Ligën e Kombeve ndaj Maltës dhe Ishujve Faro. Trajneri zviceran kishte thënë se nuk ishte momenti i duhur për ta ftuar futbollistin e krahut. Mirëpo, Celina i ka dhënë shenja trajnerit që ta ftojë për ndeshjet e nëntorit me Maltën dhe Azerbajxhanit. Ai ka realizuar gol të martën në minutën e 85-të në fitoren e Swanseat ndaj Blackburnit me rezultat 3:1.



## Mariners e do Besart Berishën

Besart Berisha, golashënuesi më i mirë në histori në elitën e futbollit australian, A-League, u largua nga Melbourne Victory për të shkuar te klubi japonez, Sanfrecce Hiroshima në qershor, por nuk po e gjen veten në mjedisin e ri, edhe pse klubi pozicionohet në vendin e dytë në J-League japoneze. Me vetëm pesë ndeshje si zëvendësues, Berisha ende nuk ka shënuar gol në Japoni. Gjatë kohës kur luante me Brisbane Roar, ka punuar me trajnerin Mike

Mulvey dhe është pikërisht ky i fundit që e ka kërkuar sulmuesin shqiptar t'i bashkohet te Central Coast Mariners. "Ne kemi folur me menaxherët e Berishës dhe ai ka thënë faleminderit për ofertën, do të kthehesha të luaj me Mariners, por kam kontratë në Japoni dhe të shohim se çfarë do të ndodhë. Ka qenë futbollist im në Brisbane, ishte një djalosh fantastik, ai dëshiron gjithmonë të fitojë". Interesant fakti që te Mariners është stërvitur prej disa

javësh rekordmeni i botës në 100 dhe 200 metra, Usain Bolt, i cili dëshiron të bëhet futbollist profesionit, por Mariners nuk janë të mundur për t'i siguruar një kontratë të majme xhamajkanit, ndaj e kanë lënë jashtë skuadrës, të paktën për momentin. Trajneri i Central Coast, Mike Mulvey, dëshiron të ketë në dispozicion një sulmues të konfirmuar si Berisha, i cili gjatë karrierës së tij në Australi ka shënuar plot 116 gola në A-League.

# AGNELLI: TA BËJMË JUVENTUSIN SUPERFUQI EKONOMIKE DHE SPORTIVE

“Qëllimi ynë është që të konsolidojmë dhe rrisim atë që kemi ngritur gjatë viteve. Në vitin 2010, qarkullimi ynë financiar ishte nën 200 milionë euro. Sot, megjithatë, të ardhurat i kanë tejkaluar 500 milionë euro. Veç kësaj, sigurisht, nuk mund të harrojmë rezultatet sportive: shtatë tituj kampioni radhazi, katër Kupa të Italisë, tri Superkupa Italiane dhe dy finale të Ligës së Kampionëve”, ka deklaruar Agnelli



tri Superkupa Italiane dhe dy finale të Ligës së Kampionëve”, tha në fillim presidenti i “Zonjës së Vjetër”. Në mënyrë të pashmangshme, Agnelli u ndal edhe te largimi i drejtorit të pargjithshëm, Beppe Marotta: “Të flasësh për Marottën si një profesionist në botën e futbollit ka gjasa të jetë e tepërt. Për 40 vite ai ka menaxhuar klubet e futbollit, me suksese si ato te Venezia. Pastaj, Atalanta dhe Sampdoria, përpara se të arrinte te Juventus. Aftësia, përvoja dhe njohuritë e Beppe kanë qenë faktorë shumë të rëndësishëm në rritjen e skuadrës sonë. Dhe ne i detyrohemi atij me një falënderim të ngrohtë”. Presidenti i bardhezinjve shpjegon edhe rinovimin menaxherial të klubit: “Sa i përket fushës së shërbimit, ajo do të vazhdojë të ketë detyrën e sigurimit të mjeteve nga pikëpamja teknologjike dhe finan-

ciare, për të arritur objektivat. Përveç menaxhimit normal të aspekteve të aktivitetit, ne presim rritje të të ardhurave. I vlerësojmë të gjitha operacionet e klubit, por duhet të optimizohet menaxhimi i burimeve të financimit. Kjo ka për qëllim zvogëlimin e rreziqeve financiare. Sa i përket të ardhurave, qëllimi është që ta konsolidojmë Juventusin si një superfuqi ekonomike dhe sportive. Kjo do të thotë rritje në tregjet tona kryesore, duke shfrytëzuar valën e interesit, që është rritur, gjithashtu, dhe mbi të gjitha në sajë të rezultateve sportive”. Një reflektim i Agnelli edhe mbi presidentin e ri të FIGC: “Për fat të mirë u zgjodh Gabriele Gravina. Do të përpiqem të marr pjesë dhe të jap kontributin tim, duke mos pasur të drejtën e votës. Sidoqoftë, federata ka një sfidë të rëndësishme përpara saj”.

Në një ditë të rëndësishme të Juventusit, dedikuar mbledhjes së aksionarëve bardhezinj, me Andrea Agnelli si numrin një të klubit, mund të analizohen perspektivat afatshkurtra dhe afatgjata. “Qëllimi ynë është që të konsolidojmë dhe rrisim atë që kemi ngritur gjatë viteve. Në vitin 2010, qarkullimi ynë financiar ishte nën 200 milionë euro. Sot, megjithatë, të ardhurat i kanë tejkaluar 500 milionë euro. Veç kësaj, sigurisht, nuk mund të harrojmë rezultatet sportive: shtatë tituj kampioni radhazi, katër Kupa të Italisë,



## Van Persie do të “var këpucët në gozhde” pas këtij sezoni

Legjenda e Holandës Robin van Persie ka treguar se ka mundësi të dalë në pension pas fundit të këtij sezoni. 35 vjeçari aktualisht është rikthyer në ekipin ku ka startuar karrierën e tij, Feyenoord. Ai ka shënuar gjashtë gola për Feyenoord këtë sezon, duke mbajtur vendin e tretë pas PSV Eindhoven dhe Ajax. “Kur do të ndaloj? Ka mundësi në fund të këtij sezoni”, ka thënë Van Persie për median holandeze AD. “Do të jem 36 vjeç dhe kam luajtur si profesionist për 18 vite. Që në moshën 5 vjeçare jam marr me futboll”. Van Persie ka qëndruar për 8 sezone me Arsenal, duke shënuar 132 gola në 278 paraqitje, si edhe duke i ndihmuar të fitonin FA Cup në 2004. Gjithashtu ka ndihmuar Manchester United të shpallen kampion të Premier League-s nën drejtimin e Sir Alex Ferguson. Ndërsa pas qëndrimit për tre vite në Manchester është bashkuar në 2015 me ekipin turk Fenerbahçe. Tashmë që është kthyer në Holandë, në vendin e tij të origjinës, mesa duket dëshiron ta mbyllë aty ku e nisi, me dashurinë e tifozerisë holandeze. “Nuk mendoj se rikthimi në Feyenoord do të ishte i suksesshëm vetëm nëse do të fitonim titullin. Unë dua të fitoj si futbollist dhe do të ishte mirë fitorja e kupës, por nuk ka një masë përcaktuese mes asaj që është e suksesshme ose jo”, ka theksuar Van Persie.

Publicitet

**SHMK Gjinnazi „ Mirçe Acev “ – Prilep**  
Rr. „ Prilepski Braniteli “ 96a  
Tel/fax +38948425841  
e-mail: gimmapp@yahoo.com

Në bazë të nenit 19 paragrafi 1, 2 dhe 3 nga Rregullorja për kryerjen e ekskursioneve për nxënësit e shkollave të mesme, në pajtim me nenin 24- paragrafi 11 nga Ligji për shkollën e mesme, komisioni për zhvillimin e procedurës, publikon:

**SHPALLJE PUBLIKE**  
**Për përmblidhjen e ofertave për realizimin e ekskursioneve për nxënësit e SHMK Gjinnazi "Mirçe Acev" - Prilep, për vitin shkollor 2018/2019**

**Kërkesues:** SHMK Gjinnazi "Mirçe Acev" - Prilep  
**Ofrues:** Çdo subjekt juridik që është i regjistruar për kryerjen e aktivitetit në pajtim me aktet e miratimit.  
**Lënda:** Organizim për ekskursion përfundimtar për nxënësit e vitit të tretë dhe shoqërim i përbashkët i maturës për nxënësit e vitit të katërt në pajtim të programit për punë në shkollë\*  
**Destinacioni:** Ekskursion përfundimtar për nxënësit e vitit të tretë do të realizohet në relacionin: **PRILEP - SERBI - KROACI - SLOVONI - SHPELLA E POSTONJËS - VENECI - ROMË - BOLONJË - PLITVIČKI EZERA - PRILEP.**  
Shoqërimi i përbashkët i maturës i nxënëseve të vitit të tretë do të realizohet në relacionin: **PRILEP - SERBI - KROACI - SLOVONI - SHPELLA E POSTONJËS - VENECI - ROMË - BOLONJË - PLITVIČKI EZERA - PRILEP.**  
Ofruesit të cilët janë të interesuar për pjesëmarrje në procedurën sipas shpalljes publike për përmblidhjen e ofertave, si dhe informacione për lëndën e shpalljes publike, kriteret minimale dhe vërtetime për dëshmi të aftësisë, kërkesat teknike dhe financiare, kriteret për zgjedhje të ofertës më të favorshme dhe mënyra e dorëzimit të ofertave, mund të merren së bashku me dokumentacionin shtesë, i cili mund të tërhiqet çdo ditë pune nga ora 09.00 - 14.00 nga arkivi i SHMK Gjinnazi "Mirçe Acev" - Prilep, rr. "Prilepski braniteli" nr. 96a, Prilep, Ngritja e dokumentacionit, si shtesë e kësaj kërkeje është kusht për pjesëmarrje në procedurën për zgjedhjen e ofruesit më të favorshëm për realizimin e ekskursioneve për nxënësit.  
Ofertat duhet të parashtrihen veçanërisht për ekskursionin përfundimtar, veçanërisht për shoqërimin e përbashkët të maturës. Shpallja zgjat 5 (pesë) ditë nga dita e shpalljes në shtypin ditor.  
Ofertat me dokumentacion e plotë teknik të parashtrihen tek Komisionet për përzgjedhjen e ofertave në arkivin e shkollës ose përmes postës në adresën SHMK Gjinnazi "Mirçe Acev" - Prilep rr. "Prilepski braniteli" nr. 96a, Prilep në zarf të mbyllur me shënimin "Për komisionin për zgjedhjen e ofertave për ekskursionin përfundimtar" ose "Për komisionin për zgjedhjen e ofertave për shoqërimin e përbashkët të maturës".  
Dokumentet jo të kompletuara dhe të dorëzuara me vonesë nuk do të merren për mbikëqyrje nga ana e komisionit.  
Prilep, 25.10.2018

**Kryetari i komisionit për zgjedhje të ofertave për ekskursionin përfundimtar**  
Gordana Ristevska – Tuneska

**Kryetari i komisionit për ofertave për shoqërim të maturës**  
Miroslav Andonoski

Republika e Maqedonisë  
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit  
Hapësinor

MKD  
СЕРТИФИКАТ  
MKC EN ISO 9001:2009

Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor të Republikës së Maqedonisë

**SHPALLJE**  
A - Leje e integruar ekologjike për Shoqatën për prodhim, tregti të brendshme dhe të jashtme, Trgopromet Toni DOOEL fabrika e tullave, Kumanovë

Instalacioni Shoqata për prodhim, tregti të brendshme dhe të jashtme Trgopromet Toni DOOEL fabrika e tullave, Kumanovë, deri te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor ka dorëzuar kërkesë për marrjen e A - lejes për harmonizim me planin operativ. Pas kryerjes së procedurës ligjore MMJPH ka lëshuar A - Leje për harmonizim me planin operativ nr. 11-4249/2 nga 08.05.2013. Sipas njoftimit të marur për realizimin e tërësishëm të planit operativ (në përputhje me nenin 138 pika 6 dhe 7 të Ligjit për mjedisin jetësor (Gazeta zyrtare e RM 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16), dhe inspektimit të realizuar më 15.12.2017):  
Drejtoria e Mjedisit Jetësor pranë MMJPH përgatiti  
A - Leje të integruar ekologjike për Shoqatën për prodhim, tregti të brendshme dhe të jashtme Trgopromet Toni DOOEL fabrika e tullave, Kumanovë

Instalacioni sipas Rregullores për përcaktimin e aktiviteteve të instalacioneve i takon aktiviteteve nga Shtojca I, Pika:  
3. Industria e mineraleve  
3.4. Instalacioni për prodhimin e prodhimeve të qeramiks me pjekje, para së gjithash, tulla, tulla zjarrduruese, plakave, gurit ose porcelanit, me kapacitet të prodhimit mbi 75t/ditë dhe me kapacitet të furrës mbi 4m<sup>3</sup> dhe me dendësi hyrëse mbi 300kg/m<sup>3</sup> për furrë.  
Kapaciteti i projektuar:  
300 ton/ditë prodhim i pjekur  
Lloji i aktivitetit:  
Prodhimi i tullave, tjegullave dhe prodhime nga argjila e pjekur.  
Leja do jetë e shpallur, në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe planifikimit Hapësinor www.moepp.gov.mk  
Ankesa kundër vendimit për lejen mund të dorëzohen nga ana e personave juridik dhe fizik, si edhe nga ana e shoqatave të qytetarëve të themeluara për përparimin dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, deri te komisioni shtetëror për vendosje për procedurë administrative dhe procedura për marrëdhënie pune i shkalles së dytë, në afat prej 15 ditëve që nga dita e shpalljes në shtypin ditor.

Në bazë të nenit 23 alineja 1 e Ligjit për marrëdhënie pune (G. zyrtare e RM nr. 62/05, dhe plotësim ligjit 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13 dhe 113/14) dhe neni 80, 82 alineja 1,3 dhe neni 86 alineja 1 i ligjit për shkollë fillore G.z. RM nr. 103/08 dhe pëlqimin e MASH me nr. 12-10292/25 të datës 19.09.2018, Shkolla fillore komunale "Limani Kaba" f. Luboten-Butel shpallë:

**KONKURS**  
**Për këtë vend pune**

1. Një pedagog me kohë të caktuar pune ,shuma mujore 21.150,00 den..  
Kandidatët duhet të ofrojnë këto dokumente:  
Diplomë të kualifikimit përkatës .  
-Certifikatë të shtetësisë.  
Konkursi është i hapur 5 ditë pune nga dita e shpalljes.

**Drejtor**  
Ajfer Dibrani

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**Universiteti i Evropës Juglindore shpall:**  
**KONKURS**

**Për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore shkencore FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE**  
Zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në tëmin e Shkencave Kompjuterike dhe Informatikë;  
**Afati i paraqitjes**  
Afati i dorëzimit të aplikacioneve është 8 ditë nga dita e shpalljes së konkursit.  
**Konkursi është i shpallur nga 24.10.2018 – 01.11.2018**  
**Për më shumë informata: https://www.seeu.edu.mk/en/information/calls?id=1737**



**KOMUNA E SARAJIT  
KORIGJIM I SHPALLJES nr.4/2018**

**Korigjohet shpallja në gjuhën shqipe me numër arhivor 2107-543/1 e shpallur 15.10.2018, për tjetërsim të tokës ndërtimore pronësi e Republikës së Maqedonisë të ankandit publik elektronik në Komunën e Sarajit**

**LËNDA E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK**

Lënda e ankandit publik elektronik është toka ndërtimore e pa ndërtuar, pronësi e Republikës së Maqedonisë, e paraparë me DOKUMENTACION TË PLANIT LOKAL URBANISTIK për pjesë nga PK 10466, PIJES NGA PK 10468, pjesë nga 10469, pjesë nga PK 10470, PK 10471, PK 10472 dhe pjesë nga PK 10473/1, me dedikim: Industria e lehtë (G2) me objekte përcjellëse – Prodhimtari të mjetëve për industri ekologjike KK Saraj Komuna e Sarajit, e miratuar me vendim nga Kryetari i komunës së Sarajit nr. 08-813/16 nga 08.11.2016, me dedikim të ndërtimit G2 – industri e lehtë dhe e pa ndotshme, me klasë kompatible të dedikuar B1 deri 30%, B2 deri 30%, B4 deri 10%, D3 deri 30%, G3 deri 30% dhe G4 deri 30%- në pajtim me kontrolin tabelar në të cilin janë të dhënat: numri i parcelës ndërtimore, dedikimi i parcelës ndërtimore, numri i parcelave kadastrale të përmbyllura me parcelë kadastrale, sipërfaqja e përgjithshme e parcelës kadastrale, sipërfaqja e ndërtimit, sipërfaqja e zhvilluar bruto, lartësia maksimale deri në kurorë dhe katet, çmimi fillestar në m<sup>2</sup>, çmimi fillestar i përgjithshëm dhe depozitimi për pjesëmarrje të ankandit publik.

**Rishikimi Tabelarë:**

Numri I parcelës ndërtimore.	Dedikimi I ndërtimit në parcelën ndërtimore	Nr I parcelës kadastrale KK Saraj	Sipërf. E parc.ndërtimore (m <sup>2</sup> )	Sipërfaqja e ndërtimit (m <sup>2</sup> )	Përq. E ndërtimit (%)	Koefic.i shfritzimit.	Sipërf.bruto e zhvilluar (m <sup>2</sup> )	Lartësia maksimale për ndërtimin nga niveli I trotoari mbrojtës deri në kurorë	çmimi fillestarë në m <sup>2</sup> në denarë	Çmimi fillestar I përgjithshëm	Garancioni banker për seriozitetin e ofertës
P.N nr.1	G2	PK 10467/1 PK 10468/1 PK 10469/1 PK 10471/1 PK 10466/1 PK 10466/2 PK 10470/1 PK 10473/1 PK 10472/1 PK 13617/7	15004	6373	42,05	0,49	7300	TP,P+1	61.00	915.244,00	1.065.284,00

**TË DREJTË PËR PJESËMARRJE**

Të drejtë për pjesëmarrje kanë:

1. Personat fizik: shtetas të Republikës së Maqedonisë, shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe në OECD, si dhe shtetas të shteteve të cilat nuk janë anëtare të bashkimit Evropian dhe në OECD a në kushte të reciprocitetit mund të arin të drejtë të pronësisë në tokë ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë.

2. Personat juridik: personi juridik vendor, personi juridik në pronësi të përzier, personi juridik i themeluar nga personi fizik dhe juridik i jashtëm, të regjistruar në regjistrin Qendrorë në Republikën e Maqedonisë, Personat juridik të huaj rezident të shteteve anëtare të bashkimit evropian dhe në OECD, Si dhe persona juridik të huaj rezident të shteteve të cilat nuk janë anëtare të shteteve të bashkimit evropian dhe në OECD të cilat në kushte të reciprocitetit mund të arin të drejtë të pronësisë në tokë ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë.

**KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK**

Personat e interesuar fizik dhe juridik parashtrajnë paraqitjen për pjesëmarrje në ankandit publik ( në formë elektronike, në [www.gradezno-zemjiste.mk](http://www.gradezno-zemjiste.mk) në të cilën është e potencuar se në cilën parcelë ndërtimore drejtohet paraqitja dhe cilat dokumentacione janë pjesë përbërëse të paraqitjes,) dëshmit vijuese të kompletuara:

1. Paraqitja nga dorëzuesi, nga të cilat janë të potencuara të dhënat për dorëzuesin e paraqitjes;

2. Garancion Bankar për seriozitet të ofertës (garancioni bankarë për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik për parcelat ndërtimore dorëzohet edhe në formë të shkruar në origjinal deri te Komuna e Sarajit – rr.„Qendra rekreative” nr. 5, Shkup, më së voni deri në kalimin e afatit për dorëzim të paraqitjes për pjesëmarrje në ankand publik. Dorëzuesve të paraqitjes për pjesëmarrje në ankand publik të cilët nuk do të dorëzojnë garancion bankarë në formë të shkruar në origjinal nuk do të lejohet pjesëmarrje në ankand publik.).

3. persona fizik vërtetim për shtetësinë;

4. Për persona juridik dëshmi për regjistrim të personi juridik nga regjistri kompetent;

5. E-mail adresë të dorëzuesit të paraqitjes, përmes së cilës do të kryhet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankand publik elektronik, respektivisht do t’ju dorëzohen emri i shfrytëzimit dhe shifra për qasje në faqen e internetit në të cilën do të zhvillohet ankand publik elektronik.

(Për dorëzues të paraqitjeve të cilët do të dorëzojnë e-mail adresë të gabuar, Komuna e Sarajit nuk ka obligim të pranojë dhe kryejë korigjim të së njëjtës).

6. Deklaratë të nostrifikuar në noter se ofertuesi i pranon të gjitha kushtet dhe obligimet e shpalljes.

7. Ofertuesi më i volitshëm i zgjedhur obligohet që ti mbulojë edhe harxhimet e veçanta të procedurës edhe atë:

- Harxhime për sigurim të dëshmive për tokën ndërtimore lëndë e ankandit publik;
- Harxhime për shpallje në medime dhe gazetat publike;
- Harxhime për këqyrje në vend ngjarje dhe konstatimin e gjendjes faktike dhe për fillimin e pronësisë të tokës ndërtimore.

Lartësia harxhimit e lartpërmendura është 10% nga vlera e garancionit bankarë për seriozitetin e ofertës dhe e njëjta paguhet me virman ose përmes postës në Komunën e Sarajit, llogaria depozitare 781014116569614, shifra e të ardhurave 733111 programi 00 me mbishkrim “ harxhime të veçanta të procedurës për ankand publik për tjetërsim të tokës ndërtimore “, për parcelën ndërtimore nr.PN1.

Paraqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marin pjesë në ankandin publik elektronik për çka parashtruesit e paraqitjeve jo të kompletuara do të njoftohen në formë elektronike.

**OBLIGIME TJERA TË OFERTUESIT MË TË VOLITSHËM**

1. Ofertuesi më i volitshëm obligohet që ndërtimin e ardhshëm duhet që ta realizojë me dedikim definuar në dokumentacionin e planit urbanistik lokal si kompleks për prodhimtari të pajisjeve për industri ekologjike.

**ÇMIMI FILLESTAR**

Çmimi fillestar në ankandin publik elektronik për parcelat ndërtimore është e theksuar në kontrollin tabelarë dhe përbëhet pre 61 denarë në metër katrorë.

**AFATET PËR PARASHTRIMIN E FLETPARAQITJEVE**

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik mund të dorëzohen deri më 13.11.2018, në formë elektronike në adresë vijuese: [www.gradezno-zemjiste.mk](http://www.gradezno-zemjiste.mk)

Ankandit publik do të mbahet në formë elektronike në faqen vijuese të internetit [www.gradezno-zemjiste.mk](http://www.gradezno-zemjiste.mk)

Ankandit publik për PN1 do të fillon në 16.11.2018, në ora 09.30

Dhe i njëjti do të zgjatë 15 minuta.

Ankandit publik për çdo parcelë ndërtimore nga rishikimi i njëanshëm tabelarë , vazhdon për 2 minuta deri atëherë kur në 2 minutat e fundit nga ankandit ka ofertë të re.

Një ofertues mund të jetë pjesëmarrës me ofertë në një ose më shumë parcela, ose në të gjitha parcelat nga shpallja.

**PROCEDURA**

1. Komisioni i njofton parashtruesit e fletëparaqitjeve për kompletimin e të njëjtave në formë elektronike, në afat prej 24 orë pas mbarimit të afatit për parashtrimin e të njëjtave, nga çka parashtruesve të fletëparaqitjeve që kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar ju dorëzohet edhe emër shfrytëzimi dhe shifër për pjesëmarrje në ankand publik elektronik, parashtruesve të fletëparaqitjeve që nuk kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar ju dorëzohet njoftim me arsyetim se të njëjtit nuk do të marrin pjesë në ankandin publik;

2. Në ditën e mbajtur të ankandit publik elektronik pjesëmarrësit kanë qasje në faqen elektronike me emrin shfrytëzues dhe shifër në cilën e marrin në e-mail adresën, e dorëzuar në shtojcë të paraqitjes për pjesëmarrje në ankandin publik;

3. Ankandit publik elektronik mund të fillon me më pak një pjesëmarrës në ankandin publik, për çdo parcelë ndërtimore në veçanti;

4. Ankandit publik elektronik e ndjek Komisioni, i formuar nga Kryetari i komunës së Sarajit;

5. Ankandit publik elektronik fillon me shpallje të çmimit fillestar të tokës me metër katrorë, a miratohet në mënyrë të ankandit nga ana e pjesëmarrësve;

6. Ankandit kryhet “ hap pas hapi” me rritje të vlerës për çdo ‘hap’ dhe atë:

-për parcelat ndërtimore me dedikim G2- Industri e lehtë jo më pak se 10,0 denarë/m<sup>2</sup>;

7. Ankandit publik elektronik llogaritet si i kryer në momentin e kalimit të kohës i përcaktuar me këtë shpallje, me çka derisa në kalimin e 2 minutave të fundit nga ana e paraqitësve është dhënë ofertë, afati i fundit për kryerje të ankandit publik vazhdohet edhe për dy minuta a do të mbaroj kur në periudhë nga dy minutat e ardhshme nuk ka ofertë të re të ofruar. Ankandit publik vazhdon pakufi deri atëherë kur në intervalin kohorë pre di minutave ka ofertë të re.

8. Për ofertues më të volitshëm për metër katror llogaritet pjesëmarrësi i cili në ankandin publik ka dhënë ofertë me çmimin e fundit, i cili paraqet çmimin më të lartë për tjetërsim të tokës ndërtimore;

9. Komisioni pas mbarimit të ankandit publik përgatit procesverbal për ankandin publik që është zhvilluar dhe në mënyrë elektronike e dërgon tek të gjithë pjesëmarrësit në ankandin publik;

10. Pas mbarimit të procedurës së ankandit publik Komisioni është i obliguar në afat prej tre ditë pune të dorëzojë kërkesë për mendim deri tek Prokuroria e përgjithshme shtetërore e Republikës së Maqedonisë në lidhje me draft-tekstin për marrëveshjen për tjetërsim të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë.

11. Prokuroria e përgjithshme shtetërore e Republikës së Maqedonisë është e obliguar të jep mendim në lidhje me draft-tekstin për marrëveshjen për tjetërsim të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë në lidhje me kërkesë për mendim. Në rast se në afat prej 30(tridhjetë) ditësh Prokuroria e përgjithshme shtetërore e Republikës së Maqedonisë nuk na dorëzon mendim, do të llogaritet për pozitive;

12. Pas marrjes së mendimit pozitiv nga Prokuroria e përgjithshme shtetërore e Republikës së Maqedonisë, Komisioni në afat prej tre ditësh deri tek ofertuesi më o volitshëm dërgon informim me shkrim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm;

13. Ofruesi më i volitshëm në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga marrja e informimit për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm është i obliguar që të bëjë pagesën e mjetëve dhe deri tek Komisioni të dorëzojë dëshmi për pagesën e realizuar me tërë dokumentacionin e nevojshëm për pjesëmarrje në ankandin publik;

14. Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimi i informimit për zgjedhje të ofruarit më të volitshëm është i obliguar të bëjë pagesën e mjetëve për shpenzime të veçanta në procedure e tjetërsimit të tokës ndërtimore nëpërmjet ankandit publik, në lartësi prej 10% nga vlera e provizionit bankar për seriozitet të ofertës;

15. Në rast se ofertuesi më i volitshëm nuk e bën pagesën e mjetëve në afatin e caktuar, do të llogaritet se toka ndërtimore nuk është tjetërsuar, nuk do të kalohet në përfundim të marrëveshjes dhe garancia bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe i njëjti nuk do të mund të marrë pjesë në çdo ankand publik tjetër në të ardhmen për parcelën ndërtimore në fjalë;

16. Në qoftë se ofertuesi më i volitshëm e bën pagesën e mjetëve në përputhshmëri me çmimin e fundit të ankandit në afatin e caktuar dhe në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nuk mund të arrihet marrëveshje, mjetet e paguara për tjetërsim të tokës ndërtimore ofertuesit më të volitshëm nuk i kthehen, garancia bankare për seriozitet të ofertës aktivizohet dhe nuk do të ketë qasje në arrijten e marrëveshjes;

17. Në afat prej 5 (pesë) ditë pune pas dorëzimit të dëshmisë për pagesën e bërë dhe dorëzimit të dokumentacionit të përgjithshëm i nevojshëm për

pjesëmarrje në ankand, Kryetari i komunës së Sarajit në emër të Republikës së Maqedonisë arrijnë marrëveshje për tjetërsim të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë;

18. Pas arrijtes së marrëveshjes, komuna e Sarajit në afat prej një dite, në mënyrë elektronike e dorëzon kontratën deri tek Njësia për tatime lokale dhe taksa për caktim të tatimit të fitimit në patundshmëri. Blerësi është i obliguar që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga marrja e vendimit për caktim të tatimit të fitimit në patundshmëri që ta paguaj tatimin dhe të dorëzojë dëshmi për pagesën e realizuar;

19. Pas dorëzimit të dëshmisë për pagesën e realizuar të tatimit të fitimit në patundshmëri , blerësi në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh marrëveshjen në mënyrë elektronike e dorëzon tek noteri i autorizuar për ta bërë solemnizimin. Blerësi është i obliguar solemnizimin ta bëjë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dorëzimi i kontratës tek noteri i autorizuar;

20. Mos plotësimi i obligimeve nga pika 17, 18 dhe 19 nga kjo shpallje me faj të blerësit paraqet bazë për prishje të kontratës së njëanshme prej çka 80% nga shuma e përgjithshme e tjetërsimit nuk i kthehet blerësit;

21. Me marrëveshjen ofruesi më i volitshëm (blerësi) obligohet të sigurojë leje për ndërtim të objektit të paraparë në afat prej 12(dymbëdhjetë) muajve nga realizimi i solemnizimit të po të njëjtit ku si mjet i kontratës është parcela ndërtimore me hapësirë mbi 5000 m<sup>2</sup> dhe është i obliguar që ta ndërtojë objektin në pajtim me planin urbanistik nëpërmjet të cilit toka është tjetërsuar, në afat jo më gjatë se 2(dy) vjet nga marrja e lejes së plotfuqishme për ndërtim të objektit me bruto hapësirë të ndërtuar deri 1000m<sup>2</sup> në pajtim me lejen e marrur për ndërtim, respektivisht në afat jo më gjatë se 4(katër) vjet nga marrja e lejes së plotfuqishme për ndërtim të objekteve me hapësirë bruto për ndërtim mbi 1000 m<sup>2</sup> në pajtim me lejen e fituar për ndërtim. Në të kundërtën, në rast se blerësi nuk nxjerr leje për ndërtim në afatin e paraparë, respektivisht në rast se objekti nuk është ndërtuar në afatin e paraparë me faj të blerësit, i njëjti do të ketë obligim të paguaj dënimin e caktuar prej 1.5% të çmimit të arritur në ankandin publike tokës në fjalë për secilin muaj të kaluar në vitin e pare nga kalimi i afatit, respektivisht 3% nga çmimi i arritur në ankandin publik të tokës në fjalë për secilin muaj të kaluar në vitin e dytë nga afati i kaluar, respektivisht 4,5% nga shuma e përgjithshme e çmimit e arritur në ankandin publik e tokës në fjalë për secilin muaj të kaluar në vitin e tretë dhe secilit vit me radhë nga skadimi i afatit. Mosplotësimi i këtyre obligimeve, respektivisht pas ramjes së blerësit në vonesë të plotësimit të këtyre obligimeve tre muaj me radhë, paraqet bazë që tjetërsuesi pas tre muajve thirrje të njëanshme për realizim, si kreditor me deklaratë për mosplotësim të obligimeve nga kontrata të kërkojë vërtetim për realizim të kontratës , respektivisht të kërkojë pagesën e dënimit kontraktues i cili paraqet edhe bazë për prishje të njëanshme të kontratës, prej çka 80% nga shuma e përgjithshme e tjetërsimit nuk i kthehen blerësit;

22. Përqindja minimale e cila duhet të ndërtohet nga gjithsej hapësira e zhvilluar për ndërtim e paraparë me planin urbanistik për lëndën e parcelës ndërtimore, nuk duhet të jetë më e vogël se 30%;

23. Ofertuesi më i volitshëm është i obliguar që ta paguaj tatimin e fitimit i cili do të del si obligim pas marrëveshjes së arritur për tjetërsim të tokës ndërtimore;

24. Në çmimin e tokës ndërtimore nuk është përfshirë kompensimi për rregullim të tokës ndërtimore;

25. Shpenzimet për procedurën noteriale dhe paraqitjen në evidencën e patundshmërive në Agjencia për kadastrë të patundshmërive bien në ngarkesë të blerësit të tokës ndërtimore.

26. Pronari i tokës ndërtimore të fituar në procedure për tjetërsim nëpërmjet ankandit publik nuk i lejohet të njëjtën që ta transferojë në persona të tretë, para plotësimit të obligimeve të kontraktuara për tjetërsim të së njëjtës. Ndajesa për transferim tek persona të tretë regjistrohet në librin publik për regjistrim e të drejtave të patundshmërisë;

27. Pjesëmarrësit e pakënaqur në ankandin publik mund të deklarojnë kundërshtim deri tek Komisioni në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e mbajtjes së ankandit publik në mënyrë elektronike. Kundërshtimi dorëzohet në formë të shkruar deri tek Komisioni i cili vendosë për kundërshtimin me vendim. Komisioni është i obliguar të vendosë për kundërshtimin në afat prej pesë ditë pune nga pranimi i të njëjtit.

28. Kundërshtimi të sjellë nga ana e komisionit, me të cilin vendoset për kundërshtimin e paraqitur, pala ka të drejtë të paraqesë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit deri tek Komisioni shtetëror që vendosë për procedurë administrative dhe procedurë për marrëdhënie pune në shkallë të dytë.

[Kjo shpallje do të jetë e publikuar edhe në UEB faqen e Komunës së Sarajit ww.sara.gov.mk](http://www.sara.gov.mk)

Komisioni për realizim të procedurës për ankand publik të tokës Ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë

LIGA E KAMPIONËVE

# “SHAQIRI ISHTE VENDIMTAR”: KLOPP NGRE LART SHQIPTARIN KUNDËR SERBËVE



“Shaqiri ishte i përfshirë në shumë gjëra të kësaj ndeshjeje. Ai ishte vendimtar. Në rastin e golit të parë, ai e fitoi topin dhe dha një pasim fantastik për Robbo (Andrew Robertson). Në golin e dytë, unë nuk e di se si e pasoi atë top për Mohamed, por ishte sërish Shaq. Ai është një futbollist me të vërtetë i këndshëm, që po na ndihmon në këto lojëra”, ka deklaruar Klopp

Jurgen Klopp është i vetëdijshëm se Liverpool duhet të mbetet i vëmendshëm, pasi ka kapur kren e grupit C, duke besuar se me rivalë si PSG dhe Napoli nuk ka asgjë të sigurtë në një kompeticion si Liga e Kampionëve. “Reds” mundën Crvena Zvezda 4-0, për të marrë vendin e parë në grup, teksa PSG dhe Napoli barazuan 2-2 në Francë. Jurgen Klopp iu përgjigj pyetjes nëse ka ende punë për të bërë, për të siguruar kualifikimin, duke thënë se këtë gjë nuk mund ta konfirmojë përpara kthimit me serbët, pas dy javëve. “Unë nuk e di kush është i dyti, por kam dëgjuar se Napoli dhe PSG kanë barazuar 2-2”, tha trajneri gjerman për “BT Sport”. – Mund ta imagjinoj se ishte një ndeshje shumë e hapur në Paris. Do të jetë një rivalitet emocionues, sepse ky grup është i vështirë për të gjithë ne. Duhet të punojnë fort çdo ditë dhe shpresojmë se do të jemi gati për dy javë, kur të luajmë sfidën e kthimit me Cvena Zvezda”. Mohamed Salah shënoi dy herë në “Anfield”, duke rrumbullakosur golin e tij të 50-të për klubin, por Klopp zgjodhi Xherdan Shaqirin, i cili kishte ndikimin e tij në dy gola, për t'i dhënë lëvdata të veçantë, pas një shfaqjeje të mrekullueshme. Përsëri, duke qeshur me emrin e Shaqirit, Klopp ka thënë: “Shaqiri ishte i përfshirë në shumë gjëra të kësaj ndeshjeje. Ai ishte vendimtar. Në rastin e golit të parë, ai e fitoi topin dhe dha një pasim fantastik për Robbo (Andrew Robertson). Në golin e dytë, unë nuk e di se si e pasoi atë top për Mohamed, por ishte sërish Shaq. Ai është një futbollist me të

vërtetë i këndshëm, që po na ndihmon në këto lojëra”, ka deklaruar Klopp.

## ANCELOTTI: I KËNAQUR ME NDESHJEN, KEQARDHJE PËR BARAZIMIN

Thomas Tuchel, trajneri i PSG nuk ka mbetur aspak i kënaqur me lojën e ekipit të tij dhe as me rezultatin, pavarësisht se në minutat e fundit Di Maria gjeti golin e barazimit. Në prononcimin për mediat, në fund të ndeshjes me Napolin, e cila u mbyll barazim 2-2, gjermani është përpjekur të theksojë se PSG nuk është si skuadrat e italiane apo edhe Atlético de Madrid, sipas së cilit kanë një stil loje, që nuk e pëlqen aspak. “Kultura në Itali karakterizohet nga kujdesi për lojën pa top, ne duhet ta respektojmë atë, por ne nuk jemi një ekip italian, as Atlético de Madrid, ne janë PSG, “deklaro ai. Nisur nga loja që pa nga djemtë e tij në fushë mbrëmjen e së mërkurës, por edhe ecurinë e skuadrës, Tuchel nuk e sheh aspak PSG si pretendent për të fituar Champions League, pavarësisht se në merkato, klubi ka bërë shpenzime të “çmendura” duke blerë yje të futbollit. “Ne nuk jemi aspak favo-

ritë, nuk do ishte e çuditshme që të eliminohehim. E nisëm mirë në 15 minutat e para, por më pas ishim të të çorganizuar”, tha ai për lojën e dobët të klubit të Parisit. Aktualisht Paris Saint Germain renditet në vendin e tretë në grupin C me katër pikë. Grupi kryesohet nga Liverpool me gjashtë pikë, për t'u ndjekur nga Napoli dhe në vendin e fundit Crvena Zvezda e cila u mund me “poker” mbrëmjen e djeshme nga skuadra e Jurgen Klopp. Nga ana tjetër, Thomas Tuchel, trajneri i PSG nuk ka mbetur aspak i kënaqur me lojën e ekipit të tij dhe as me rezultatin, pavarësisht se në minutat e fundit Di Maria gjeti golin e barazimit. Gjermani është përpjekur të theksojë se PSG nuk është si skuadrat e italiane apo edhe Atlético de Madrid, sipas së cilit kanë një stil loje, që nuk e pëlqen aspak. “Kultura në Itali karakterizohet nga kujdesi për lojën pa top, ne duhet ta respektojmë atë, por ne nuk jemi një ekip italian, as Atlético de Madrid, ne janë PSG, “deklaro ai. Nisur nga loja që pa nga djemtë e tij në fushë mbrëmjen e së mërkurës, por edhe ecurinë e skuadrës, Tuchel nuk e sheh aspak PSG si pretendent për të fituar

Champions League, pavarësisht se në merkato, klubi ka bërë shpenzime të “çmendura” duke blerë yje të futbollit. “Ne nuk jemi aspak favoritë, nuk do ishte e çuditshme që të eliminohehim. E nisëm mirë në 15 minutat e para, por më pas ishim të të çorganizuar”, tha ai për lojën e dobët të klubit të Parisit.

## VALVERDE: NDALUAM LOJËN SULMUESE TË INTERIT

Trajneri spanjoll, Ernesto Valverde ka folur pas fitores së Barcelonës në Ligën e Kampionëve ndaj Interit. Barcelona fitoi me rezultat 2-0 ndeshjen e fazës së grupeve ndaj Interit, duke i ofruar edhe më shumë kualifikimit dhe kjo i ka pëlqyer edhe trajnerit Valverde, i cili ka vlerësuar skuadrën e tij, edhe pse pa Lionel Messin e lënduar. “Ne i ndaluan ata që të luajnë dhe e bëmë këtë gjatë gjithë ndeshjes”, ka thënë fillimisht Valverde në konferencën e tij pas ndeshjes. Ishte një ndeshje e rëndësishme dhe e vështirë dhe e para pa Messin. Gjithkush ishte në pritje dhe mendoj se reaguam mirë. Është e vërtetë se loja e sotme na ndihmoi të bënim një hap

përpara pa Leon. Qëllimi ynë ishte, që Interi të mos e ketë topin dhe të jetë shumë i shpejtë në presing pasi të humbasim topin. Ata janë një ekip sulmues, por ne ishim ekipi më i mirë në të gjithë ndeshjen. Arthur luajti shumë mirë dhe unë jam shumë i lumtur me të. Zëvendësimi? Nuk dua ta rrezikoj atë sepse ai kishte një goditje të vogël”, përfundoi spanjollli. Mauro Icardi ka folur pas humbjes së Interit në Ligën e Kampionëve ndaj Barcelonës. Interi u mposht në Camp Nou nga Barcelona me rezultat 2-0 falë golit të parë të shënuar nga Rafinha dhe të dytit nga Jordi Alba. Kjo humbje ka lënë shije të hidhur te kapiteni i klubit italian, Icardi, i cili është ndarë i pakënaqur pas ndeshjes. “Mendoj se diferenca sot ishte në pjesën e parë, ku nuk luajtëm me standartet e Interit. Kemi lënë shumë hapësira dhe u kemi lejuar iniciativën”, ka thënë fillimisht Icardi për Sky Sport Italia. “Në pjesën e dytë, ne bëmë më mirë dhe e detyruam Barcelonën të humbasë pasimet, por unë mund të kisha bërë më shumë për ta bërë maksimumin e situatës duke përfunduar shanset. Nuk jam shumë i kënaqur me performancën, sepse ne mund të kishim bërë mirë që nga fillimi dhe në vend të kësaj u kthyem mbrapa. Ne tani duhet të ndryshojmë shumë në San Siro dhe të marrim pikët e nevojshme për të kaluar tutje. E dinim se ishim kundër kampionëve të klasit botëror që kanë fituar gjithçka gjatë viteve. Nëse u lejon atyre një gol, bëhet e vështirë të rikuperohet”, përfundoi kapiteni i Interit.

## RAFINHA: I LUMTUR PËR FITOREN DHE GOLIN

Mesfushori i Barcelonës, Rafinha, u shpreh i lumtur për golin dhe fitoren 2-0 ndaj Interit. Braziliانى gjithashtu premtoi se skuadra do të jep gjithçka për të vazhduar me fitore edhe në La Liga kundër Real Madridit. “Jam shumë i lumtur se kam startuar, ndihem mirë, kam shënuar dhe ne fituam”, ka thënë Rafinha pas ndeshjes. “Rezultati na jep shumë besim dhe si gjithmonë ne do të japim

gjithçka të dielën. Jemi shumë të lumtur që arritëm të bëjmë një paraqitje të mirë ndaj një skuadre që ishin duke na vështirësuar gjërat. Luajtëm shumë mirë. Liga e Kampionëve është shumë speciale për neve, por edhe gara tjera janë gjithashtu të rëndësishme”, shtoi braziliani për fund. Vlen të theksohet se Rafinha ishte i huazuar te Interi në sezonin e fundit.



**DASHI** 21. mars - 20. prill

Po përballeni me një periudhë mjaft të komplikuar dhe për këtë arsye do të jeni të stresuar dhe të lodhur. Këshillohet që gjatë kësaj të enjteje të pushoni më shumë. Para jush do të shpalosen mundësi shumë të mira, por nuk duhet të merrni vendime të nxituara.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Fuqia fizike dhe mendore e juaja do të vihet në provë të vështirë, e cila gjithsesi do të dominojë. Në dashuri do të ndiheni të lënë pas dore, por kjo gjë nuk duhet të çojë në sjellje agresive, pasi rrezikoni të konfrontoheni me partnerin/en.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Parashikohet një ditë e cila do ju gjejë konfuz, sidomos në sferën e ndjenjave. Do e gjeni veten të ndarë mes dy historive, ndaj mundohuni të merrni më shumë kohë për të reflektuar mbi atë që kërkon vërtetë nga një lidhje.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Në këtë moment duhet të jeni kurajoz dhe të mundoheni të merrni përsipër ndonjë rrezik më shumë, pasi intuïta juaj do ju lejojë që të arrini rezultate të kënaqshme. Sa i takon dashurisë dhe ndjenjave, ky është një moment i mirë për tu hapur me dikë.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Keni shumë mundësi për të shfrytëzuar në avantazhin tuaj, por do të arrini të favorizoni bashkëpunimin me kolegët tuaj, duke marrë rezultate të frytshme. Në dashuri duhet të jeni më impulsiv.



**VIRJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Nëse do arrini që të lirohni nga të gjithë mendimet negative, mund t'j jepni një shtysë tjetër jetës tuaj, duke u dominuar nga një pozitivitet i madh. Do të jeni të qetë dhe reflektues dhe për këtë arsye, do të arrini të kaloni çdo moment tensioni.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Dëgjoni më shumë sugjerime të vlefshme nga familja ose bashkëpunëtorët tuaj, pasi do të rezultojnë mjaft me vlerë. Duhet të jeni gati të përballeni me ndonjë debat të ashpër, por nuk duhet të jeni të tensionuar, pasi do arrini të fitoni çdo betejë me sukses. Takimet janë mjaft të favorshme.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Do t'iu duhet të bëni një zgjedhje të rëndësishme në vendin e punës, ndaj nuk duhet të nxitoheni. Ky është një moment shumë i mirë për të bërë ndryshime thelbësore në stilin tuaj të jetës. Mbrëmja parashikohet të jetë mjaft pasionante.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Në vendin e punës nuk duhet të shfaqni një sjellje që ngjall polemika, pasi rrezikoni të ushqeni tensione dhe keqkuptime në vendin e punës. Nga pikëpamja sentimentale, këshillohet të mos jini shumë xheloz dhe të mos kërkon më shumë nga ç'duhet ndaj partnerit/es.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Kjo ditë do ju shohë mjaft të shqetësuar dhe të përhumbur në mendime, ndoshta për shkak të ndonjë vonese në vendin e punës. Mos ngurroni që të kërkon ndihmë. Mbrëmja është ideale për ta kaluar me familjen.



**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Do të jeni mjaft të ngarkuar në realizimin e një projekti të ri i cili do të kërkojë shumë energji dhe përgënjim. Nuk duhet të lejoni veten që të përfshihen në polemika të kota. Në dashuri do të jeni në kërkim të më shumë stabiliteti.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Do të jeni shumë paqësor dhe kjo në sajë të rigjetjes së harmonisë dhe bashkëpunimit me partnerin/en. Kjo ditë favorizon ndjenjat dhe kohën e kaluar me njerëzit që doni, kështu që largoni çdo ankth nga vendi i punës. Intuïta e mirë do ju vijë në ndihmë në zgjidhjen e të papriturave të vogla.



PËRKUJTIM

Flamur Samiu

28.11.2003-26.10.2017

Jeta ishte plot dhimbje për ne pa Rahimin, por tani që nuk të kemi Ti Flamur dhimbja u shtua edhe më shumë për mua dhe motrat e tua Rrezëartën dhe Erën, por krenaria që ju patëm na mban në jetë, na jep kurajo që të ecim para me kujtimet e bukura për Ju. Do të jeni gjithmonë në zemrat tona !  
Të kujtojnë me mall e dhimbje nga zemra nëna Luljeta dhe motrat Rrezëarta dhe Era Samiu

Mensur Mamuti	PENGIM, PRISHJE NË MBARËVAJTJEN E NJË PUNE	NUËSIA PËR MATJEN E GJATËSISË ISH POLITIKANI FRANCEZ NË FOTO	M	PARTIA E POLITIKANIT NË FOTO ISH FUTBOLLISTI SPANJOLL, GONZALEZ (SHQ.)	P	NE KE TE DATE				
TRUP I RRRUMBULLAKËT, RRUZULLI										
ZEJSTAR I PUNIMEVE TE ARTIT										
LËNDË PLASESE, PLUHUR										
AKTORI AMERIKAN, RAJAN (SHQ.)										
ELIOT DIZAJNERI FRANCEZ I MODËS, KRISTIAN			ISMAIL ARSLANI RUTENIUMI							
D				SUEDIA SHTYPJA						
FUTBOLLISTI ARGJENTINAS, KARDI										
KOHA	METRI LLOJ LULEJE (SH. PASHQ.)		EJUP CERAJA ORSON UELLS							
SHKURTPAMËSI (MJEK.)						RAPISTI AMERIKAN, KUDI	KOHA	FSHAT NË GOSTVAR	AKTORE	POSEDON
ENË, NË TË CILËN E BËJNË NEVOJEN FEMIJET							RRJETË PESHKIMI ME DREJTËSI, NDRERSHËM			
SKIFTERI ETEMI			KËNGËTARE E JONA ESAD MEKULI							
POSTI I POLITIKANIT NË FOTO NJËRI NGA MUSHQETARET										MARKË ITALJANE AUTOMOBILASH
A						ISH POLITIKANI BOSHNIAK, DIZDAREVIQ NUËSIA E VJETËR E PESHËS				
AKTORJA AMERIKANE, MARGARET			KËNGËTARI SLOVEN, PESTNER				SHKRONJË GREKE DANIMARKA			
KALIUMI HAPËSIRA NË MES DY DREJTËZAVE QË DALLIN NGA E NJËJTA PIKË		TREGIMI ZBAVITËS NGA JETA E DIKJUT AZOTI								
						BOSHTET				

ZGJIDHJET: M, P, SFERA, ARTAR, BARUT, O NILI, TS, IA, DIOR, S, MAURO, M, EC, MIOP, OTURAK, SAK, SE, ELI FARA, PRESIDENT, ARAMIS, RAIF, EN, OT, KSI, K, ANEKDOTA, KËNDI, AKSEFT.

## Titaniku do të kthehet sërish në det!

"Titanik"-u do të kthehet sërish në det. Projekti për ndërtimin e një kopjeje të anijes më të famshme në botë, i fundosur në oqeanin Atlantik, ishte pezulluar, ndërkohë që sapo ka filluar plani për ndërtimin e tij dhe përrurimin me një udhëtim turistik në vitin 2022.

Bëhet fjalë për një tur prej dy javësh, duke nisur nga Dubai drejt Sauthemptonit dhe më pas në New York, në gjurmët e anijes që u fundos më 12 prill 1912 gjatë udhëtimit përurues, pas përplasjes me një ajsberg. "Titanic II", i ndërtuar nga kompania "Blue Star Line", do të ketë të gjitha detajet estetike origjinale dhe të njëjtin numër pasagjerësh (2 400) dhe ekuipazhi (900).

Sidoqoftë, ai do të ketë një teknologji



të përparuar lundrimi dhe sigurie. "Udhëtimi i parë do të ndjekë atë origjinal, ndërkohë që do të ketë edhe udhëtime të

tjera", deklaroi biznesmeni dhe politikani australian Clive Palmer, i cili qëndron pas kësaj nisme.

## Telefonat 5G gati vitin e ardhshëm



Shumë prodhues të telefonave kanë zbuluar planet se janë gati për të hyrë në treg me rrjetin më të ri, 5G. Carl Pei, bashkëthemeluesi i OnePlus, ka thënë se kompania e tij do të jetë ndër të parat që do të sjellin pajisje që përkrahin këtë rrjet. Me gjasë, telefoni i parë i kësaj kompanie me rrjetin 5G do të quhet OnePlus 7. Në një konferencë që po mbahet në Hong Kong, Cristiano Amon, presidenti i Qualcommit, njoftoi se të paktën dy pajisje 5G do të vijin më 2019, përfshirë OnePlusin. Ky telefon do të dalë në treg më parë të vitit të ardhshëm. HMD Global, LG, Motorola, Oppo, Sony, vivo dhe Xiaomi janë kompanitë tjera që do të lansojnë telefona të tilla. Në mesin e emrave të mëdhenj mund të përmendim Samsungu, Apple e Huawei.

## Gjobë 1 mijë euro kush nuk deklaron shpenzimet e dasmës

Të gjithë çiftet e reja të martuar gjatë 5 viteve të fundit do të jenë nën shënjestrën e Agjencisë së Mbledhjes së Taksave, ANAF. Sipas kësaj të fundit, ata duhet të deklarojnë shumën totale të shpenzimeve të dasmës së tyre, në të kundërt do të përballen me gjoba deri në 1071 euro.

Në Rumani, ashtu si në shumë vende të Evropës, dhuratat e dasmës zakonisht janë në formën e parave për t'i dhënë mundësi çiftit të paguajnë për ceremoninë e martesës së tyre dhe për të shërbyer në një farë mënyrë si mbështetje financiare edhe për muajt në vijim. Pajesja me para 'cash' e indi-

vidëve dhe kompanive që ofrojnë shërbime në dasma, duke përfshirë këngëtarët, fotografët, etj, ka filluar të shqetësojë autoritetet tatimore, pasi të ardhurat e tyre nuk deklarohen, raporton "scantv". Nisur nga kjo, ata kanë vendosur që të dorëzojnë formularë të gatshëm të gjithë këtyre çiftëve duke kërkuar detaje për njerëzit që kanë ofruar shërbime në dasmën e tyre dhe për shumën totale që kanë shpenzuar. Ndërkohë, ministri i Financave të vendit, Eugen Teodoroviç ka kritikuar nismën e autoriteteve tatimore rumune mbi taksimin e dhuratave të dasmës dhe deklarimit të shpenzimeve.



## Hungaria do ta ndalojë tërësisht duhanpirjen!

Hungaria po planifikon të bëhet vendi i parë në botë që i thotë jo duhanit. Janos Lazar, komisioneri për Mbrojtjen e jo-duhanpirësve i ka bërë thirrje Parlamentit hungarez të miratojë legjislacionin që ndalon të gjithë ata që do të lindin pas datës 1 janar 2020 të konsumojnë duhan.

Sipas tij, nëse është e nevojshme, parlamenti do të ndryshojë kushtetutën në mënyrë që projektligji të kalojë. Ai nuk e ka dorëzuar ende zyrtarisht propozimin në kabinet, sipas Qendrës së Informacionit të Qeverisë. Hungaria është tashmë një nga vendet më strikte në botë për duhanpirësit. Që nga vitit 2013, cigaret



tregtohen vetëm në dyqane të veçanta për duhan. Autoritetet pretendojnë se

numri i cigareve të blera në vend ka rënë me më shumë se 40%.



KALENDARI HISTORIK 26 TETOR

740 - Tërmet i madh në Konstantinopolje.

1407 - Turmë e njerëzve sulmojnë Komunitetin hebre në Krakov.

1662 - Çarlisi II i Anglisë shet Dankirkun Francës.

1822 - Mbreti Uilhemi I obligon banorët e Brukselit të përdorin gjuhën holandeze.

1863 - Kryqi i Kuq mbarë botëror organizohet në Gjenevë.

1912 - Trupat serbe pushtojnë Shkupin.

1941 - Takimi i dytë mes Titos dhe Drazha Mihailoviçit në Jugosllavi.

1947 - Përfundon okupimi britanik në Irak.

1950 - Nëna Terezë themelon Misionin e Bamirësisë në Kalkutë, Indi.

1951 - Uinston Çerçili rizgjidhet kryeministër britanik.

1962 - Kenedi paralajmëron Rusinë që SHBA nuk do të lejojë që raketat sovjetike të qëndrojnë në Kubë.



A E DINI SE...

Deuteriumi, një nga përbërësit për shkrirjes bërthamore, gjendet lehtësisht në ujin e detit, dhe shihet si një karburant i mundshëm për një reaktor bërthamor. Kështu deri 3,5 litra ujë, mund të prodhojnë më shumë energji se sa 1000 litra benzinë.



Në vitin 1944, britanikët prezantuan një plan të plotë për të vrarë Hitlerin gjatë shëtitjes së tij të përditshme vetëm. Plani nuk u zbatua asnjëherë, pasi Hitleri ishte një strateg kaq i dobët, sa që britanikët e kuptuan se zëvendësimi i tij, vetëm mund të forconte dhe jo dobësonte mbrojtjen e Gjermanisë naziste.



BARSOLETA

### RECETA

Një grua shkon tek farmacisti dhe i thotë: - Të lutem, më jepni një doze arsenik!

- Përse ju duhet, e pyet farmacisti.

- Dua të helmoj burrin, i thotë gruaja.

- Jo, i thotë farmacisti! Ne nuk japim ilaçe për të tilla raste! Në këtë moment gruaja i tregon një foto që kishte dalë burri i saj me gruan e farmacistit.

- Ahaa, i thotë farmacisti! Po pse s'më the që në fillim që kishe recetë!



THËNIA E DITËS



Çfarë mund të bëni për të promovuar paqen në botë? Shko në shtëpi dhe dua je familjen!

(Nënë Tereza)